**VENDIM**
**Nr. 812, datë 30.12.2025**

# PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË PËRGJITHSHËM ANALITIK TË PROJEKTAKTEVE, QË DO TË PARAQITEN PËR SHQYRTIM NË KËSHILLIN E MINISTRAVE GJATË VITIT 2026

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 27, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve, që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2026, sipas tabelave që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

# PROGRAMI I PËRGJITHSHËM ANALITIK I PROJEKTAKTEVE PËR VITIN 2026

## KRYEMINISTRI/ZV.KRYEMINISTRI

| Nr. | Titulli i projektaktit | Lloji i projektaktit | Ministri propozues | Katërmujori | Arsyet kryesore për propozimin e projektaktit | Çështjet kryesore që parashikon të rregullojë projektakti | A është parashikuar projektakti në PKIE?<br><br>Nëse po, të specifikohet kapitulli përkatës | Përputhshmëria e projektaktit me programin politik qeverisës 2025-2029<br><br>Nëse përputhet, të jepet referenca e saktë në progam | A është akt i një rëndësie të veçantë e prioritare? | Lidhja e projektaktit me strategjitë kombëtare dhe sektoriale<br><br>Nëse lidhet, të specifikohen strategjitë | Ndikimet e mundshme ekonomike, financiare, sociale dhe mjedisore<br><br>Përgjigjuni me Po/Jo për ndikimet përkatëse |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10/2023 "Për informacionin e klasifikuar" | Projektligj | Kryeministri/Zv. Kryeministri (AKSIK) | Katërmujori I | 1.Në funksion të sigurisë dhe të punës me informacionin e klasifikuar.<br>2. Si rezultat i problematikave të hasura gjatë punës me informacionin e klasifikuar, të evidentuara nga institucionet të cilat prodhojnë, ruajnë apo përpunojnë informacion të kalsifikuar. | 1.Rritje e standardeve që garantojnë sigurinë e informacionit të klasifikuar, gjatë procesit të administrimit dhe mbikëqyrjes së tij.<br>2. Përmirësim i punës me informacionin e klasifikuar.<br>3.Përcaktim i aktit nënligjor që rregullon kryerjen e trajnimeve, për personelin që punon me informacionin e klasifikuar.<br>4.Mbikëqyrja e masave të sigurisë. Rregullim i kuadrit ligjor për kryerjen e procedurave të inspektimeve.<br>Parashikim i aktit nënligjor që përcakton rregullat e detajuara të kryerjes së procedurave të inspektimeve. | Jo | Jo | Jo | Jo | N/A |
| 2 | Për miratimin e metodologjisë për llogaritjen së çmimeve të tokës në RSH | Projektvendim | Kryeministri/Zv. Kryeministri (ASHK) | Katërmujori I | Në funksion të përmirësimit të punës dhe ecurisë së veprimtarisë së ASHK dhe detyrimeve që burojnë nga ligji nr.111/2018 " Për Kadastrën", neni 9, pika 2, germa k. | Përcakton metodologjinë e vlerësimit të pronave të paluajtshme(tokës) në RSH, në zbatim të nenit 9/2/k të ligjit nr.111/2018 " Për Kadastrën" | Jo | Përputhet me programin politik të qeverisë dhe konkretisht me Kreun "Administratës Publike, Antikorrupsioni dhe Transparenca" (faqe 15) | PO | Miratimi i këtij projektakti është në funksion të zbatimit të Strategjise ndersektoriale " Reforma në fushën e të drejtave të pronësisë në vitin 2012-2020(kapitulli II) | Po, ndikim ekonomik dhe social |
| 3 | Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 711, datë 20.11.2024 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores "Për marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit dhe personave juridikë, në kuadër të ofrimit të asistencës juridike, rolin e avokatëve të shtetit në gjykim, si dhe normat e posaçme procedurale" | Projektvendim | Kryeministri - Zv./Kryeministri (Avokatura e Shtetit) | Katërmujori I | Ky projektakt propozohet me qëllim mbledhjen e informacionit për të gjitha çështjet gjyqësore në të cilat institucionet shtetërore janë palë, dhe që Avokatura e Shtetit ofron asistencë juridike. Në Avokaturën e Shtetit do të krijohet një Regjistër për Çështjet Gjyqësore, në format elektronik, ku do të grumbullohen të gjitha çështjet gjyqësore që raportohen nga institucionet shtetërore, si dhe do të verifikohet nëse janë njoftuar nga gjykatat personat juridikë dhe Avokatura e Shtetit. | Krijimin e një regjistri për çështjet gjyqësore në të cilat Avokatura e Shtetit ofron asistencë juridike. Dërgimin në mënyrë periodike të informacionit për çështjet gjyqësore, Avokaturës së Shtetit, nga të gjithë personat juridik të cilëve ju ofrohet asistenca ligjore.<br>Ky projektvendim vjen në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008, të ndryshuar, duke parashikuar mekanizma që synojnë pasjen e një bashkëpunimi të koordinuar në kohë dhe fleksibël, e njëkohësisht krijimin e një sistemi data bazë të qendërzuar dhe permanent, për të gjitha proceset gjyqësore me palë ndërgjyqëse personat juridik të parashikuar në pikën 1/1, të nenit 5, të ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008. | Jo | Jo | Jo | Jo | N/A |
| 4 | Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese nr.2 me shkëmbim letrash të marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Malit të Zi dhe Komisionit Evropian Për Programin IPA BNK Mali i Zi-Shqipëri 2021-2027". | Projekligj | Kryeministri (SASPAC) | Katërmujori I | Detyrimet e parashikuara në Nenin 10 të Ligjit nr. 43/2016 "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë". Me miratimin e këtij projektakti, Shqipëria bëhet përfituese e fondeve të BE dhe i lind e drejta e aksesimit dhe përthithjes së fondeve të miratuara në këtë program. | Projektakti parashikon ndryshimiet për aprovimin e angazhimeve financiare të Bashkimit Evropian,për të cilat vendet pjesëmarrëse në program mund të përfitojnë fonde, strukturat përgjegjëse për menaxhimin, koordinimin, monitorimin, audimin dhe kontrollimin fondeve të disponueshme të programit, mënyrën e shpërndarjes së fondeve në dispozicion dhe periudhën kohore, etj. | Jo | Anëtarësimi në Bashkimin Europian<br>Inovacioni dhe Teknologjia<br>Infrastruktura Moderne<br>Turizmi<br>Energjia<br>Politikat Sociale<br>Rinia dhe Barazia Gjinore<br>Mbrojtja e Mjedisit dhe Ndryshimet Klimatike<br>Pushteti Vendor dhe Zhvillimi Rajonal<br>Kultura | Po | Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2030 | Po |
| 5 | Për miratimin e Dokumentit të Politikave Prioritare 2027-2029 | Projektvendim | Kryeministri (SASPAC) | Katërmujori I/ Lista Unike e Projekteve Strategjike mund te rishikohet sipas vleresimit cdo tre muaj: Prill - Korrik - Tetor | Ngritja e ketij dokumenti qendror, planifikues dhe strategjik afat-mesem ne nivelin e duhur te hierarkise ligjore per te inicuar rritjen e performances se zbatimit si edhe ne funksion te paraprirjes me te mire te drejtimit te politikes se pergjithshme ndaj funksionit te planifikimit financiar te shtetit.<br>NSPP eshte parashikuar në VKM "Për Procedurat e Menaxhimit të Investimeve Publike" | Ne teresi rrit harmonizimin e perparesive dhe politikave te qeverise me kapacitetin financues te saj ne afatin e mesem, ose orienton racionalisht procesin e shperndarjes se burimeve midis sektoreve. Ndihmon ne percaktimin e tavaneve buxhetore afat-mesme per PBA si dhe rregullon procesin e konsiderimit te projekteve te reja ( politika te reja) duke siguruar vazhdimesine e projekteve ekzistuese dhe ruajtur ekuilibrin e bilancit te shtetit. Lista Unike e Projekteve me Rëndësi Kombëtare përmban projektet e investimeve publike që kanë rëndësi strategjike përsa i përket zhvillimit ekonomik dhe social të vendit, pavarësisht nga burimi i tyre i financimit. Kjo listë shërben si instrument për mbeshtetjen e politikave dhe prioriteteve të Qeverisë Shqiptare, në linjë me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2030 (SKZHIE), si edhe strategjitë sektoriale e ndërsektoriale. Lista Unike e Projekteve me Rëndësi Kombëtare shërben si referencë për ministrinë përgjegjëse për financat dhe njësitë e qeverisjes qëndrore, në kuadër të përfshirjes së projekteve të investimeve publike në Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA) apo Buxhetin Vjetor. | Tematika e SKZHIE III dhe lidhjes se saj me PBA. Ky projekt akt harmonizon pikerisht politikat dhe reformat afatmesme te qeverise me PBA duke perfshire projektet kombetare NSPP nga buxheti i shtetit, fondet IPA dhe financimin tjeter te huaj. DPP lidhet me te gjithe kapitujt e integrimit ne teresi pavaresisht se raportohet tek kap. 22 , pasi perfshin reformat afatmesme dhe afatgjata te qeverise si dhe sektoret prioritare, NSPP prek shume sektore te zhvillimit te vendit si vertikale ashtu edhe sektore horizontale. DPP lidhet konkretisht me clusters te integrimit: Themeloret, Konkurueshmeria, Agjenda e gjelber dhe nderlidhjet e qendrueshme, burimet bujqesia dhe marredheniet e jashtme.<br>Raportohet formalisht ne kuader te Kapitullit 22. Politikat Rajonale (Kohezioni) dhe Kordinimi I Instrumentave Strukturore. | Integrimi Evropian, te drejtat e njeriut, PAR reforma, Zhvillimi i bujqësisë dhe i fshatit, Infrastruktura, Turizmi dhe Mjedisi, Energjia, Digjitalizimi , Shoqëria dixhitale etj | Po | Strategjia Kombetare e Arsimit 2021-2026 , Strategjia Kombetare e Shendetesise 2021-2030 , Strategjia Kombëtare e Pronësisë Intelektuale 2022 -2025<br>- Strategjia e Bujqesise , Zhvillimit Rural dhe Peshkimit 2021-2027<br>- Agjenda Digjitale e Shqipërisë 2026<br>- Dokumenti i Përgjigjes Strategjike IPA III<br>- Prioritetet e Programit IPA III , - Prioritetet e Programit IPARD III (Instrumenti per Asistencen e Para-Anetaresimit per Zhvillimin Rural) 2021 – 2027, - Procesi i Hartimit te draftit te Strategjise Kombetare per Zhvillim dhe Integrim 2021-2030 | Impakton ecurine ekzistuese dhe ndryshimin ne investimet e pergjithshme kapitale (publike) afat mesme, financimin e huaj (IPA dhe financime te tjera) dhe permireson vleresimin e politikave mbi bazen e evidencave (fakteve) duke prezantuar vazhdimisht nevojen per buxhetim te pergjithshem te pergjegjshem e te bazuar ne performance ( performance based budgeting) duke kontribuar ne shperndarjen e burimeve aty ku ka me shume nevoje dhe ku jemi me efektive dhe eficente. Impakton ne konvergimin e vazhdueshem me pragmatik te politikes qeveritare afatmesme me objektivat e integrimit dhe ato te zhvillimi te |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | | | qendrueshem. |
| 6 | Pë miratimin e Udhërrëfyesit për OZHQ 2025-2030 | Projektvendim | Kryeministri (SASPAC) | Katërmujori I | Përmbushja e detyrimeve që ka Shqipëria për angazhimin e marrë në kuadër të Agjendës së OKB-së 2030, për zhvillim të qëndrueshëm | Vendosjen e një kuadri për matjen e treguesve pë zhvillim të qëndrueshëm | Po, te gjithe kapitujt e Integrimit ne teresi. Udherrefyesi perfshin 17 objektivat e zhvillimit te qendrueshem sipas Agjendes 2030. Ai lidhet me te 5 clusters te integrimit : Themeloret, Tregu I brendshem, Kokurueshmeria dhe rritja gjitheperfshirese, agjenda e gjelber dhe nderlidhjet e qendrueshme dhe marredheniet e jashtme | Demokracia, te drejtat e njeriut, sundimi i ligjit, shëndeti dhe zhvillimi i qëndrueshëm, Mirëqënie për të gjithë, Infrastruktura, Energjia, Turizmi dhe Mjedisi, Arsimi, perputhshmeria shtrihet ne pothuajse te gjithe fushat e rendesishme te zhvillimit te vendit etj | Po | SKZHIE 2022-2030, S3 Specializimi Inteligjent, reformat, politika e jashtme, sektoret prioritare te zhvillimit te vendit, bujqesia, turizmi, digjitalizimi, antikorrupsioni, integrimi evropian, energjia etj. | Axhenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, e miratuar nga të gjitha Shtetet Anëtare të Kombeve të Bashkuara në 2015, ofron një plan të përbashkët për paqen dhe prosperitetin për njerëzit dhe planetin, tani dhe në të ardhmen. Në qendër të tij janë 17 Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG), të cilat janë një thirrje urgjente për veprim nga të gjitha vendet - të zhvilluara dhe në zhvillim - në një partneritet global. Ato pranojnë se dhënia fund e varfërisë dhe privimeve të tjera duhet të shkojë krah për krah me strategjitë që përmirësojnë shëndetin dhe arsimin, zvogëlojnë pabarazinë dhe nxisin rritjen ekonomike – të gjitha duke trajtuar ndryshimet klimatike dhe duke punuar për të ruajtur oqeanet dhe pyjet tona. |
| 7 | Per identifikimin elektronik dhe sherbimet e besuara dhe Portofolin e Identitetit Digjital" | Projektligj | Kryeministri/Zv. Kryeministri (AKSK) | Katërmujori II | Mbartur nga PPAP 2025 | Projektligji transpozon rregulloret e BE nr. 910/2014 (eIDAS1) dhe rregulloren 1183/2024 (eIDAS2). | N/A | N/A | N/A | N/A | N/A |
| 8 | Për miratimin e listës së substancave prioritare, substancave të rrezikshme prioritare dhe disa ndotësve në ujërat sipërfaqësore, standardeve të tyre të cilësisë mjedisore, si dhe listës kombëtare të mbikëqyrjes | Projektvendim | Kryeministri/Zv. Kryeministri (AMBU) | Katërmujori II | Arsyet kryesore të propozimit të projektaktit lidhen me plotësimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor për menaxhimin e integruar të burimeve ujore në përgjithësi dhe përcaktimin e standardeve të cilësisë mjedisore në fushën e politikave për burimet ujore në veçanti, në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin Evropian | Projektvendimi synon përcaktimin e listës së substancave prioriteteve dhe substancave të rrezikshme prioritare, përcaktimin e listës së standardeve të cilësisë mjedisore për substancat prioritare dhe substancat e rrezikshme prioritare, përcaktimin e kërkesave për zbatimin e standardeve të cilësisë mjedisore; përcaktimi i standardeve të cilësisë mjedisore për dioksinat, PTB-të dhe substancat e ngjashme me dioksinat në artikujt ushqimorë; e listës së substancave prioritare për të cilat duhet të arrihet standardi i cilësisë mjedisore, si një element i statusit të mirë kimik të ujërave sipërfaqësore; e listës së substancave prioritare që priren të akumulohen në sediment dhe në biotë, si dhe përckatimin e listës kometare të vëzhgimit. | po (Kapitulli 27) | Paragrafi 5, gërma c, pika 3.6 Mbrojtja e Mjedisit dhe Ndryshimet Klimatike, Shtylla III Mirëqenie për të gjithë | SKZHI 2022-2030, Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore 2018-2034 | Jo | N/A |
| 9 | Për miratimin e planit të ndryshuar të masave të dokumentit të politikave “Për qeverisjen e sektorit të gjeoinformacionit në Shqipëri, 2020-2030” | Projektvendim | Kryeministri-Zëvendëskryeministri (ASIG) | Katërmujori II | Rishikimi I planit të masave pas vitit të pestë të zbatimit është parashikuar në dokumentin e politikave “Për Qeverisjen e Sektorit të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri, 2020-2030” të miratuar me VKM-në Nr. 402, datë 20.05.2020. | 1-Plani parashikon zbatimin e një serie masash për realizimin ne perudhen 2026-2030 të 12 politikave të parashikuara ne dokumentin e politikave .<br>2-Plani parashikon rolin dhe pergjegjësitë e institucioneve respektive pergjegjëse për zbatimin e dokumentit të politikave. | Jo | Shtylla 1, Pika 1.2 Shteti Digjital dhe Siguria Kibernetike | Jo | Dokumenti I politikave “Për Qeverisjen e Sektorit të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri, 2020-2030”, miratuar me VKM Nr. 402, datë 20.05.2020. | Jo |
| 10 | Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 291, datë 15.05.2024, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kufijve monetarë në procedurat e prokurimit publik" | Projektvendim | Kryeministri (APP) | Katërmujori II | Përafrimi i kufijve monetarë për prokurimet në sektorin klasik dhe utilitar, me kufijtë e rinj monetarë në Direktivën 2014/24/BE dhe Direktivën 2014/25/BE të cilët hyjnë në fuqi më 1 Janar 2026. | Përafrimi i kufijve monetarë për prokurimet në sektorin klasik dhe utilitar, me kufijtë e rinj monetarë në Direktivën 2014/24/BE dhe Direktivën 2014/25/BE të cilët hyjnë në fuqi më 1 Janar 2026. Gjithashtu, parashikimi n këtë VKM edhe të kufijve monetarë për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë dhe kufiri monetar për koncesionet, vlera e të cilave duhet të jetë në përputhje me vlerat e parashikuara në Direktivën 2009/81/KE dhe Direktivën 2014/23/BE, duke pasur në konsideratë që çdo dy vjet Bashkimi Evropian ndryshon kufijtë monetarë për prokurimet në sektorin klasik, utilitar, koncesionet dhe prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë. | Jo | PO | Jo | N/A | N/A |
| 11 | Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit” të ndryshuar | Projektligj | Kryeministri - Zv./Kryeministri (Avokatura e Shtetit) | Katërmujori II | Nëpërmjet këtij projektligji synohet të shpejtohet procesi i rekrutimit të avokatëve të shtetit, nëpërmjet parashikimit të një dispozite kalimtare. Arsyet që çojnë në këtë projektligj lidhen me vakancat e shumta të krijuara në Avokaturën e Shtetit, mosplotësimit të tyre nëpërmjet Programit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës, dhe kohës së gjatë të | Çështjet kryesore që parashikohet të trajtohen janë dispozita kalimtare për emërimin e avokatëve të shtetit si dhe parashikimi i funksionit të ndihmës avokatit të shtetit. | Jo | Jo | Jo | Jo | N/A |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | nevojshme për të filluar emërimet e para. Aktualisht nëpërmjet Shkollës së Magjistraturës pritet të përfundojnë programin fillestar deri në vitin 2027 4 kandidatë nga 7 vende vakante të njoftuara nga Avokatura e Shtetit në muajin Janar 2025. Ndërsa, aktualisht janë 8 vende vakante për avokatë shteti në nivel vendor, të cilët do të mbesin vakant të paktën deri në Tetor 2027. Për këtë, dhe referuar ngarkesës së konsiderueshme të avokatëve të shtetit, ka lindur domosdoshmëria e përshpejtimit të procesit të rekrutimit, duke e zhvilluar atë në të njëjtën mënyrë të kryer më parë, sipas dispozitave kalimtare të ligjit nr. 86/2018 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 018, datë 13.11.2008 "Për Avokaturën e Shtetit". | | | | | | |
| 12 | Për miratimin e kuadrit të bashkëpunimit midis Republikës së Shqipërisë dhe Kombeve të Bashkuara 2027 - 2031 | Projektvendim | Kryeministri (SASPAC) | Katërmujori II | Projektakti propozohet për të adresuar aspekte ekonomike, mjedisore dhe sociale të identifikuara në kuadër të zbatimit të Kuadrit të Bashkëpunimit, si rritja e aftësive të përshtatshme për tregun e punës, lufta ndaj informalitetit, politikat e biznesit dhe të mbrojtjes sociale. Ai synon të forcojë qeverisjen, transparencën dhe zbatimin e të drejtave të njeriut, duke mbështetur progresin e Shqipërisë në procesin e integrimit në BE, veçanërisht në kapitujt 23 dhe 24 të acquis. Një arsye tjetër themelore është përputhja me Marrëveshjen e Gjelbër Evropiane dhe tranzicioni drejt një ekonomie të gjelbër e gjithëpërfshirëse | Forcimin e politikave për zhvillim ekonomik të qëndrueshëm dhe punësim gjithëpërfshirës;<br>Investimet në kapitalin shoqëror dhe njerëzor;<br>Rritjen e efikasitetit të shërbimeve publike dhe sociale dhe uljen e pabarazive;<br>Formalizimin e tregut të punës, mbrojtjen sociale dhe rritjen e pjesëmarrjes së grave, të rinjve dhe PAK;<br>Zbatimin e standardëve të BE-së në fushat e sundimit të ligjit, të drejtave të njeriut dhe qeverisjes;<br>Tranzicionin e gjelbër dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore. | Jo specifikisht por lidhet ngushtesisht me kapitujt 2 Lëvizja e Lirë e Punëtorëve, 11 Bujqësia dhe Zhvillimi Rural, 12 Politikat e Sigurisë Ushqimore, 19 Politika Sociale dhe punësimi, 20 Ndërmarrjet dhe Politikat Industriale, 23 (“Drejtësia dhe të drejtat themelore”) dhe 24 (“Drejtësia, liria dhe siguria”), 25 Shkenca dhe Kërkimi Shkencor, 26 Arsimi dhe Kultura, Mbrojtja e Konsumatorit dhe Shëndeti Publik, si dhe në kapitujt 15 dhe 27 që lidhen me energjinë dhe mjedisin. Këto fusha janë thelbësore për procesin e anëtarësimit dhe për përputhjen me acquis të BE-së. | Projektakti përputhet me objektivat e programit qeverisës që parashikon zhvillim ekonomik të qëndrueshëm, forcim të shtetit të së drejtës, luftë kundër informalitetit, Investimet në kapitalin shoqëror dhe njerëzor rritje të punësimit dhe barazi gjinore, si dhe tranzicion drejt ekonomisë së gjelbër dhe dixhitale. | Po. Ky është një akt prioritar, pasi lidhetme procesin e integrimit në BE, zbatimin e OZHQ-ve dhe përmbushjen e angazhimeve ndërkombëtare në fushat e të drejtave të njeriut, sundimit të ligjit, mjedisit dhe qeverisjes demokratike | Projektakti lidhet me një sërë strategjish kombëtare dhe sektoriale, përfshirë:<br>• Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2021–2030;<br>• Strategjinë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2023–2030;<br>• Strategjinë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2024–2030;<br>• Planin e Integruar Kombëtar të Energjisë dhe Klimës;<br>• Planin Kombëtar për Barazi Gjinore dhe Fuqizimin e Grave;<br>• Strategjinë për Sundimin e Ligjit dhe Drejtësinë.<br>• Plani Kombëtar për Tranzicionin e Gjelbër dhe Mjedisin<br>• Strategjia Kombëtare për Zhvillim Rural dhe Bujqësi<br>• Plani Kombëtar për Cilësinë e Arsimit dhe Aftësitë Digjitale<br>• Etj | Ekonomik: Parashikohet ndikim pozitiv përmes rritjes së punësimit formal, produktivitetit dhe zhvillimit të qëndrueshëm.<br>Financial: Kërkon koordinim buxhetor dhe investime publike e partnere për mbështetje të reformave.<br>Social: Ndikon drejtpërdrejt në investimet në kapitalin shoqëror dhe Njerëzor, përmirësimin e barazisë, përfshirjes sociale dhe mbrojtjes së grupeve vulnerabël.<br>Mjedisor: Promovon tranzicionin e gjelbër dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore |
| 13 | Për disa ndryshime në vendimin nr.642, datë 29.10.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës”, të ndryshuar | Projektvendim | Kryeministri (SASPAC) | Katërmujori II | Projektakti parashikohet të propozohet me qëllim riorganizimin e agjencisë | | | | | | Po, ndikime të mundshme për shkak të riorganizimit |
| 14 | Për miratimin e listës së substancave ndotëse dhe vlerat kufi të emetimeve të ujërave të ndotura nga burimet industriale, si dhe listën e industrive që gjenerojnë ujëra të ndotura me ngarkesë organike | Projektvendim | Kryeministri/Zv. Kryeministri (AMBU) | Katërmujori III | Arsyet kryesore të propozimit të projektaktit lidhen me plotësimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor për menaxhimin e integruar të burimeve ujore në përgjithësi dhe përcaktimin e vlerave kufi të emetimeve për ujërat e ndotura nga burimet industriale, në veçanti, në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin Evropian. | Projektvendimi synon përcaktimin e listës së substancave ndotëse, të kushteve dhe kërkesave të veçanta për impiantet e incenerimit dhe bashkincenerimit të mbetjeve; përcaktimin e kushteve dhe kërkesave të veçanta për instalimet dhe veprimtaritë që përdorin tretës organikë, të cilat synojnë mbajtjen nën kontroll të emetimeve aksidentale, përcaktimi i kushteve dhe kërkesave të veçanta lidhur me instalimet që prodhojnë dioksid titani, përcaktimin e kritereve për identifikimin e teknikave më të mira të disponueshme lidhur me burimet ujore. | po (Kapitulli 27) | Paragrafi 5, gërma c, pika 3.6 Mbrojtja e Mjedisit dhe Ndryshimet Klimatike, Shtylla III Mirëqenie për të gjithë | SKZHI 2022-2030, Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore 2018-2035 | Jo | N/A |
| 15 | Për miratimin e kërkesave për përmbajtjen, hartimin dhe zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore, elementëve të Planeve të Menaxhimit të Baseneve Lumore, elementëve të metodologjisë për kryerjen e e vlerësimit paraprak të riskut nga përmbytjet, si dhe të elemetëve të metodologjisë për hartimin e Planeve të Menaxhimit të riskut nga përmbytjet | Projektvendim | Kryeministri/Zv. Kryeministri (AMBU) | Katërmujori III | Arsyet kryesore të propozimit të projektaktit lidhen me plotësimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor për menaxhimin e integruar të burimeve ujore në përgjithësi dhe me përcaktimin e metodologjisë së hartimit të Strategjisë Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore, Planeve të Menaxhimit të Baseneve Lumore, si dhe Planeve të Menaxhimit të riskut nga përmbytje, në përputhje me legjislacionin Evropian | Projektvendimi synon përcaktimin kërkesave për përmbajtjen, hartimin dhe zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore, elementëve të Planeve të Menaxhimit të Baseneve Lumore, elementëve të metodologjisë për kryerjen e e vlerësimit paraprak të riskut nga përmbytjet, si dhe të elemetëve të metodologjisë për hartimin e Planeve të Menaxhimit të riskut nga përmbytje. | po (Kapitulli 27) | Paragrafi 5, gërma c, pika 3.6 Mbrojtja e Mjedisit dhe Ndryshimet Klimatike, Shtylla III Mirëqenie për të gjithë | SKZHI 2022-2030, Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore 2018-2036 | Jo | N/A |
| 16 | Për miratimin e kërkesave dhe standardeve të projektimit, ndërtimit dhe mirëmbajtjes së sistemeve të kanalizimeve,kriteret e shkarkimeve nga impiantet e trajtimit të ujërave të | Projektvendim | Kryeministri/Zv. Kryeministri (AMBU) | Katërmujori III | Arsyet kryesore të propozimit të projektaktit lidhen me plotësimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor për menaxhimin e integruar të burimeve ujore në përgjithësi dhe të kërkesave dhe standardeve të projektimit, ndërtimit dhe mirëmbajtjes së | Projektvendimi synon përcaktimin e kërkesave dhe standardeve të projektimit, ndërtimit dhe mirëmbajtjes së sistemeve të kanalizimeve,kriteret e shkarkimeve nga impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura urbane, si dhe kriteret e identifikimit të zonave të ndjeshme dhe | po (Kapitulli 27) | Paragrafi 5, gërma c, pika 3.6 Mbrojtja e Mjedisit dhe Ndryshimet Klimatike, Shtylla III Mirëqenie për të gjithë | SKZHI 2022-2030, Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore 2018-2037 | Jo | N/A |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | ndotura urbane, si dhe kriteret e identifikimit të zonave të ndjeshme dhe më pak të ndjeshme | | | | sistemeve të kanalizimeve, kriteret e shkarkimeve nga impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura urbane, si dhe kriteret e identifikimit të zonave të ndjeshme dhe më pak të ndjeshme, në veçanti në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin Evropian. | më pak të ndjeshme | | | | | |
| 17 | Për miratimin e kitereve e kërkesave për mbrojtjen e ujërave nga nitratet me origjinë bujqësore, elementëve minimalë që duhet të përmbajë kodi I praktikave të mira bujqësore, elementet udhëzuese për identifikimin e masave, të cilat do të përfshihen në programet e veprimit lidhur me zonat e shpallura vulnerabël, si dhe të metodave referncë të matjeve | Projektvendim | Kryeministri/Zv. Kryeministri (AMBU) | Katërmujori III | Arsyet kryesore të propozimit të projektaktit lidhen me plotësimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor për menaxhimin e integruar të burimeve ujore në përgjithësi dhe e kitereve e kërkesave për mbrojtjen e ujërave nga nitratet me origjinë bujqësore, elementëve minimalë që duhet të përmbajë kodi I praktikave të mira bujqësore, elementet udhëzuese për identifikimin e masave, të cilat do të përfshihen në programet e veprimit lidhur me zonat e shpallura vulnerabël, si dhe të metodave referncë të matjeve, në veçanti në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin Evropian. | Projektvendimi synon të përcaktojë kiteret e kërkesat për mbrojtjen e ujërave nga nitratet me origjinë bujqësore, përcaktimin e elementëve minimalë që duhet të përmbajë kodi I praktikave të mira bujqësore, që synojnë zvogëlimin e ndotjes nga nitratet dhe marrjen parasysh të kushteve të rajoneve të ndryshme, përcaktimin e elementëve udhëzuese për identifikimin e masave, të cilat do të përfshihen në programet e veprimit lidhur me zonat e shpallura vulnerabël, si dhe të metodave referncë që aplikohen për të matjet. | po (Kapitulli 27) | Paragrafi 5, gërma c, pika 3.6 Mbrojtja e Mjedisit dhe Ndryshimet Klimatike, Shtylla III Mirëqenie për të gjithë | SKZHI 2022-2030, Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore 2018-2038 | Jo | N/A |
| 18 | Per kerkesat e sigurise kibernetike per produktet me elemente digjitale dhe qendrueshmerine kibernetike | Projektligj | Kryeministri/Zv. Kryeministri (AKSK) | Katërmujori III | | Projektligji transpozon Rregulloren e BE nr.2024/2847 mbi kerkesat horizontale te sigurise kibernetike per produktet me elemente digjitale dhe ndryshimin e rregullores se BE nr.168/2013 dhe 2019/1020 dhe Direktives 2020/1828 | N/A | N/A | N/A | N/A | N/A |
| 19 | Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në RSH | Projektvendim | Kryeministri/Zv. Kryeministri (ASHK) | Katërmujori III | Në funksion të përmirësimit të punës dhe ecurisë së veprimtarisë së ASHK dhe detyrimeve që burojnë nga ligji nr.111/2018 " Për Kadastrën", neni 9, pika 2, germa k. | Përcaktojë hartën e vlerës së tokës në RSH (pasurive të paluajtshme truall, tokë bujqësore, pyll, livadh, kullote), në zbatim të nenit 9/2/k të ligjit nr.111/2018 "Për Kadastrën" | Jo | Përputhet me programin politik të qeverisë dhe konkretisht me kreun "Kreun "Administratës Publike, Antikorrupsioni dhe Transparenca" (faqe 15) | PO | Miratimi i këtij projektakti është në funksion të zbatimit të Strategjise ndersektoriale " Reforma në fushën e të drejtave të pronësisë në vitin 2012-2020(kapitulli II) | Po, ndikim financiar dhe social |
| 20 | Për përcaktimin e mënyrës së ofrimit të shërbimeve elektronike për subjektet private | Projektvendim | Kryeministri/Zv. Kryeministri (AKSHI) | Katërmujori III | Harmonizimi me kuadrin ligjor mbi qeverisjen elektronike.Projektakti propozohet për të zbatuar dispozitat e Ligjit nr. 43/2023 “Për Qeverisjen Elektronike”.Unifikimi i proceseve dhe shmangia e praktikave të ndryshme.Nevoja për standarde të njëjta cilësie dhe sigurie Shërbimet elektronike që ofrohen nga subjektet private duhet të respektojnë standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të sigurisë, aksesueshmërisë dhe cilësisë së shërbimit. | Ky akt synon të:<br>Lehtësojë aksesin e bizneseve dhe subjekteve private në shërbimet publike;<br>Ulë burokracitë dhe kohën e shërbimit;<br>Nxisë digjitalizimin e marrëdhënieve shtet-privat;<br>Harmonizojë ofrimin e shërbimeve me standardet e BE-së për qeverisje elektronike dhe ekonomi digjitale | Jo | N/A | N/A | N/A | N/A |
| 21 | Rregullat e Harmonizuara te Inteligjences Artificiale | Projektligj | Kryeministri/Zv. Kryeministri (AKSHI) | Katërmujori III | Vendosjen e rregullave te harmonizuara mbi perdorimin e AI-S.Transpozimin e rregullores (EU) 2024/1689 of the European Parliament and of the Council of 13 June 2024 | Qëllimi i kësaj Rregulloreje është përmirësoje funksionimin e tregut të brendshëm përmes vendosjes së një kuadri të unifikuar ligjor, në veçanti për zhvillimin, hedhjen në treg, vënien në funksion dhe përdorimin e sistemeve të inteligjencës artificiale (sistemeve AI) të besueshme dhe të përqendruar te njeriu, duke garantuar një nivel të lartë të mbrojtjes së shëndetit, sigurisë dhe të drejtave themelore | Po Kapitulli 10 | https://eur-lex.europa.eu/eli/reg/2024/1689/oj/eng | N/A | N/A | N/A |
| 22 | Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 451, datë 3.7.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për Rregullat Uniforme të Infrastrukturës së Informacionit Gjeohapësinor” | Projektvendim | Kryeministri-Zëvendëskryeministri (ASIG) | Katërmujori III | Përdorimi i Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor nga autoritetet publike për vendimmarrje të drejta dhe të shpejta në kryerjen e fuksioneve të tyre publike.<br>Rritja e eficences dhe performancës së strukturave GIS në autoritetet publike. | 1-Detyrimi i përdorimit nga autoritetet publike të informacionit gjeohapësinor zyrtar, të përditësuar dhe standardizuar (te marrë nga sistemet dhe aplikacionet e ASIG).<br>2-Krijimi i strukturave të dedikuara GIS ne autoritetet publike përgjegjëse dhe trajnimi i strukturave që përdorin informacionin gjeohapësinor në institucionet publike. | Jo | Shtylla 1, Pika 1.2 Shteti Digjital dhe Siguria Kibernetike | Jo | Dokumenti I politikave “Për Qeverisjen e Sektorit të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri, 2020-2030”, miratuar me VKM Nr. 402, datë 20.05.2020. | Jo |
| 23 | Për miratimin e Planit Strategjik dhe Planit të Veprimit për Avokaturën e Shtetit | Projektvendim | Kryeministri - Zv./Kryeministri (Avokatura e Shtetit) | Katërmujori III | Nëpërmjet këtj projektvendimi synohet miratimi i planit strategjik dhe planit të veprimit të përgatitur nga Projekti IPA, gjatë periudhës 18 mujore të veprimtarisë së mbështetjes së Avokaturës së Shtetit për të sjellë praktikat gjyqësore në përputhje me praktikat më të mira të BE-së, dhe standardet e të drejtave të njeriut. | Nëpërmjet miratimit të planit strategjik dhe planit të veprimit për Avokaturën e Shtetit, lejohet fillimi i procesit të implementimit të hapave të përcaktuara në këtë plan, të cilat përfshijnë ndryshime ligjore dhe nënligjore në kuadrin ligjor për Avokaturën e Shtetit si dhe, parashikojnë gjithashtu investime në sisteme digjitale dhe në logjistikë, të cilat shoqërohen me efekte financiare.<br>Ky projektakt, është e nevojshme të përgatitet në bashkëpunim me SASPAC, Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Drejtësisë, në mënyrë që përmbajtja e Planit Strategjik të përshtatet dhe koordinohet me Programin Qeverisës 2025-2029. | Jo | Jo | Jo | Po | N/A |
| 24 | Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Ekonomisë Blu 2025 -2030 | Projektvendim | Kryeministri (SASPAC) | Katërmujori III | Arsyeja kryesore eshte rregullimi ligjor i sektorit te marinave dhe potenciali I identifikuar per zhvillim dhe bashkepunim nderkombetar qe kane sektori i detarisë, turizmit blu,peshkimit, ushqimeve te detit etj. | Rregullon Zhvillimin dhe transformimin e ekonomisë detare të Shqipërisë në një kontribues kryesor të rritjes së qëndrueshme duke rikthyer traditën e lundrimit dhe mbështetur zhvillimin e turizmit detar, peshkimit, ate sportive dhe argëtuese me mekanizma dhe mjete të | Jo specifikisht por lidhet ngushtesisht me kapitujt 13: Peshkimi, 14: Politikat e Tansportit, 19: Politika sociale dhe Punesimi, 22: Politikat e zhvillimit Rajonal, 27: Mjedisi, 20: Politikat Industriale, 8: Politika e Konkurences etj | Faqe 23 e Programit.. "Objektiv Strategjik I Qeverise Shqiptare per zhvillimin e transportit detar.. Komplementimit me zona te zhvillimit ekonomik.. Akomodimin dhe sherbimet per mjetet lundruese turistike… | Jo | SKZHIE 2021-2030 : S3 Specializimi Inteligjent, Agjenda e Konektivitetit (Shtylla nr 3): Ekonomia Blu, Str per Zhv e Turizmit 2019-2023 obj 2.3, 3.1, Str Sektoriale e Transportit | Pozitive (impakte te pergjithshme)1. Rritja e nder-konektivitetit (nderlidhjeve) 2. Rritja ekonomike (dhe e Punesimit), 3. Rritje e Energjise se |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | pajtueshme me mjedisin në të gjithë bregdetin. | | | | 2021 (1.1 Sisteme eficente portuale dhe te marinave), SDG 8, SDG 14: Ruajtja dhe perdorimi I qendrueshem I oqeaneve, deteve dhe burimeve te marinave) | Rinovueshme, 4. Zhvillim I peshkimit (eksporteve nga 130 mln USD (2021 ne 200 mln USD ne 2030, KPI SKZHIE III), sigurise ushqimore dhe akuakultures, Negative (impakte te pergjithshme) 1. Mbi-peshkimi , 2. Degradimi i Habitatit, 3. Disbalanca ne tregti ( pjesa detare me pjesen tokesore te nje vendi) 4. Zhvillimi ad hoc i paplanifikuar mire midis bregdetit dhe tokes, 5. Rritja e kostove te jeteses per komunitetin qe nuk perfshihet, ose per peshkataret e vegjel artizane etj.. |
| 25 | Rishikimi afatmesem i SKZHIE 2022 -2030 | Projektvendim | Kryeministri (SASPAC) | Katërmujori III | Linjezimi me i mire afatmesem, me objektiva afatmesme dhe indikatore per 2027, me programin e ri te qeverise 2025-2029, me procesin e pershpejtuar te negociatave per integrimin evropian 2026-2027, perditesim i objektivave per disa sektore prioritare per te adresuar me mire dhe ne menyre me dinamike objektivat e zhvillimit te vendit deri 2030 | Rishikon objektivisht permbajtjen e objektivave te zhvillimit per sektoret prioritare te zhvillimit te vendit duke formuluar objektiva afatmesem per 2027, ne linje me vizionin e SKZHIE per 2030. Rishikon KPI per periudhen afatmesme (2027) si dhe harmonizohet me mire me programin e ri qeveritar 2025-2029. Konstaton mesime nga eksperienca dhe monitorimi afatmesem qe do reflektohen ne informimin me realist dhe koherent te planifikimit strategjik dhe vendimmarrjes. Linjezim me i mire me kerkesat e integrimit (2026-2027) dhe udherrefyesin e SDG 2025-2030. | Jo | Po, rishikimi i dokumentit ka pikerisht nje nga motivet kryesore linjezimin/perputhjen me objektive me programin 2029, nderkohe qe lidhja me programin e meparshem qeveritar 2025 eshte ekzistuese dhe nevojitet perditesim afatmesem | Po | SKZHIE 2030, rishikim afatmesem (mid term review) | Ndikimi kryesor konsiston në balancimin e progresit ndërmjet sektorëve prioritarë, veçanërisht në adresimin e zhvillimit jo simetrik ndërsektorial. Disa sektorë kanë shënuar përparim më të shpejtë, siç është turizmi, ndërsa sektorë të tjerë kërkojnë nxitje më të forta dhe të synuara, si psh bujqësia. Në këtë kontekst, ruajtja e realizmit dhe relevances së indikatorëve strategjikë, në raport me dinamikat dhe kërkesat ne ndryshim të zhvillimit, përbën një domosdoshmëri për efektivitetin optimal te politikave prioritare shteterore. Njëkohësisht, përmes linjëzimit më të fortë me procesin e integrimit evropian, zhvillimi i brendshëm unifikohet më ngushtë me kërkesat e negociatave të anëtarësimit. Kjo qasje çon drejt një procesi sintezë, ku reformat e brendshme harmonizohen me kerkesat e integrimit evropian dhe me Agjendën e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG), duke rritur cilesisht koherencën dhe ndikimin afatgjatë të reformave. |

## PPAP 2026
## Ministria e Infrastruktures dhe Energjise

| Nr. | Titulli i projektaktit | Lloji i projektaktit | Ministri propozues | Katërmujori | Arsyet kryesore për propozimin e projektaktit | Çështjet kryesore që parashikon të rregullojë projektakti | A është parashikuar projektakti në PKIE? Nëse po, të specifikohet kapitulli përkatës | Përputhshmëria e projektaktit me programin politik qeverisë 2025-2029<br>Nëse përputhet, të jepet referenca e saktë në progam | A është akt i një rëndësie të veçantë e prioritare? | Lidhja e projektaktit me strategjitë kombëtare dhe sektoriale<br>Nëse lidhet, të specifikohen strategjitë | Ndikimet e mundshme ekonomike, financiare, sociale dhe mjedisore<br>Përgjigjuni me Po/Jo për ndikimet përkatëse |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 943, datë 28.12.2016, "Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim" | Projektvendim | Ministria e Infrastruktures dhe Energjise | Katërmujori I | Per te reflektuar menyren e aplikimit nepermjet sistemit elektronik te licencave ne rregulloren e kritereve dhe procedurave te dhenies se liçencave profesionale ne fushen e studimit e te projektimit ne ndertim dhe mbikqyerjes e kolaudimit te punimeve te zbatimit ne ndertim. | Ndryshimi I menyres se aplikimit dhe rishikimi I afateve dhe procedurave ne perputhje me sistemin elektronik te liçencave | Jo | Jo | Jo | Jo | Jo |
| 2 | "Per Miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin e Sektorit Minerar 2026-2040" | Projektvendim | Ministria e Infrastruktures dhe Energjise | Katërmujori I | Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Sektorit Minerar 2026–2040 vendos një kuadër të ri kombëtar për modernizimin, transformimin dhe integrimin e industrisë minerare shqiptare në standardet dhe tregjet e Bashkimit Evropian. Në një kohë kur lëndët e para kritike (CRM) janë shndërruar në një prioritet strategjik global për tranzicionin e gjelbër dhe dixhital, kjo strategji synon të pozicionojë Shqipërinë si një vend me rëndësi të veçantë për furnizimin rajonal dhe evropian me minerale të sigurta, të qëndrueshme dhe konkurruese | / | Jo | Jo | Jo | Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Sektorit Minerar 2026-2040 | Jo |
| 3 | Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin për sektorin e energjisë elektrike Nr. 43/2015, i ndryshuar" | Projektligj | Ministria e Infrastruktures dhe Energjise | Katërmujori I | Transpozim i Direktivës (BE) 2019/944 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 5 qershor 2019 mbi rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të energjisë elektrike dhe ndryshimin e Direktivës 2012/27/BE, Rregullores (BE) 2019/943 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 5 qershor 2019 mbi tregun e brendshëm të energjisë elektrike, Rregullores (BE) 2019/941 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 5 qershor 2019 mbi gatishmërinë ndaj rrezikut në sektorin e energjisë elektrike dhe shfuqizimin e Direktivës 2005/89/EC dhe Rregullores ACER- Rregullorja 2019/942 për krijimin e Agjencisë së Bashkimit Evropian për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë | Ky projektligj parashikon përcaktimin e rregullave të përbashkëta për prodhimin, transmetimin, shpërndarjen dhe furnizimin me energji elektrike, së bashku me dispozitat për mbrojtjen e konsumatorit, me qellim krijimin e kushteve për një treg të integruar të energjisë elektrike në rajon si dhe përmirësimin e sigurisë së furnizimit dhe funksionimin e përgjithshëm të sistemit energjetik të Shqipërisë, miratimin e rregullave për sigurinë e furnizimit me energji elektrike të cilat përfshijnë masat që duhet të ndërmerren në rastet e situatave emergjente, rolin dhe detyrimet e pjesëmarrësve të tregut të energjisë elektrike në lidhje me sigurinë e furnizimit me energji elektrike dhe parashikon të përmirësojë koordinimin ndërmjet autoriteteve rregullatore të energjisë të vendeve të ndryshme për çështjet ndërkufitare. | Po, Kapitulli 15 | Shtylla II- Rritja ekonomike e qëndrueshme - energjia | Po, projektiakti është detyrim në kuadër të transpozimit të Acquis por edhe sepse përfshihet në Reform Agenda | Strategjia Kombëtare e Energjisë 2018-2030, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 480, datë 31.07.2018. Vendimit te Këshillit të Ministrave nr. 872 datë 29.12.2021 "Për miratimin e Planit Kombëtar i Energjisë dhe Klimës 2020-2030 | Po |
| 4 | "Per Miratimin e Strategjisë Kombëtare Sektoriale të Transportit 2030" | Projektvendim | Ministria e Infrastruktures dhe Energjise | Katërmujori I | Strategjia Kombëtare Sektoriale e Transportit 2030 synon të sigurojë një kuadër gjithëpërfshirës për të udhëhequr zhvillimin, modernizimin dhe qëndrueshmërinë e sektorit të transportit, duke siguruar përafrimin me qëllimet kombëtare të zhvillimit dhe praktikat më të mira ndërkombëtare. Strategjia do të adresojë sfidat aktuale, do të parashikojë kërkesat e ardhshme dhe do të integrojë zgjidhje inovative për të krijuar një rrjet transporti te pershtatshem dhe efikas. | Kjo strategji do të përafrohet me prioritetet kombëtare, rajonale dhe të BE-së në fushën e transportit si dhe me Axhendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor 2020, Planin e Investimeve Ekonomike të BE-së për Ballkanin Perëndimor, Strategjinë për Transport të zgjuar dhe të Qëndrueshëm për Ballkanin Perëndimor, përfshirë dhe planet e veprimit të Traktatit të Komunitetit të Transportit. | Po, Kapitulli 14 "Politikat e transportit" | Jo | Dokumenti i Politikave te Transportit dhe rekomandimi i vazhdueshem i progres raporteve | Strategjia Kombëtare Sektoriale e Transportit 2030 | Jo |
| 5 | "Per disa ndryshime dhe shtesa në VKM Nr. 153, date 7.4.2000", I ndryshuar | Projektvendim | Ministria e Infrastruktures dhe Energjise | Katërmujori I | Ne Pozicionin e Komisionit Evropian per kapitullin 14 te politikave te transportit eshte nenvizuar nevoja e linjezimit te direktivave qe kane te bejne me sigurine rrugore, posaçërisht Direktiva mbi shkembimin e informacionit nderkufitar ne lidhje me kundravatjet e sigurise rrugore, direktiva 2015/413. | Projektakti do te synoje te perafroje plotesisht direktiven 2015/413, ne evidentimin dhe ndjekjen e shkeljeve te shtetasve te huaj qe qarkullojne me mjeteve ne territorin e Shqiperise dhe anasjelltas, duke percaktuar procedurat dhe menyrat e shkembimit te informacionit te nevojshem midis shteteve permes | Jo | Shtylla I, pika 1.7, pika c, paragrafi 3 | Closing Benchmarks | Jo | Jo |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | pikave te kontaktit. | | | | | |
| 6 | Per kriteret e qëndrueshmëris per biokarburantet dhe lëndët djegëse të rinovueshme për transport. | Projektvendim | Ministria e Infrastruktures dhe Energjise | Katërmujori I | Detyrimi i lindur nga zbatimi i ligjit nr. 46/2025 Për prodhimin , transportimin, tregtimin dhe perdorimin e biokarburanteve dhe te lendeve te tjera djegse, te rinovushme per transport. | Me kete projektakt sunohet te rregulloeht, qëndrueshmëria dhe reduktimi i emetimeve të gazeve serrë për biokarburantet Biokarburantet dhe lëndët djegëse, të rinovueshme për transport, të prodhuara nga mbetje të tjera nga mbetjet bujqësore, akuakulturore, nga peshkimi dhe nga mbetjet e pyjeve, duhet të përmbushin vetëm kriteret e reduktimit të emetimeve të gazeve serrë. | Po, Kapitulli 15 | Jo | Po | Vendim nr. 480, datë 31.7.2018 "Për miratimin e strategjisë kombëtare të energjisë për periudhën 2018–2030" | Po |
| 7 | Per reduktimit të emetimeve të gazeve serrë nga perdorimi I biokarburanteve | Projektvendim | Ministria e Infrastruktures dhe Energjise | Katërmujori I | Detyrimi i lindur nga zbatimi i ligjit nr. 46/2025 Për prodhimin , transportimin, tregtimin dhe perdorimin e biokarburanteve dhe te lendeve te tjera djegse, te rinovushme per transport. | Me kete projektakt sunohet te rregulloeht, qëndrueshmëria dhe reduktimi i emetimeve të gazeve serrë për biokarburantet Biokarburantet dhe lëndët djegëse, të rinovueshme për transport, të prodhuara nga mbetje të tjera nga mbetjet bujqësore, akuakulturore, nga peshkimi dhe nga mbetjet e pyjeve, duhet të përmbushin vetëm kriteret e reduktimit të emetimeve të gazeve serrë. | Po, Kapitulli 15 | Jo | Po | Vendim nr. 480, datë 31.7.2018 "Për miratimin e strategjisë kombëtare të energjisë për periudhën 2018–2030" | Po |
| 8 | Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr. 54/2024 Per komunikimet elektronike ne RSH | Projektligj | Ministria e Infrastruktures dhe Energjise | Katërmujori I | Harmonizimi me Rregulloren e BEREC me qellim mundesimin e zbatimit te RLAH mes BE dhe Shqiperise | Parashikimi i pjesemarrjes se AKEP ne funksiomin e BEREC dhe organet e BEREC, shkembimi i informacionit me BEREC si dhe nxjerrjes se akteve nenligjore te nevojshme per zbatimin e rregullimit te roamingut me BE - RLAH mes BE dhe Shqiperise | Jo | Jo | Po | Jo | Jo |
| 9 | "Per Tregun Digjital ne Republiken e Shqiperise" | Projektligj | Ministria e Infrastruktures dhe Energjise dhe Ministri i Ekonomisë dhe Inovacionit | Katërmujori I | Harmonizimi i "Rregullores se tregjeve digjitale (DMA)"te BE ne legjislacionin kombetar | Te siguroje konkurrence te drejte dhe te hapur ne tregun digjital, duke kufizuar fuqine e platformave shume te medha online. | Po, Kapitulli 10 | Jo | Jo | Jo | Jo |
| 10 | "Per lirimin e Digital Divident 2" | Projektligj | Ministria e Infrastruktures dhe Energjise dhe Ministria e Financave | Katërmujori I | Zbatimi i UHF Decision, pjese e piketave permbyllese te Kapitullit 10 | Mundesimin e realizimit te lirimit te frekuencave te brezit 700 MHz, DD2 dhene ne perdorim per sherbime televizive per rrjetet numerike | Po, Kapitulli 10 | Po | Po | Po, VKM 436/2020; VKM 636/2020 | Po |
| 11 | Per procedurat e rinovimit te te drejtave te perdorimit te dhena me konkurim | Projektvendim | Ministria e Infrastruktures dhe Energjise | Katërmujori I | Plotesim i kudrit nenligjor, ligji 54/2024 Per komunukimet elektronike ne RSH | / | Jo | Jo | Jo | Jo | Jo |
| 12 | Për produktet e ndërtimit | Projektligj | Ministria e Infrastruktures dhe Energjise | Katërmujori II | Përafrimit i rregullores nr. 2024/3110/EU | Ky projektakt synon lëvizjen e lirë të mallrave dhe heqjen e barrierave në tregti, funksionimin eficent të tregut, duke siguruar vendosjen dhe bërjen e disponueshme në treg të produkteve të ndërtimit të sigurta dhe të qëndrueshme. Gjithashtu synon të kontribuoje në objektivat e dixhitalizimit dhe të një ekonomie të gjelbër, duke parandaluar dhe zvogëluar ndikimin e produkteve të ndërtimit në mjedis, sigurinë dhe shëndetin e njerëzve. | Po, Kapitulli I | Jo | Jo | Jo | Po |
| 13 | "Per miratimin e Aktit te Infrastruktures Gigabit" | Projektligj | Ministria e Infrastruktures dhe Energjise | Katërmujori II | Harmonizim i rregullores se BE "Mbi masat per reduktimin e kostove per shtrirjen e rrjeteve te komunikimit gigabit"/Akti Infrastruktures Digjitale, ne legjislacionin kombetar | Pershpejtimin e ndertimit te rrjeteve te infrastruktures Gigabit, VHCN duke ulur kostot e ndertimit, reduktuar burokracite dhe vonesat dhe lejet per ndertimin e rrjeteve dhe nxitur bashkeperdorimin e infrastrukturave te perbashketa | Po, Kapitulli 10 | Jo | Jo | Jo | Jo |
| 14 | Per politiken e zbatimit te RLAH | Projektvendim | Ministria e Infrastruktures dhe Energjise | Katërmujori II | Harmonizimin e Rregullores 2022/612/EU per roamingun RLAH ne BE | E lidhur me zbatimin e RLAH me BE ne 2026 | Po, Kapitulli 10 | Jo | Jo | Jo | Jo |
| 6 | Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 420, datë 8.6.2016, "Për miratimin e Ceremonialit Shtetëror të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar | Projektvendim | Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme | Katërmujori I | Harmonizimin e dispozitave ekzistuese me ndryshimet e fundit të ndodhura në legjislacionin shqiptar, bazuar në nenin 17, të ligjit 23/2025 | Përditësimin e rregullave të ceremonialit shtetëror, sidomos për mënyrën e organizimit të ceremonive të dhënies së titujve të nderit dhe zbatimin e praktikave bashkëkohore protokollare, referuar ligjit nr. 94/2022 "Për titujt e nderit dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë", dhe VKM-së nr. 819, datë 26.12.2024, "Për miratimin e rregullores së Kancelarisë së Urdhrave dhe Medaljeve". | Jo | Po, Shtylla I "Shqiperia evropiane" dhe 1.5 "Politika e jashtme dhe diaspora" | Jo | Jo | Po, ndikime financiare dhe sociale |
| 7 | "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2026-2030" | Projektvendim | Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme | Katërmujori II | Strategjia Kombëtare e Diasporës 2021–2025", është miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr.585 datë 22.07.2020. Strategjia përcakton parimet e politikës shtetërore të Republikës së | Strategjia Kombëtare e Diasporës do të përqëndrohet në një strukturë objektivash strategjikë dhe shoqërohet nga plani i saj i veprimit. Propozohet të hartohet në përputhje | Jo | Po, Shtylla I "Shqiperia evropiane" dhe 1.5 "Politika e jashtme dhe diaspora" | Po | 1)- Strategjia Kombëtare e Zhvillimit të Sipërmarrjes Inovative 2024-2030;<br>2)- Strategjia Kombëtare | Jo |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | Shqipërisë për mbështetjen e komuniteteve shqiptare që jetojnë në vendet pritëse në mënyrë të ligjshme. Vizioni i saj ka për synim rivlerësimin e angazhimit të diasporës duke u bazuar në strukturën e marrëdhënieve aktuale të shtetit shqiptar me diasporën.<br>Kjo Strategji është në vitin e fundit të zbatimit të saj dhe në vitin 2026 lind domosdoshmëria e miratimit dhe zbatimit të Strategjisë së re për Diasporën, bazuar ne pikën a dhe b të nentit 5, ligji 16/2028 | me Udhëzuesin e Bashkimit Evropian për Politikat dhe me standardet ndërkombëtare dhe Paktin Global për Migracionin. Strategjia synon të krijojë mekanizma, të cilat do të mbështesin komunitetet shqiptare në diasporë si edhe do të nxisë angazhimin bashkëpunues të institucioneve shtetërore.<br>Objektivat kryesorë janë:<br>• Përshtatja e ndryshimeve ligjore me nivelin e politikbërjes.<br>• Angazhimi i strukturave shtetërore të krijuara për të përmirësuar dhe fuqizuar bashkëpunimin me komunitetet shqiptare në diasporë.<br>Çështjet kryesore që parashikon të rregullojë projekt akti:<br>• Marrëdhënia shtetërore me diasporën<br>• Organizimi i diasporës<br>• Ekonomia, biznesi dhe Inovacioni<br>• Arsimi dhe mësimdhënia<br>• Media dhe komunikimi<br>• Monitorimi dhe transparenca | | | | për Migracionin 2024-2030 ; 3)- S3-Strategjia e Specializimit Ineligjent | |
| 8 | Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 339, datë 06.06.2018 të Këshillit të Ministrave"Për kriteret dhe mënyrën e ndarjes së çmimit "Ambasador i Kombit". | Projektvendim | Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme | Katërmujori II | Këshilli i Ministrave ka miratuar Vendimin nr. 510, datë 25.9.2025 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme" sipas të cilit MEPJ caktohet si institucion përgjegjës për diasporën.<br>Në këto kushte, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme i lind detyrimi për të bërë një screening / analizë të kuadrit ligjor në fuqi për çështjet e diasporës, duke mbajtur në konsideratë politikën shtetërore dhe objektivat e MEPJ-së për diasporën.<br>Projekt Vendimi propozohet të avancohet pas miratimit të Projektligjit për disa shtesa dhe ndryshime në (neni 15) Ligjin nr. 16/2018 "Për Diasporën" me subjekt propozues MEPJ. | Projekt akti nënligjor synon të zgjerojë kategorinë e çmimeve që mund ti akordohen personaliteteve apo individëve të suksesshëm në diasporë, të cilët kanë dhënë dhe vijojnë të japin kontribut të qënësishëm në promovimin e Shqipërisë në arenën ndërkombëtare apo përmes arritjeve të tyre lartësojnë emrin shqiptar kudo në botë. Duke patur një gamë të gjerë të fushave në të cilat shqiptarët spikasin dhe janë të suksesshëm Vendimi i Këshillit të Ministrave aktualisht në zbatim, ka nevojë për disa shtesa pasi është i kufizuar vetëm në një lloj çmimi atë të Ambasador Kombi.<br>Konkluzion : Për këtë qëllim lind nevoja për zgjerim të çmimeve të akorduara duke mos u kufizuar vetëm në akordimin e çmimit të Abasador Kombi por të pasurohet dhe me kategori të tjera çmimesh. | Jo | Po, Shtylla I "Shqiperia evropiane" dhe 1.5 "Politika e jashtme dhe diaspora" | Po | 1)- Strategjia Kombëtare e Zhvillimit të Sipërmarrjes Inovative 2024-2030;<br>2)- Strategjia Kombëtare për Migracionin 2024-2030 ; 3)- S3-Strategjia e Specializimit Ineligjent | Jo |
| 9 | "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 470, datë 26.07.2018 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrave Kulturore për Diasporën". | Projektvendim | Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme | Katërmujori III | Këshilli i Ministrave ka miratuar Vendimin nr. 510, datë 25.9.2025 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme" sipas të cilit MEPJ caktohet si institucion përgjegjës për diasporën.<br>Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme ka propozuar Projektligj për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 16/2018 "Për Diasporën" . Për rrjedhojë miratimi i mundshëm i Projektligjit në fjalë pasjell nevojën e harmonizimit dhe përpuethshmërisë me aktet nenligjore të nxjerra në zbatim të tij.<br>Projekt Vendimi propozohet të paraqitet pas miratimit të amendimeve në Ligjin nr. 16/2018 "Për Diasporën" dhe në Ligjin nr.23/2015 " Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", referuar pikës d, neni 5, të ligjit 16/2028. | Projekt akti synon të qartësojë mënyrën e funksionimit, varësinë dhe mënyrën e financimit të Qendrave Kulturore për Diasporën, të cilat konsiderohen vatër e përhapjes së kulturës shqiptare në diasporë.<br>Qendrat luajnë rol thelbësor së bashku me institucionet përgjegjëse për diasporën në: ruajtjen, kultivimin e identitetit kombëtar, gjuhësor, kulturor e arsimor të diasporës si dhe kontribuojnë drejtpërdrejtë në forcimin e lidhjeve të saj me institucionet e Republikës së Shqipërisë. Rregullimi i aspekteve të funksionimit të Qendrave Kulturore për Diasporën konsiderohet me rëndësi, pasi ato paraqesin një mekanizëm përmes të cilit, shteti shqiptar lobon për përhapjen e kulturës shqiptare në diasporë. | Jo | Po, Shtylla I "Shqiperia evropiane" dhe 1.5 "Politika e jashtme dhe diaspora" | Po | 1)- Strategjia Kombëtare e Zhvillimit të Sipërmarrjes Inovative 2024-2030;<br>2)- Strategjia Kombëtare për Migracionin 2024-2030 ; 3)- S3-Strategjia e Specializimit Ineligjent | Po, ndikime sociale |
| 10 | Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 120, datë 6.3.2024 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës" | Projektvendim | Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme | Katërmujori III | Këshilli i Ministrave ka miratuar Vendimin nr. 510, datë 25.9.2025 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme" sipas të cilit MEPJ caktohet si institucion përgjegjës për diasporën.<br>Ndryshimet e propozuara kanë për objekt kreun III, pika 2 të VKM nr. 120, datë 6.3.2024 dhe synojnë të harmonizojnë dhe reflektojnë objektivat për diasporën e cilësuara në programin qeverisë 2025-2029 ku politika e jashtme dhe diaspora konsiderohen ura jonë me botën, e në veçanti zgjerimin e përgjegjësive funksionale dhe lidhjen e diasporës me inovacionin dhe teknologjinë, për të tërhequr profesionistë dhe ekspertizë, duke ndërtuar ura mes talenteve jashtë vendit dhe mundësive ekonomike në Shqipëri si dhe mundësinë e rikthimit të talenteve. Ndryshimet prekin edhe kompetencën territoriale të ushtrimit të veprimtarisë së AKD si një institucion varësie i specializuar për marrëdhënet me diasporën, duke e zgjeruar atë dhe jashtë vendit në koordimim me përfaqësitë tona diplomatike,<br>Gjithashtu, ndryshimet e propozuara | Zgjerimin e përgjegjësive funksionale dhe lidhjen e diasporës me inovacionin dhe teknologjinë, për të tërhequr profesionistë dhe ekspertizë, duke ndërtuar ura mes talenteve jashtë vendit dhe mundësive ekonomike në Shqipëri si dhe mundësinë e rikthimit të talenteve. Ndryshimet prekin edhe kompetencën territoriale të ushtrimit të veprimtarisë së AKD si një institucion varësie i specializuar për marrëdhënet me diasporën, duke e zgjeruar atë dhe jashtë vendit në koordimim me përfaqësitë tona diplomatike,<br>Gjithashtu, ndryshimet e propozuara prekin dhe aspekte organizative dhe menxhuese: që lidhen me shërbimet e brendshme dhe menaxhimin financiar sanksionuar në kreun III pika 5 të cilat propozohen të vazhdojnë të kryhen nga vetë Agjencia Kombëtare e Diasporës për vetë faktin që diaspora shqiptare gjendet e përqëndruar në shtete të ndryshme dhe paraqet sfida dhe çështje komplekse të cilat duhet të | Jo | Po, Shtylla I "Shqiperia evropiane" dhe 1.5 "Politika e jashtme dhe diaspora" | Po | 1)- Strategjia Kombëtare e Zhvillimit të Sipërmarrjes Inovative 2024-2030;<br>2)- Strategjia Kombëtare për Migracionin 2024-2030 ; 3)- Strategjia e Specializimit Ineligjent | Po, ndikime financiare dhe sociale |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | prekin dhe aspekte organizative dhe menxhuese: që lidhen me shërbimet e brendshme dhe menxhimin financiar sanksionuar në kreun III pika 5 të cilat propozohen të vazhdojnë të kryhen nga vetë Agjencia Kombëtare e Diasporës. Kjo synohet të reflektohet më pas dhe në strukturën e re të AKD. | trajtohen në kohë reale dhe pa vonesa. Kjo synohet të reflektohet më pas dhe në strukturën e re të AKD. | | | | | |
| 11 | Për disa ndryshime në vendimin nr. 504, datë 24.6.2020 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të studentëve të cilët studiojnë jashtë vendit" | Projektvendim | Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme | Katërmujori III | Propozimi për ndryshime në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 504, datë 24.6.2020 synon të qartësojë përgjegjësitë e institucioneve të ngarkuara me zbatim duke revokuar përgjegjësinë e MEPJ/AKD në këtë proces. Konkretisht, propozimi mbështetet në vetë faktin që Ministria e Arsimit është institucion përgjegjës për çështjet e arsimit dhe disponon të dhëna të plota dhe të sakta për studentët shqiptarë që studiojnë jashtë vendit, refezuar nenit 9, te ligjit 10325/2010 dhe pikës 1, neni 6 i ligjit 115/18.12.2025. Gjithashtu, propozimi siguron shmangien e mbivendosjes së funksioneve dhe paqartësive mbi përgjegjësinë e administrimit të të dhënave personale të studentëve që kanë përfituar bursa jashtë vendit. Ministria e Arsimit në zbatim të VKM nr. 160 datë 19.2.2020 ”Për mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe të nëpunësve civilë (fondi i ekselencës)” administron procedurën e regjistrimit, verifikimit dhe menaxhimit të bursave të studimit të përfituara nga studentët shqiptarë, të cilët kryejnë studimet universitare jashtë vendit si dhe shtetasit shqiptarë që kanë përfituar bursat e studimit që i ofrohen Shqipërisë nga shtete, organizata ndërkombëtare dhe jofitimprurëse në bazë të marrëveshjeve të nënshkruara apo dokumente të tjera ku Republika e Shqipërisë është palë. | Projekt akti nënligjor synon qartësojë përgjegjësitë e institucioneve të ngarkuara me zbatim dhe shmangien e mbivendosjes së funksioneve dhe paqartësive mbi përgjegjësinë e administrimit të të dhënave personale të studentëve që kanë përfituar bursa jashtë vendit. | Jo | Po, Shtylla I "Shqiperia evropiane" dhe 1.5 "Politika e jashtme dhe diaspora" | Po | Po, Strategjia Kombëtare për Arsimin 2021-2026 | Po, ndikime financiare dhe sociale |
| 12 | Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.43/2016 "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë" | Projektligj | Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Ministri i Financave | Katërmujori III | Përshtatja, lehtësimi, përmirësimi i kuadrit ligjor që rregullon procedurat e lidhjes së marrëveshjeve të huas dhe granteve në Republikën e Shqipërisë, si dhe qartësimi i disa dispozitave mbi procesin e lidhjes së marrëveshjeve ndërkombëtare në përgjithësi nisur nga paqartësi të hasura nga aplikimi ndër vite i ligjit, referuar nenit 5, 10, 15 të ligjit 43/2016 | Përmirësimi i dispozitave që lidhen me si vijon, por jo vetëm:<br>- procedurat për marrëveshjet e huas dhe granteve të dalin jashtë objektit të Ligjit nr.43/2016 dhe të parashikohen në Ligjin nr.9665/2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;<br>- subjektet e marrëveshjeve;<br>- detyrimin për miratimin në parim të marrëveshjeve;<br>- fleksibilitetin lidhur me nënshkrimin e marrëveshjeve;<br>- përfshirja e një dispozite të re që qartëson marrëveshjet jo-ligjërisht të detyrueshme. | Jo | Po, Shtylla I "Shqiperia evropiane" dhe 1.5 "Politika e jashtme dhe diaspora" | Jo | Jo | Jo |
| 13 | “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.340, datë 6. 6. 2018 “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për kushtet dhe mënyrën e zgjedhjes së përfaqësuesve të Këshillit Koordinues të Diasporës”. | Projektvendim | Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme | Katërmujori III | Këshilli i Ministrave ka miratuar Vendimin nr. 510, datë 25.9.2025 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme” sipas të cilit MEPJ caktohet si institucion përgjegjës për diasporën. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme ka propozuar Projektligj për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 16/2018 “Për Diasporën” . Për rrjedhojë miratimi i mundshëm i Projektligjit në fjalë konkretisht neni 19 dhe neni 20 i tij, pasjell nevojën e harmonizimit dhe përpuethshmërisë me aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.<br>Ndryshimet ligjore të propozuara duhet të reflektohen dhe detajohen më hollësisht në Vendimin nr.340, datë 6.6.2018 të Këshillit të Ministrave në kuadër të zgjerimit të kontinenteve apo zgjedhjes dhe numrit të anëtarëve përfaqësues të diasporës edhe në shtete të tjera, të cilat karakterizohen sipas statistikave për përqendrim të lartë në numër të komuniteteve shqiptare apo shtete në të cilat shteti shqiptar ka interes të veçantë, pavarësisht numrit të shtetasve me banim jashtë vendit. | Ndryshimet e propozuara synojnë pasjen e një kuadri të plotë institucional mbi mënyrën e përzgjedhjes së anëtarëve të KKD-së dhe rritjen e numrit të anëtarëve të Këshillit Koordinues të Diasporës për një përfaqësim më të gjerë të diasporës shqiptare nga shtete ose kontinente ende të pambuluara, apo shtete në të cilat shteti shqiptar ka interes të veçantë dhe partneritet, pavarësisht numrit të shtetasve me banim jashtë vendit. | Jo | Po, Shtylla I "Shqiperia evropiane" dhe 1.5 "Politika e jashtme dhe diaspora" | Po | Strategjia Kombëtare për Migracionin 2024-2030 dhe Strategjia e Specializimit Ineligjent | Jo |
| 14 | Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshë | Projektvendim | Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme | Katërmujori III | Nevoja për ndryshimin e projektaktit që rregullon QSPA-në, vjen si domosdoshmëri e rregullimit të kuadrit ligjor të strukturës përgjegjëse për diasporën historike arbëreshe në varësi të MEPJ-së, të cilat lidhen me organizimin dhe funksionimin e QSPA-së, pika II, ligji 601/2019. | Akti synon të rregulloj statusin e Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët, detyrat dhe funksionet e tij, ngritja e Këshillit Akademik Teknik për Botimet si organ kolegjial vendimarrës | Jo | Po, Shtylla I "Shqiperia evropiane" dhe 1.5 "Politika e jashtme dhe diaspora" | Jo | Strategjia Kombëtare e Diasporës Shqiptare 2021 – 2025 dhe Planin të Veprimit | Jo |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 15 | Për disa ndryshime në Vendimin nr. 447, datë 22.7.2021 të Këshillit të Ministrave "Për kriteret e dhënies së bursave për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare, për të studiuar në Republikën e Shqipërisë." | Projektvendim | Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme | Katërmujori III | Propozimi për ndryshime në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 447, datë 22.7.2021 synon të qartësojë përgjegjësitë e institucioneve të ngarkuara me zbatim duke revokuar përgjegjësinë e MEPJ/AKD në këtë proces. Konkretisht, propozimi mbështetet në vetë faktin që Ministria e Arsimit është institucion përgjegjës për çështjet e arsimit dhe disponon të dhëna të plota dhe të sakta për studentët shqiptarë që studiojnë jashtë vendit, referuar vendimit 584/28.08.2003 dhe vendimi 514/25.09.2025. | Projekt akti nënligjor synon qartësojë përgjegjësitë e institucioneve të ngarkuara me zbatim dhe shmangien e mbivendosjes së funksioneve dhe paqartësive mbi përgjegjësinë e administrimit të të dhënave personale të studentëve që kanë përfituar bursa jashtë vendit. | Jo | Po, Shtylla I "Shqiperia evropiane" dhe 1.5 "Politika e jashtme dhe diaspora" | Po | Strategjia Kombëtare për Arsimin 2021-2026 | Po, ndikime financiare dhe sociale |

## Programi i Përgjithshëm Analitik i Projektakteve për vitin 2026

### Ministria e Financave

| Nr. | Titulli i projektaktit | Lloji i projektaktit | Ministri propozues | Katërmujori | Arsyet kryesore për propozimin e projektaktit | Çështjet kryesore që parashikon të rregullojë projektakti | A është parashikuar projektakti në PKIE? Nëse po, të specifikohet kapitulli përkatës | Përputhshmëria e projektaktit me programin politik qeverisës 2025-2029 Nëse përputhet, të jepet referenca e saktë në progam | A është akt i një rëndësie të veçantë e prioritare? | "Lidhja e projektaktit me strategjitë kombëtare dhe sektoriale Nëse lidhet, të specifikohen strategjitë" | Ndikimet e mundshme ekonomike, financiare, sociale dhe mjedisore Përgjigjuni me Po/Jo për ndikimet përkatëse |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | "Për punonjësit me kontratë të përkohshme për vitin 2026 në njësitë e qeverisjes qendrore" | Projektvendim | Ministri i Financave | Katërmujori I | Projektakt i përvitshëm sipas përcaktimeve të Kodit të Punës dhe të Ligjit Vjetor të Buxhtetit | Shpërndarja e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, në njësitë e qeverisjes qëndrore për vitin 2025 | Jo | Jo | Jo | Jo | Jo |
| 2 | "Për miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2027-2029" | Projektvendim | Ministri i Financave | Katërmujori I | Projektakt i përvitshëm sipas përcaktimeve të Ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar | Percaktimi i tavaneve paraprake të shpenzimeve për periudhën afatmesme për cdo institucion buxhetor | Jo | Jo | Jo | Jo | Jo |
| 3 | "Për miratimin e kalendarit të Menaxhimit të Shpenzimeve Publike 2026" | Projektvendim | Ministri i Financave | Katërmujori I | Projektakt i përvitshëm sipas përcaktimeve të Ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar | Paraqet një kalendar me aktivitetet dhe datat përkatëse për një mirëmenaxhim të financave publike | Jo | Jo | Jo | Jo | Jo |
| 4 | "Për miratimin e "Kuadrit Makroekonomik e Fiskal për periudhën 2027-2029" | Projektvendim | Ministri i Financave | Katërmujori I | Kuadri Makroenomik dhe Fiskal (KMF) përcakton synimet dhe objektivat e qeverisë në lidhje me treguesit kryesor të politikës fiskale si, balancën e përgjithshme fiskale (deficitin), huamarrjen, borxhin publik, balancën fiskale primare dhe atë korrente. KMF shërben si bazë për përcaktimin e tavaneve në fazën e parë të procesit të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2027 – 2029 në nivel ministrie.<br>KMF ka për qëllim përcaktimin e përparësive strategjike të qeverisë, projekton pritshmërinë makroekonomike në horizontin kohor afat-mesëm | KMF përmban dy komponentë kryesore: (i) parashikimet për treguesit kryesorë makroekonomikë të cilët paraqesin pritshmërinë ekonomike për vitin aktual dhe tre vitet e ardhshme dhe (ii) parashikimet dhe objektivat për treguesit fiskal të cilët paraqesin burimet e pritshme në dispozicion të qeverisë për vitet 2027–2029 dhe shpërndarjen e tyre për këtë periudhë sipas buxhetit të konsoliduar. | Jo | Jo | Jo | Jo | Po, ndikime ekonomike. Është parashikuar në PBA 2026-2028. |
| 5 | "Për miratimin e "Programit të reformave Ekonomike (ERP) 2026-2028" | Projektvendim | Ministri i Financave | Katërmujori I | ERP-ja përgatitet nga vendet kandidate dhe potencialisht kandidate, në kuadër të qasjes së re të qeverisjes ekonomike të Bashkimit Evropian për vendet e zgjerimit. | Programi i Reformave Ekonomike (ERP) 2026-2028 paraqet kuadrin e politikave makroekonomike dhe fiskale që synojnë të mbështesin zhvillimin e qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës të ekonomisë tonë për periudhën afatmesme 2026-2028. | Jo | Jo | Jo | Jo | Jo |
| 6 | "Për miratimin e projekt dokumentit të programit buxhetor afatmesëm 2027-2029" | Projektvendim | Ministri i Financave | Katërmujori II | Projektakt i përvitshem sipas përcaktimeve të Ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar | Projekt dokument informues, i cili paraqet në menyrë të detajuar kotimin e politikave publike dhe refomave strukturore deri në nivel produkti, të shoqeruar në cdo rast me KPI në nivel qellimi dhe objektivi, për të gjitha Ministrite e Linjës dhe Institucionet e tjera buxhetore, në zbatim dhe përputhje të plotë me tavanet buxhetore përgatitore te miratuara. | Jo | Jo | Jo | Jo | Jo |
| 7 | "Për parandalimin e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe armëve të shkatërrimit në masë" | Projektligj | Ministria e Financave / nëpërmjet Agjencisë të Inteligjencës Financiare (AIF) | Katërmujori II | Harmonizimi me paketën e re të BE-së për AML/CFT (Directiva 1640/2024; rregullorja e BE 1624/2024 dhe rregulloreja e BE 1113/2023); përputhshmëria me rekomandimet FATF; forcimi i mbikëqyrjes, raportimit dhe bashkëpunimit ndërinstitucional; rritja e efektivitetit në identifikimin, ngrirjen/sekuestro-n dhe konfiskimin e produkteve të veprës penale. | Përshtatja e detyrimeve të subjekteve raportuese me Rregulloren (BE) 2024/1624 dhe rregulloren 1113/2023; masat e kujdesit të shtuar ndaj klientit, kufizimet për pagesat në para, rreziqet nga kripto-asetet; përforcimi i mekanizmave të bashkëpunimit AIF-prokurori/policia/mbikëqyrësit; rregullim i procedurave të ngrirjes dhe konfiskimit; sanksione efektive, proporcionale e dekurajuese. | Po, Kapitulli 4 | Ky projektligj është në përputhje me programin politik qeverisës 2025–2029, në veçanti me angazhimet për integrimin evropian, forcimin e shtetit të së drejtës dhe rritjen e integritetit financiar. | Jo | Strategjia Kombëtare për Integrimin Evropian; Strategjia Kombëtare për Sigurinë Financiare; Strategjia e Sigurisë Kombëtare; Strategjia Kombetare per Parandalimin e pastrimit te parave dhe financimin e terrorizmit 2024-2030. | Po ndikim financiar, ekonomik dhe social. Është parashikuar në PBA 2026-2028. |
| 8 | "Për miratimin e Buxhetit Faktik të vitit 2025" | Projektligj | Ministri i Financave | Katërmujori II | Qëllimi i projektligjit është miratimi i buxhetit faktik të Qeverisjes së Përgjithshme për vitin 2024.<br>Hartimi i këtij projektligji lidhet me plotësimin e kërkesës ligjore në zbatim të : '*Neni 62 dhe 63 i Ligjit nr.9936/2008, i ndryshuar*'. | Nëpërmjet këtij projektligji sigurohet publikimi i informacionit të plotë mbi performancën makro-fiskale dhe zbatimin e buxhetit të vitit 2024, objektivat e arritura nga çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme. | Jo | Jo | Jo | Strategjia '*Per menaxhimin e financave Publike*":<br>Objektivi 5 "*Transparenca e Financave Publike*"<br>Komponenti: "*Monitorimi dhe raportimi financiar dhe i performances*". | Po, ndikim financiar. Është parashikuar në PBA 2026-2028. |
| 9 | "Për miratimin e tavaneve përfundimtare të shpenzimeve | Projektvendim | Ministri i Financave | Katërmujori II | Projektakt i përvitshem sipas përcaktimeve të Ligjit nr.9936 datë | Përcaktimi i tavaneve përfundimtare të shpenzimeve për periudhën afatmesme për | Jo | Jo | Jo | Jo | Jo |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | të programit buxhetor afatmesëm 2027-2029" | | | | 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar | cdo institucion buxhetor | | | | |
| 10 | "Për auditimin e brendshëm" | Projektligj | Ministri i Financave | Katërmujori II | Arsyeja kryesore për propozimin e hartimit të këtij ligji është përafrimi me Standardet Globale të auditimit të brendshëm (hyrë në fuqi më 1 Janar 2025). Ky projektligj do të ndikojë në rritjen e rolit të njësive të auditimit të brendshëm, në qartësimin e rolit të titullarëve të institucioneve, në forcimin e rolit të strukturës përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm, në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të subjektit të audituar, si dhe rregullimin e rolit të auditimit të brendshëm në sektorin privat. | Rritja e rolit të njësive të auditimit të brendshëm, qartësimi i rolit të titullarëve të institucioneve qëndrore, përcaktimi i të drejtave dhe detyrimeve të subjektit të audituar, forcimi i rolit të strukturës përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm, rregullimi i rolit të auditimit të brendshëm në sektorin privat, për sigurimin e një sistemi të pavarur, profesional dhe të harmonizuar të auditimit të brendshëm, që rrit transparencën, llogaridhënien dhe efektivitetin e menaxhimit të riskut dhe kontrollit të brendshëm, në përputhje me standardet globale. | Jo | Jo | Jo | Jo | Po, ndikim financiar, ekonomik dhe social. Është parashikuar në PBA 2026-2028. |
| 11 | "Mbi kontabilitetin në sektorin publik" | Projektligj | Ministri i Financave | Katërmujori II | Ky projektakt ka për qëllim krijimin e një kuadri të unifikuar, të qëndrueshëm dhe bashkëkohor ligjor për kontabilitetin publik në Republikën e Shqipërisë. | Projektakti synon:<br>1. Përcaktimin e kuadrit rregullator për kontabilitetin e sektorit publik në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit për sektorin publik (IPSAS).<br>2. Rregullimin e procesit të mbajtjes së kontabilitetit, si dhe të përgatitjes, paraqitjes dhe publikimit të pasqyrave financiare vjetore, individuale dhe të konsoliduara, nga njësitë e sektorit publik.<br>3. Përcaktimin e strukturave përgjegjëse për mbajtjen e kontabilitetit, përgatitjen dhe paraqitjen e pasqyrave financiare, rolet dhe funksionet e tyre.<br>4. Rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në përdorimin e fondeve publike, duke garantuar raportime të standardizuara dhe të verifikueshme. | Jo | Jo | Jo | Projektakti përputhet me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Europian 2030 (SKZHIE 2030), Strategjinë e Menaxhimit të Financave Publike (2023-2030). | Jo |
| 12 | "Për disa ndryshime në ligjin nr. 102/2014, 'Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë', i ndryshuar | Projektligj | Ministri i Financave | Katërmujori III | Zbatimi i Planit te Punës për Closing Benchmark për kapitullin 29 Përafrim me Direktivat e Bashkimit Evropian lidhur me rregullat dhe procedurat e përgjithshme doganore | Harmionizimi i atyre rregullave dhe procedurave të përgjithshme doganore që nuk janë ende në përputhje të plotë me rregullat e BE-së në këtë fushë. | Po, Kapitulli 29 | Po. Në rubriken "Integrimi europian ". | Jo | Jo | Jo |
| 13 | "Për disa ndryshime në ligjin nr. 92/2014, 'Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë', i ndryshuar" | Projektligj | Ministri i Financave | Katërmujori III | Zbatimi i Planit të Punës për Closing Benchmark për kapitullin 16 Përafrim me Direktivat e Bashkimit Evropian lidhur me TVSH | Perfshirja e atyre parashikimeve detyruese nga Direktivat e BE-se në fushën e TVSH-së dhe harmonizimi i mëtejshëm i kuadrit rregullator vendas. | Po, Kapitulli 16 | Po. Në rubrikën "Integrimi evropian" | Jo | Po, Strategjia Afatmesme e të Ardhurave Tatimore dhe Plani i Veprimit 2024-2027 | Jo |
| 14 | "Për disa ndryshime në ligjin 61/2012, "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar" | Projektligj | Ministri i Financave | Katërmujori III | Zbatimi i Planit të Punës për Closing Benchmark për kapitullin 16 Përafrim me Direktivat e Bashkimit Evropian lidhur me akcizën | Perfshirja e atyre parashikimeve detyruese nga Direktivat e BE-s në fushën e Akcizave dhe harmonizimi i mëtejshëm i kuadrit rregullator vendas, përfshire nivelet e akcizes për kategorine e duhaneve | Po, Kapitulli 16 | Po. Në rubriken "Integrimi evropian" | Jo | Po, Strategjia Afatmesme e të Ardhurave Tatimore dhe Plani i Veprimit 2024-2027 | Jo |
| 15 | "Për miratimin dhe publikimin zyrtar të Nomenklaurës së Kombinuar të Mallrave 2027" | Projektvendim | Ministri i Financave | Katërmujori III | Përditësimi i Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, sipas versionit të Bashkimit Evropian. Në datë 1 janar 2026 Administrata Doganore Shqiptare duhet të zbatojë të njejtën Nomenklaturë Mallrash si Bashkimi Evropian. Në bazë të kësaj Nomenkalture zbatohen nivelet kombetare të tarifes doganore, Marrëveshja e Stabilizim Asociimit, Marrëveshja Interim si dhe Marrëveshjet e Tregtisë së Lirë. | Zbatimin e saktë të: niveleve të tarifës doganore, Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit dhe Marreveshjeve të Tregetisë së Lirë; Shkembimin e informacionit me autoritetet doganore evropiane si dhe lehtësimin e raportimeve statistikore dhe procedurave doganore për shkembimet tregtare me vendet e BE. | Po, Kapitulli 29 | Po. Në rubriken "Integrimi europian ". | Jo | Jo | Jo |
| 16 | Projektligji "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit elektronik të informacionit mbi pagesat ndërkufitare" | Projektligj | Ministri i Financave | Katërmujori III | Zbatimi i Planit të Punës për Closing Benchmark për kapitullin 16 Përafrim me Direktivën e Këshillit (BE) 2020/283 dhe Direktivën e Komisionit (BE) 2020/284, që ndryshon Direktivën 2006/112/EC për integrimin e dispozitave mbi CESOP. | Objekti i këtij ligji është përcaktimi i parimeve, rregullave dhe detyrimeve ligjore për krijimin, administrimin dhe funksionimin e Sistemit Elektronik të Informacionit mbi Pagesat Ndërkufitare , si një bazë të dhënash shtetërore, si dhe përcaktimi i detyrimit të ofruesve të shërbimeve të pagesave për të mbledhur dhe raportuar të dhënat mbi pagesat ndërkufitare sipas procedurave, formateve dhe afateve të përcaktuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. | Po, Kapitulli 16 | Po. Në rubriken "Integrimi europian ". | Jo | Po, Strategjia Afatmemse e te Ardhurave Tatimore dhe Plani i Veprimit 2024-2027 | Jo |
| 17 | "Për disa ndryshime në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar" | Projektligj | Ministri i Financave | Katërmujori III | Rritja e transparencës financiare, lufta kundër evazionit fiskal dhe përshtatja me standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare | Përmirësimi i procedurave tatimore.<br>Përafrimi i ligjit për procedurat tatimore me Direktivat e Bashkimit Evropian në fushën e tatimeve direkte, që lidhen me parashikimet e këtij ligji | Po, Kapitulli 16 | Jo | Jo | Po, Strategjia Afatmemse e te Ardhurave Tatimore dhe Plani i Veprimit 2024-2027 | Jo |
| 18 | "Për disa ndryshime në ligjin nr. 29/2023, datë 30.3.2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar" | Projektligj | Ministri i Financave | Katërmujori III | Zbatimi i Planit të Punës për Closing Benchmarks për Kapitullin 16 Përafrim me Direktivat e Bashkimit Evropian për tatimet direkte: "Council Directive 2009/133/EC of 19 October 2009"; "Council Directive 2016/1164 of 12 July 2016"; dhe "Council Directive 2011/96/EU of 30 November 2011". | Përafrimi i ligjit për tatimin mbi të ardhurat me Direktivat e Bashkimit Evropian në fushën e tatimeve direkte, që lidhen me parashikimet e këtij ligji | Po, Kapitulli 16 | Jo | Jo | Po, Strategjia Afatmemse e te Ardhurave Tatimore dhe Plani i Veprimit 2024-2027 | Jo |
| 19 | "Për sigurimin e një niveli minimal global të tatimit për grupet e shoqërive shumëkombëshe" | Projektligj | Ministri i Financave | Katërmujori III | Zbatimi i Planit të Punës për Closing Benchmarks për Kapitullin 16 Përafrim me "Council Directive 2022/2523/EC" | *Zbatimi i normës minimale efektive të tatimit prej 15%<br>*Rregulli i përfshirjes së të ardhurave (Income Inclusion Rule - IIR)<br>*Rregulli për fitimet e nën-tatuara (Undertaxed Profits Rule - UTPR)<br>*Tatimi shtesë i brendshëm i kualifikuar (Qualified Domestic Minimum Top-up Tax - | Po, Kapitulli 16 | Jo | Jo | Po, Strategjia Afatmemse e te Ardhurave Tatimore dhe Plani i Veprimit 2024-2027 | Jo |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | QDMTT)<br>*Rregulla administrative dhe raportimi | | | | |
| 20 | "Për disa ndryshime në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, "Për taksat kombëtare", të ndryshuar" | Projektligj | Ministri i Financave | Katërmujori III | Zbatimi i Planit të Punës për Closing Benchmarks për Kapitullin 16<br>Eliminimi i politikave të taksimit diskriminues | Unifiikim i taksës së plastikës, në kuadër të kapitullit 16 të BE-së. | Po, Kapitulli 16 | Jo | Jo | Po, Strategjia Afatmemse e te Ardhurave Tatimore dhe Plani i Veprimit 2024-2027 | Jo |
| 21 | "Për ndihmën e ndërsjellë për rekuperimin e pretendimeve që lidhen me tatimet, detyrimet doganore dhe masa të tjera" | Projektligj | Ministri i Financave | Katërmujori III | Zbatimi i Planit të Punës për Closing Benchmarks për Kapitullin 16<br>Përafrim me "Council Directive 2010/24/EU (16 March 2010)" | *Zbatimi i ndihmës së ndërsjellë për rekuperimin e pretendimeve tatimore dhe doganore.<br>*Procedurat për shkëmbimin e informacionit ndërmjet autoriteteve kompetente.<br>*Rregullat për njoftimin e dokumenteve tatimore në juridiksione të tjera.<br>*Mekanizmat për zbatimin e masave të rekuperimit dhe të masave paraprake.<br>*Përdorimi i një instrumenti të unifikuar përpretendimet në shtetet e tjera. | Po, Kapitulli 16 | Jo | Jo | Po, Strategjia Afatmemse e te Ardhurave Tatimore dhe Plani i Veprimit 2024-2027 | Jo |
| 22 | "Për mekanizmat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në fushën e tatimeve" | Projektligj | Ministri i Financave | Katërmujori III | Zbatimi i Planit të Punës për Closing Benchmarks për Kapitullin 16<br>Përafrim me "Council Directive (EU) 2017/1852 (10 October 2017)" | *E drejta për të paraqitur ankesë nga tatimpaguesit.<br>*Procedura e marrëveshjes së ndërsjellë (MAP).<br>*Krijimi i Komisionit Këshillimor.<br>*Transparenca dhe publikimi i vendimeve.<br>*Zgjerimi i fushës së zbatimit përtej çështjeve të transferimit të çmimit. | Po, Kapitulli 16 | Jo | Jo | Po, Strategjia Afatmemse e te Ardhurave Tatimore dhe Plani i Veprimit 2024-2027 | Jo |
| 23 | "Për disa shtesa ndryshime në ligjin nr. 9665/2006 "Për Huamarrjen Shtetërore, Borxhin Shtetëror dhe Garancitë Shtetërore të Huasë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar" | Projektligj | Ministri i Financave | Katërmujori III | Lehtësimi dhe harmonizimin e procedurave ekzistuese të miratimit të marrëveshjeve të huasë dhe të granteve sipas ligjit nr. 43/2016, i ndryshuar. | Lehtesimin dhe harmonizimin e procedurave ekzituese. | Jo | Jo | Jo | Jo | Jo |
| 24 | "Për disa ndryshime në ligjin nr. 9831, datë 12.11.2007, "Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist", të ndryshuar | Projektligj | Ministri i Financave / Ministri i Drejtësisë | Katërmujori III | Arsyeja kryesore për propozimin e ndryshimit të këtij ligji është përmirësimi dhe përshpejtimi i procesit të shpërndarjes së dëmshpërblimit financiar në favor të ish të dënuarve politik të regjimit komunist. Duke qënë se shume ish të dënuar politike kanë ndërruar jetë dhe përfitues janë trashëgimtaret e tyre, kufizimet e vlerave për pagese në ligjin aktual bejne që të ngadalesohet ecuria e procesit të shlyerjes së detyrimit të qeverise për pagesat e dëmshpërblimit financiar të kësaj kategorie të shoqërise, si një nga angazhimet prioritare të shtetit shqiptar. | Realizimin e inciativës së Qeverisë, për përfundimin sa më parë të shpërndarjes së dëmshpërblimit e plotë financiare, në favor të ish-të dënuarve politik dhe familjarëve të tyre, nëpërmjetë rritjes së pragut limit të pagesës financiare duke e çuar nga 1,000,000 (një milion) lekë që është aktualisht, në 3,000,000 (tre milion) lekë, për çdo këst pagese. | Jo | Jo | Jo | Jo | Po ndikim financiar, ekonomik dhe social. Është parashikuar në PBA 2026-2028. |
| 25 | "Për miratimin e dokumentit të programit buxhetor afatmesëm 2027-2029, të rishikuar" | Projektvendim | Ministri i Financave | Katërmujori III | Projektakt i përvitshëm sipas përcaktimeve të Ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"i ndryshuar | Dokument informues, i cili paraqet në mënyre të detajuar kotimin e politikave publike dhe refomave strukturore deri në nivel produkti, të shoqëruar në cdo rast me KPI në nivel qellimi dhe objektivi, për të gjitha Ministritë e Linjës dhe Institucionet e tjera buxhetore, në zbatim dhe përputhje të plotë me tavanet buxhetore përfundimtare të miratuara. | Jo | Jo | Jo | Jo | Jo |
| 26 | "Për buxhetin e vitit 2027" | Projektvendim | Ministri i Financave | Katërmujori III | Projektakt i përvitshem sipas përcaktimeve të Ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar | Përcaktimi i të ardhurave dhe Shpenzimeve të Buxhetit të shtetit, duke synuar në rritjen progresive të të ardhurave, dhe eficencë në mënyret e përdorimit të fondeve publike në sektorët prioritar dhe jo vetëm, duke mbajtur në konsideratë nga ana tjetër uljen e Deficitit Buxhetor dhe të Borxhit Publik. | Jo | Jo | Jo | Jo | Jo |

## Programi i Përgjithshëm Analitik i Projektakteve për vitin 2026

### Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit

| Nr. | Titulli i projektaktit | Lloji i projektaktit | Ministri propozues | Katërmujori | Arsyet kryesore për propozimin e projektaktit | Çështjet kryesore që parashikon të rregullojë projektakti | A është parashikuar projektakti në PKIE?<br><br>Nëse po, të specifikohet kapitulli përkatës | Përputhshmëria e projektaktit me programin politik qeverisës 2025-2030<br><br>Nëse përputhet, të jepet referenca e saktë në progam | Lidhja e projektaktit me strategjitë kombëtare dhe sektoriale<br><br>Nëse lidhet, të specifikohen strategjitë | Ndikimet e mundshme ekonomike, financiare, sociale dhe mjedisore<br><br>Përgjigjuni me Po/Jo për ndikimet përkatëse |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Për deklarimin pasuri kulturore e paluajtshme e Zonës Arkeologjike A te Qytetit Antik të Bushatit | Projektvendim | Ministri i Turizmit, Kulturës dhe Sportit | Katërmujori I | Shkronja “a” dhe ç e pikës 3, të nenit 9, dhe të nënparagrafit “iv”, të shkronjës “b”, të pikës 3, të nenit 53, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzet | Vlerësimin, ruajtjen, mbrojtjen, restaurimin, konservimin e integruar dhe administrimin e trashëgimisë kulturore dhe peisazhit të zonës arkeologjike “A” të qytetit antik të Bushatit mbështetur në ligjin Nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe Muzetë", i ndryshuar Gjithashtu, ky projektvendim synon përcaktimin e rregullave, procedurave dhe autoriteteve shtetërore përgjegjëse për vlerësimin, ruajtjen, mbrojtjen, dhe administrimin e pasurisë dhe vlerave të trashëgimisë kulturore të zonës arkeologjike “A” të qytetit antik të Bushatit. | Jo | Jo | Strategjia Kombetare për Kulturen 2019-2025 | Po |
| 2 | Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Kulturën 2026-2030 | Projektvendim | Ministri i Turizmit, Kulturës dhe Sportit | Katërmujori I | Neni 100 i Kushtetutës dhe ligjet sektoriale | Ky dokument ka për qëllim të ofrojë një pasqyrë të politikave kulturore në vend, prirjet e zhvillimit të sektorit kulturor dhe krijues, si dhe të paraqesë planin e veprimit drejt krijimit të një mjedisi të favorshëm për rritjen e rolit të kulturës në zhvillimin e qëndrueshëm të Shqipërisë, të shoqërisë së saj dhe të çdo individi. | Jo | Jo | Jo | Po |
| 3 | Për deklarimin pasuri kulturore e paluajtshme "Ansambël Arkitektonik Urban" të një zone të qytetit të Delvinës, përcaktimin e zonës mbrojtëse të tij dhe miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre | Projektvendim | Ministri i Turizmit, Kulturës dhe Sportit | Katërmujori I | Shkronja “a” dhe ç e pikës 3, të nenit 9, dhe të nënparagrafit “iv”, të shkronjës “b”, të pikës 3, të nenit 53, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzet | Deklarimin pasuri kulturore e paluajtshme të ansamblit arkitektonik urban te nje zone ne qytetin e Delvines. Gjithashtu, ky projektvendim synon përcaktimin e rregullave, procedurave dhe autoriteteve shtetërore përgjegjëse për vlerësimin, ruajtjen, mbrojtjen, dhe administrimin e pasurisë dhe vlerave të trashëgimisë kulturore të ansamblit historik urban/qendër historike | Jo | Jo | Strategjia Kombetare për Kulturen 2019-2025 | Po |
| 4 | Për disa ndryshime në VKM Nr. 285, datë 29.04.2022 “Për Kriteret e Vendosjes dhe të Funksionimit të Stacioneve Sezonale të Ankorimit/Bregëzimit” | Projektvendim | Ministri i Turizmit, Kulturës dhe Sportit | Katërmujori I | Pika 2, të nenit 21, të ligjit nr. 43/2020, “Për aktivitetet e turizmit detar" | Ndryshimet vijnë si rezultat i nevojës për rishikimin e metologjisë së tarifimit të subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë e stacionit sezonal të ankorimit/bregëzimit, duke u bazuar në vlerat e referencës sipas secilës zonë dhe funksionimin e Komisionit e Komisionit të Shqyrtimit të kërkesave për stacion sezonal ankorimi/ bregëzimi | Jo | Rritja ekonomike e qendrueshme | Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Turizmit 2025–2034 | Po |
| 5 | Për krijimin e Parkut Arkeologjik Bylis - Klos | Projektvendim | Ministri i Turizmit, Kulturës dhe Sportit | Katërmujori I | Pika 3 e nenit, 9, shkronja "b" e ligjit 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, i ndryshuar | Ky projektvendim synon organizimin dhe funksionimin e Parkut Arkeologjik Bylis dhe Klos, përgjegjësitë funksionale, misionin dhe financimin e veprimtarisë. | Jo | Jo | Strategjia Kombetare per Kulturen 2019-2025 | Po |
| 6 | Për krijimin e Parkut Arkeologjik të Apollonise dhe rregulloren e administrimit | Projektvendim | Ministri i Turizmit, Kulturës dhe Sportit | Katërmujori II | Pika 3 e nenit, 9, shkronja "b" e ligjit 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, i ndryshuar | Nw kuadwr tw ndarjes sw Parkut Arkeologjik Apoloni-Bylis do tw rishikohen kufijtw e Parkut Arkeologjik tw Apollonisw dhe struktura adiministruese | Jo | Jo | Strategjia Kombetare per Kulturen 2019-2027 | Po |
| 7 | Per disa ndryshime ne VKM Nr. 29, datë 20.1.2016 "Për shpalljen e qendrës historike të fshatit Dhërmi dhe miratimin e rregullores për administrimin e saj e të zonës së mbrojtur përreth" | Projektvendim | Ministri i Turizmit, Kulturës dhe Sportit | Katërmujori II | Shkronja “a” dhe “ç” të pikës 3 e nenit 9, pikës 3 të nenit 62, pika 1 e nenit 96, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, i ndryshuar | Deklarimin pasuri kulturore e paluajtshme të ansamblit arkitektonik urban te nje zone ne qytetin e Delvines. Gjithashtu, ky projektvendim synon përcaktimin e rregullave, procedurave dhe autoriteteve shtetërore përgjegjëse për vlerësimin, ruajtjen, mbrojtjen, dhe administrimin e pasurisë dhe vlerave të trashëgimisë kulturore të ansamblit historik urban/qendër historike | Jo | Jo | Strategjia Kombetare per Kulturen 2019-2028 | Jo |
| 8 | Për procedurën e shpalljes publike të pasurive kulturore që zbulohen në det | Projektvendim | Ministri i Turizmit, Kulturës dhe Sportit | Katërmujori II | Pika 2 e të nenit 154 të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, i ndryshuar | Vlerësimin, ruajtjen, mbrojtjen, restaurimin, konservimin e integruar dhe administrimin e trashëgimisë kulturore dhe peisazhit të zonës arkeologjike “A” të qytetit antik te Bushatit mbështetur në ligjin Nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe Muzetë", i ndryshuar Gjithashtu, ky projektvendim synon përcaktimin e rregullave, | Jo | Jo | Strategjia Kombetare per Kulturen 2019-2029 | Jo |
| 9 | Për ushtrimin e funksioneve të fondacionit "Marubi" | Projektvendim | Ministri i Turizmit, Kulturës dhe Sportit | Katërmujori II | Pika 4, neni 206 i ligjit nr.27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", i ndryshuar | Ngritja dhe funksionimi i fondacionit “Marubi”, prane Muzeut Kombetar te Fotografise Marubi, Shkoder. Referuar ligjit nr.27/2018 "Per trashegimine kulturore dhe muzete". ky fondacion,midis të tjerave, | Jo | Jo | Strategjia Kombetare per Kulturen 2019-2029 | Po |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | hërben për formimin e restauratorëve të ardhshëm të materialeve fotografike | | | | |
| 10 | Për disa ndryshime në vendimin nr.22,datë12.1.2018 "Për miratimin e kritereve e të procedurave për certifikimin e veprimtarisë së agroturizmit dhe ndërtimin e strukturave/objekteve në funksion të tij" | Projektvendim | Ministri I Turizmit,Kulturës dhe Sportit | Katërmujori II | Pika 2 e nenit 4, të ligjit nr. 93/2015, "Përturizmin", të ndryshuar | Lehtësimi i kritereve dhe procedurave për certifikimin e veprimtarisë së agroturizmit dhe rritja e standardeve. | Jo | Rritja ekonomike e qendrueshme | Jo | Po |
| 11 | Për disa ndryshime në ligjin nr. 93/2015 "Për turizmin" | Projektligj | Ministri I Turizmit,Kulturës dhe Sportit | Katërmujori III | Nenet 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës. | Rritja e konkurrencës dhe lehtësimi i qarkullimit rajonal të shërbimeve në fushën e turizmit.Në kuadër të aderimit të shtetit shqiptar në Marrëveshjen për Amendimin dhe Zgjerimin e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA) nënshkruar me datë 19 dhjetor 2006, hyrë në fuqi me 26 korrik 2007 dhe Vendimit te Komitetit të Përbashkët të CEFTA-s nr. 6/22024 "Për lehtësimin e tregtisë së shërbimeve të ofruara nga agjencitë dhe operatorët turistikë", i miratuar më 9 tetor 2024, buron detyrimi për ndryshime në kuadrin ligjor të turizmit duke e integruar më tej Shqipërinë në tregun rajonal të CEFTA-s.<br>Gjithashtu, në kuadër të integrimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian (BE) dhe hapjes së negociatave për grup kapitujt e Acquis të BE-së, konkretisht ne zbatim te Kapitullit 3, "E Drejta e Vendosjes dhe Liria për të Ofruar Shërbime" dhe Planit te tij te Veprimit, nëpërmjet eksperteve janë rekomanduar te bëhen ndryshime në kuadrin ligjor të turizmit. | Po,kapitulli 3. | Rritja ekonomike e qendrueshme | Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Turizmit 2025–2030 | Po |
| 12 | Për disa ndryshime në vendimin nr. 710, datë 12.10.2016 "Për miratimin e rregullores "Për kërkesat dhe kriteret për ushtrimin e veprimtarisë së operatorit turistik" | Projektvendim | Ministri I Turizmit,Kulturës dhe Sportit | Katërmujori III | Pika 3, të nenit 51, të ligjit nr. 93/2015, "Përturizmin" i ndryshuar. | Rritja e konkurrencës dhe lehtësimi i qarkullimit rajonal të shërbimeve te agjencive të udhëtimit dhe operatorëve turistik.Në vijim të ndryshimeve ligjore të ligjit të turizmit, në kuadër të aderimit në CEFTA dhe të integrimit në BE | Po, kapitulli 3. | Rritja ekonomike e qendrueshme | Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Turizmit 2025–2031 | Po |
| 13 | Për disa ndryshime në vendimin nr. 709, datë 12.10.2016 "Për miratimin e rregullores "Për kërkesat dhe kriteret për ushtrimin e veprimtarisë së agjencisë së udhëtimit" | Projektvendim | Ministri I Turizmit,Kulturës dhe Sportit | Katërmujori III | Pika 3, të nenit 48, të ligjit nr. 93/2015, "Përturizmin", i ndryshuar | Në vijim të ndryshimeve ligjore të ligjit të turizmit, në kuadër të aderimit në CEFTA dhe të integrimit në BE<br>Rritja e konkurrencës dhe lehtësimi i qarkullimit rajonal të shërbimeve te agjencive të udhëtimit dhe operatorëve turistik. | Po, kapitulli 3. | Rritja ekonomike e qendrueshme | Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Turizmit 2025–2032 | Po |
| 33 | "Per disa shtesa dhe ndryshime ne Ligjin nr. 162/2014 'Për cilësinë e ajrit në mjedis", i ndryshuar | Projektligj | Ministri i Mjedisit | Katërmujori III | Ne Bashkimin Evropian ne vitin 2024 eshte miratuar Direktiva e re (EU) 2024/2881 per cilesine e ajrit dhe ajer me te paster per Europen, e cila ndryshon disa Direktiven e meparshme dhe propozon per here te pare dispozita te reja dhe integron 2 Direktiva ne nje. | Ne kuader te procesit te perafrimit te legjislacionit kombetar me ate Europian, Direktivën e (EU) 2024/2881, lind nevoja që të nderhyet ne Ligjin kuadër të cilesisë së ajrit. | Po, kapitulli 27 | Po akti ka perpuethshmeri me Programin politik qeverises 2025-2029 ne piken 3.6 Mbrojtja e mjedisit dhe ndryshimet klimatike | Jo | SKZHI 2021-2030 | Ndikimet e mundshme: Ekonomike- Po, Financiare-Po, Sociale- Po dhe mjedisore-Po |
| 34 | "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr.2/2023 "Për gazet serrë të floruara"" | Projektligj | Ministri i Mjedisit | Katërmujori III | Shqipëria duhet të rishikojë ligjin për gazet serrë fluoruara. Projektligji ndryshues do të synojë përafrojë Rregulloren e re të Bashkimit Evropian (BE) nr. 2024/573, e cila zëvendëson Rregulloren 517/2014, përfaruar pjesërisht përmes Ligjit Nr.2/2023. | Në përputhje me procesin e integrimit evropian dhe me detyrimet që rrjedhin nga Kapitulli 27 "Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike", Do te synohet reduktimi i mëtejshëm të ndikimit klimatik të këtyre gazrave me potencial të lartë ngrohjeje globale (GëP), duke i integruar standardet e BE-së në çdo hallkë të zinxhirit – nga importi e tregtimi, deri te përdorimi dhe riciklimi. | Po, kapitulli 27 | SHTYLLA III<br>MIRËQENIE PËR TË GJITHË<br>3.6 Mbrojtja e mjedisit dhe ndryshimet klimatike | Jo | VKM-në nr. 581, datë 6.10.2021, "Për miratimin e Kontributit Kombëtar të Përcaktuar" | Ndikimet e mundshme: Ekonomike- Po, Financiare-Po, Sociale- Po dhe mjedisore-Po |
| 35 | "Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 352, datë 29.04.2015 "Për vlerësimin e cilësisë së ajrit në mjedis dhe kërkesat për disa ndotës të caktuar""; | Projektvendim | Ministri i Mjedisit | Katërmujori III | Në zbatim të nenit 5 të ligjit nr. 162/2014, "Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis". | Ne kuader te procesit te perafrimit te legjislacionit kombetar me ate Europian, lind nevoja që të ndërhyet ne kete Vendim për përafrimin me Direktiva (BE) 2024/2881 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 23 tetor 2024, mbi cilësinë e ajrit të ambientit dhe ajrin më të pastër për Evropën . Vendimi aktual i Këshillit të Ministrave ka për qëllim a) përcaktimin e vlerave kufi, vlerave prag dhe vlerave të synuara për disa ndotës në ajër, si dhe objektivave për cilësi të shëndetshme të ajrit të mjedisit; b) përcaktimin e metodave dhe kritereve për matjen dhe vlerësimin e cilësisë së ajrit të mjedisit; c) promovimin e rritjes së bashkëpunimit midis aktorëve të ndryshëm brenda vendit, si dhe me vende të tjera. Direktiva e re e Be-së parashikon ndryshime të rëndësishme lidhur me vlerat prag, kufi dhe të synuara, ndaj është e nevojshme të reflektohen nëpërmjet ndryshimit të VKM-së . | Po, kapitulli 27 | Po akti ka perpuethshmeri me Programin politik qeverises 2025-2029 ne piken 3.6 Mbrojtja e mjedisit dhe ndryshimet klimatike | Jo | SKZHI 2021-2030 | Ndikimet e mundshme: Ekonomike- Po, Financiare-Po, Sociale- Po dhe mjedisore-Po |
| 36 | "Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 162, datë 19.02.2020 "Per rregullat e hollesishme per hartimin, miratimin, rishikimin dhe zbatimin e programeve te pakesimit te shkarkimeve në ajër"; | Projektvendim | Ministri i Mjedisit | Katërmujori III | Në zbatim të pikës 4, të nenit 17, të ligjit nr. 162, datë 4.12.2014, "Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis" | Ne kuader te procesit te perafrimit te legjislacionit kombetar me ate Europian, lind nevoja që të ndërhyet në këtë Vendim, për përafrimin e mëtejshëm me Direktivën (BE) 2016/2284, e njohur si Direktiva për Kufijtë Kombëtarë të Emisioneve (NEC Directive), ka si qëllim kryesor reduktimin e ndikimeve negative të ndotjes së ajrit në shëndetin e njeriut dhe mjedis. | Po, kapitulli 27 | Po akti ka perpuethshmeri me Programin politik qeverises 2025-2029 ne piken 3.6 Mbrojtja e mjedisit dhe ndryshimet klimatike | Jo | SKZHI 2021-2030 | Ndikimet e mundshme: Ekonomike- Po, Financiare-Po, Sociale- Po dhe mjedisore-Po |

| Programi i Përgjithshëm Analitik i Projektakteve për vitin 2026 | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Ministria e Arsimit** | | | | | | | | | | | |
| **Nr.** | **Titulli i projektaktit** | **Lloji i projektaktit** | **Ministri propozues** | **Katërmujori** | **Arsyet kryesore për propozimin e projektaktit** | **Çështjet kryesore që parashikon të rregullojë projektakti** | **A është parashikuar projektakti në PKIE?<br><br>Nëse po, të specifikohet kapitulli përkatës** | **Përputhshmëria e projektaktit me programin politik qeverisës 2025-2029<br><br>Nëse përputhet, të jepet referenca e saktë në progam** | **A është akt i një rëndësie të veçantë e prioritare?** | **Lidhja e projektaktit me strategjitë kombëtare dhe sektoriale<br><br>Nëse lidhet, të specifikohen strategjitë** | **Ndikimet e mundshme ekonomike, financiare, sociale dhe mjedisore<br><br>Përgjigjuni me Po/Jo për ndikimet përkatëse** |
| 1 | "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Shërbimeve Arsimore" | Projektligj | Ministri i Arsimit | Katërmujori I | Rishikimi i formës së organizimit dhe funksionimit të Qendrës së Shërbimeve Arsimore si agjenci autonome të krijuar me ligj të veçantë në zbatim të neneve 81, pika 1 dhe 100 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë | Objekti i këtij projektligji është krijimi i Agjencisë Kombëtare të Shërbimeve Arsimore, përcaktimi i fushës së saj të veprimtarisë, i parimeve dhe rregullave të përgjithshme të organizimit e të funksionimit, si dhe të detyrave dhe kompetencave të saj | Jo | Shtylla III<br>Zgjerojmë shërbimet arsimore online, digjitalizojmë testimet dhe sigurojmë njohjen automatike të diplomave, përmes ngritjes së një agjencie të specializuar dhe të certifikuar sipas standardeve ndërkombëtare | Jo | Vendim nr. 621, datë 22.10.2021 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021-2026 dhe të Planit të Veprimit për zbatimin e saj”, | Po, ka efekte financiare e sociale pozitive. |
| 2 | "Për miratimin e standardeve dhe kritereve që mundësojnë zbatimin e parimit të shkencës së hapur në përputhje me politikat e zonës europiane të kërkimit" | Projektvendim | Ministri i Arsimit | Katërmujori I | Miratimi i aktit nënligjor në zbatim të pikës 6, të nenit 5, të ligjit nr. 109/2024 "Për shkencën dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë" | Zbatimin e parimit të shkencës së hapur ne perputhje me politikat e zones europiane te kerkimit | Po, kapitulli 25 | Shtylla III<br>Ndërtojmë një sistem kërkimor-shkencor të përafruar me modelin e BE, duke zbatuar kuadrin ligjor për shkencën dhe duke dyfishuar investimet për laboratorë modernë në universitetet publike, institutet dhe njësitë kërkimore. | Jo | Vendim<br>nr. 542, datë 20.09.2023 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023–2030 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj” | Po, ka efekte sociale pozitive. |
| 3 | "Për miratimin e Kodit të Etikës në Shkencë dhe Kërkim Shkencor të harmonizuar me Kodin Evropian të Sjelles për Integritet në Kërkim Shkencor" | Projektvendim | Ministri i Arsimit | Katërmujori I | Miratimi i aktit nënligjor në zbatim të pikës 1, të nenit 30 të ligjit nr. 109/2024 "Për shkencën dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë" | Miratimin e kodit te etikës në shkencë dhe kërkim shkencor të harmonizuar me kodin evropian të sjelles per integritet ne kerkim shkencor | Po, kapitulli 25 | Shtylla III<br>Ndërtojmë një sistem kërkimor-shkencor të përafruar me modelin e BE, duke zbatuar kuadrin ligjor për shkencën dhe duke dyfishuar investimet për laboratorë modernë në universitetet publike, institutet dhe njësitë kërkimore. | Jo | Vendim<br>nr. 542, datë 20.09.2023 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023–2030 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj” | Po, ka efekte sociale pozitive. |
| 4 | "Për përcaktimin e modelit të financimit për shkencën dhe kërkimin shkencor" | Projektvendim | Ministri i Arsimit | Katërmujori I | Miratimi i aktit nënligjor në zbatim të shkronjës "b", të pikës 2, të nenit 8 të ligjit nr. 109/2024 "Për shkencën dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë" | Përcaktimi i modelit të financimit për shkencën dhe kërkimin shkencor | Jo | Shtylla III<br>Ndërtojmë një sistem kërkimor-shkencor të përafruar me modelin e BE, duke zbatuar kuadrin ligjor për shkencën dhe duke dyfishuar investimet për laboratorë modernë në universitetet publike, institutet dhe njësitë kërkimore. | Jo | Vendim<br>nr. 542, datë 20.09.2023 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023–2030 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj” | Po, ka efekte financiare. |
| 5 | "Për përcaktimin e kritereve, rregullave dhe procedurave për krijimin, vendosjen nën mbikëqyrje, pezullimin dhe mbylljen e instituteve dhe njësive të veçanta të kërkimit shkencor" | Projektvendim | Ministri i Arsimit | Katërmujori I | Miratimi i akteve nënligjore në zbatim të pikës 4, të nenit 16 dhe të pikës 1, të nenit 21, të ligjit nr. 109/2024 "Për shkencën dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë" | Përcaktimi i kritereve, rregullave dhe procedurave për krijimin, vendosjen nën mbikëqyrje, pezullimin dhe mbylljen e instituteve dhe njësive të veçanta të kërkimit shkencor | Jo | Shtylla III<br>Ndërtojmë një sistem kërkimor-shkencor të përafruar me modelin e BE, duke zbatuar kuadrin ligjor për shkencën dhe duke dyfishuar investimet për laboratorë modernë në universitetet publike, institutet dhe njësitë kërkimore. | Jo | Vendim<br>nr. 542, datë 20.09.2023 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023–2030 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj” | Po, ka efekte sociale pozitive. |
| 6 | "Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave për përfitimin e kategorisë nga punonjësit kërkimorë-shkencorë" | Projektvendim | Ministri i Arsimit | Katërmujori I | Miratimi i aktit nënligjor në zbatim pikës 2, të nenit 25, të ligjit nr. 109/2024 "Për shkencën dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë" | Përcaktimin e kritereve dhe procedurave për përfitimin e kategorisë nga punonjësit kërkimorë-shkencorë | Jo | Shtylla III<br>Ndërtojmë një sistem kërkimor-shkencor të përafruar me modelin e BE, duke zbatuar kuadrin ligjor për shkencën dhe duke dyfishuar investimet për laboratorë modernë në universitetet publike, institutet dhe njësitë kërkimore. | Jo | Vendim<br>nr. 542, datë 20.09.2023 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023–2030 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj” | Po, ka efekte sociale pozitive. |
| 7 | "Për përcaktimin e fushave të rëndësisë së veçantë të kërkimit shkencor për të cilat kërkohet leje e veprimtarisë kërkimore-shkencore, si dhe kriteret e procedurat për lëshimin e lejes" | Projektvendim | Ministri i Arsimit | Katërmujori I | Miratimi i aktit nënligjor në zbatim të pikës 3, të nenit 19, të ligjit nr. 109/2024 "Për shkencën dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë" | Përcaktimi i fushave të rëndësisë së veçantë të kërkimit shkencor për të cilat kërkohet leje e veprimtarisë kërkimore-shkencore, si dhe kriteret e procedurat për lëshimin e lejes | Jo | Shtylla III<br>Ndërtojmë një sistem kërkimor-shkencor të përafruar me modelin e BE, duke zbatuar kuadrin ligjor për shkencën dhe duke dyfishuar investimet për laboratorë modernë në universitetet publike, institutet dhe njësitë kërkimore. | Jo | Vendim<br>nr. 542, datë 20.09.2023 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023–2030 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj” | Po, ka efekte sociale pozitive. |
| 8 | Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoriatit Qendror të Arsimit Parauniversitar | Projektvendim | Ministri i Arsimit | Katërmujori I | Ky projektakt ka si qëllim krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Qendror të Arsimit | Qëllimi i këtij projektvendimi lidhet me një nga qëllimet prioritare të ligjit për inspektimin mbi uljen e barrës administrative ndaj biznesit, nëpërmjet | Jo | Shtylla III<br>Riorganizojmë të gjithë sistemin e inspektorateve për ta bërë më transparent, më | Jo | Vendim nr. 621, datë 22.10.2021 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për | Po, ka efekte financiare e sociale pozitive. |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | Parauniversitar (IQAP) sipas përcaktimeve të pikës 1, të nenit 26, të ligjit nr. 99/2024, datë 12.9.2024, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë" dhe pikës 3, të nenit 25, të ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar. | riorganizimit të inspektorateve dhe institucioneve me funksione inspektimi në fushë zbatimin e ligjit për inspektimin, sipas fushave të lidhura me risqet e ngjashme. Problematikat e vazhdueshme mbi përplasjet dhe mbivendosjet e kompetencave institucionale për shkak të ushtrimit të funksioneve të njëjta apo të ngjashme inspektuese sjell si nevojë të domosdoshme riorganizimin e tyre, duke bashkuar në struktura të vetme inspektuese institucionet/strukturat që kanë funksione të ngjashme inspektimi. | | efikas dhe më miqësor për biznesin, duke shmangur abuzimet dhe kontrollin e panevojshëm<br>Reformojmë sistemin e Inspektimit dhe Kontrollit edhe në kuadër të ligjit të ri të inspektimit, duke e përafruar inspektimin me standardet dhe protokollet e BE-së. | | Arsimin 2021-2026 dhe të Planit të Veprimit për zbatimin e saj", | |
| 9 | Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore Sistemi Shqiptar i Informacionit të Kërkimit Shkencor (ACRIS) | Projektvendim | Ministri i Arsimit | Katërmujori<br>I | Bazuar ne Ligjin Nr. 10 325, datë 23.9.2010 "Për bazat e të dhënave shtetërore" bazat e të dhënave shtetërore krijohen me vendim të të Këshillit të Ministrave. Projektakti propozohet në kuadër të ngritjes dhe funksionimit të bazës së të dhënave shtetërore Sistemi Shqiptar i Informacionit të Kërkimit Shkencor (ACRIS) | Qëllimi i këtij projektakti është të krijojë bazën e të dhënave shtetërore Sistemi Shqiptar i Informacionit të Kërkimit Shkencor (ACRIS) | Jo | Shtylla III<br>Zgjerojmë shërbimet arsimore online, digjitalizojmë testimet dhe sigurojmë njohjen automatike të diplomave, përmes ngritjes së një agjencie të specializuar dhe të certifikuar sipas standardeve ndërkombëtare | Jo | Vendim<br>nr. 542, datë 20.09.2023 i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023–2030 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj" | Po, ka efekte financiare brenda tavaneve buxhetore.<br>Ka efekte sociale pozitive. |
| 10 | "Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të Sistemit të Menaxhimit të Informacionit të Arsimit të Lartë (SMIAL)" | Projektvendim | Ministri i Arsimit | Katërmujori<br>I | Bazuar ne Ligjin Nr. 10 325, datë 23.9.2010 "Për bazat e të dhënave shtetërore" bazat e të dhënave shtetërore krijohen me vendim të të Këshillit të Ministrave. Projektakti propozohet në kuadër të ngritjes dhe funksionimit të bazës së të dhënave shtetërore Sistemi i Menaxhimit të Informacionit të Arsimit të Lartë (SMIAL) | Qëllimi i këtij projektakti është të krijojë bazën e të dhënave shtetërore në fushën e arsimit të lartë, Sistemi i Menaxhimit të Informacionit të Arsimit të Lartë (SMIAL) | Po, kapitulli 26 | Shtylla III<br>Zgjerojmë shërbimet arsimore online, digjitalizojmë testimet dhe sigurojmë njohjen automatike të diplomave, përmes ngritjes së një agjencie të specializuar dhe të certifikuar sipas standardeve ndërkombëtare | Jo | Vendim nr. 621, datë 22.10.2021 i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021-2026 dhe të Planit të Veprimit për zbatimin e saj", | Po, ka efekte sociale pozitive. |
| 11 | "Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të Sistemit të Provimit të Shtetit dhe provimeve të tjera të digjitalizuara" | Projektvendim | Ministri i Arsimit | Katërmujori<br>I | Bazuar ne Ligjin Nr. 10 325, datë 23.9.2010 "Për bazat e të dhënave shtetërore" ky projektvendim ka për qëllim përmirësimin dhe plotësimin e kuadrit ligjor lidhur me krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të Sistemit të Provimit të Shtetit, i cili do të plotësohet edhe me të dhëna të tjera shtesë lidhur me organizimin dhe zhvillimin e procesit për dhënien e provimeve të tjera të digjitalizuara, që do të jenë pjesë e këtij sistemi. | Sistemi do të bëjë të mundur përditësimin e të dhënave që merren nga Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar, Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar, Urdhrat profesionalë, kandidatët, ministritë përgjegjëse, si dhe institucionet publike dhe jopublike që kërkojnë të zhvillojnë provime të tjera të digjitalizuara pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore duke siguruar menaxhimin efektiv të sistemit, të bazuar në mekanizma funksionale për sigurimin e cilësisë, transparencës dhe llogaridhënies. | Jo | Shtylla III<br>Zgjerojmë shërbimet arsimore online, digjitalizojmë testimet dhe sigurojmë njohjen automatike të diplomave, përmes ngritjes së një agjencie të specializuar dhe të certifikuar sipas standardeve ndërkombëtare | Jo | Vendim nr. 621, datë 22.10.2021 i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021-2026 dhe të Planit të Veprimit për zbatimin e saj", | Po, ka efekte sociale pozitive. |
| 12 | Ndryshimi i vendimit nr. 606, datë 14.9.2022 "Për miratimin e programit kombëtar për aktivitetet jashtë orarit mësimor dhe për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2022, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit", i ndryshuar | Projektvendim | Ministri i Arsimit | Katërmujori<br>I | Projektvendimi propozohet në zbatim të shkronjës "b" të pikës 3 të nenit 54 të ligjit nr. 69/2012 "Për arsimin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar në kuadër të vlerësimit që Ministria e Arsimit po i bën efektivitetit dhe vlefshmërisë së kësaj VKM-je në zbatimin e deritanishëm dhe përshtatja e saj me nevojat dhe zhvillimet e reformave kurrikulare në shkolla.<br>Hartimi i PVKM është në zbatim të Planit Kombëtar të Veprimit për Fuqizimin e Mekanizmave të Parandalimit të çdo forme dhune e bullizmi për sigurinë në institucionet arsimore parauniversitare. Në këtë plan veprimi është parashikuar që në periudhën 2025-2027 të pilotohen dy programet "After school" dhe "Shkollat verore". Në muajit qershor-korrik 2025 programi "Shkollat verore" u pilotua me ndihmën e donatorëve, por këto pragrame do të vazhdojnë pilotimin dhe për këtë duhet hartimi i një VKM-je për realizim me efektiv, si dhe parashikimi i efketeve financiare | 1. Parashikohet të rishikohet kurrikula e deritanishme e programit JOM;<br>2. Ndryshime të mënyrës së organizimit dhe funksionimit të këtyre aktiviteteve.<br>3. Do të parashikohen roli dhe qëllimi i programeve "After school" dhe "Shkollat verore", strukturat që do të angazhohen dhe përgjegjësisa e secilës strukturë.<br>4.Do të parashikohen efeket financiare për periudhën e pilotimit, mënyra dhe vlera e pagesës për punonjësit që do të angazhohen dhe për shërbime të tjera të nevojshme në funksion të programeve që do të pilotohen. | Jo | Shtylla III<br>Zbatojmë programin e ushqimit në çdo bashki qendër qarku dhe nisim një program të ri passhkollor (after school) | Jo | Vendim nr. 621, datë 22.10.2021 i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021-2026 dhe të Planit të Veprimit për zbatimin e saj", | Po, ka efekte financiare, ka efekte sociale pozitive tek fëmijët e arsimit bazë. |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 13 | "Për një shtesë në vendimin nr.649, datë 14.9.2011, të Këshillit të Ministrave, "për përcaktimin e listës së specialiteteve, nënspecialiteteve apo specialiteteve plotësuese për profesionet e rregulluara", të ndryshuar | Projektvendim | Ministri i Arsimit dhe Ministri i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale | Katërmujori II | Projektvendimi propozohet në zbatim të nenit 13, të ligjit nr.10171, datë 22.10.2009, "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar | Rishikimi i shtojcës 1 të vendimit nr.649, datë 14.9.2011, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, "Lista e specialiteteve, nënspecialiteteve apo specialiteteve plotësuese për profesionet e rregulluara", në kuadër të përfshirjes në ndarjen V, për profesionin e fizioterapistit Diplomave në "Shkenca Rehabilitimi" ose ekuivalente me këto diploma. | Jo | Shtylla III Ngremë arsimin shqiptar në lartësinë e standardeve evropiane, duke e bërë shkollën urën e së ardhmes ku çdo fëmijë dhe i ri gjen mundësi për t'u rritur, për t'u formuar dhe për të qenë një qytetar dinjitoz i Evropës. | Jo | Vendim nr. 621, datë 22.10.2021 i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021-2026 dhe të Planit të Veprimit për zbatimin e saj", | Po, ka efekte sociale pozitive për profesionistëve në fushën e shëndetit. |
| 14 | "Për përcaktimin e kritereve, procedurave, periodicitetit, metodologjisë dhe llojeve të masave për vlerësimin e instituteve dhe njësive të veçanta të kërkimit shkencor që financohen me fonde publike" | Projektvendim | Ministri i Arsimit | Katërmujori II | Miratimi i aktit nenligjor në zbatim të pikës 2, të nenit 20, të ligjit nr. 109/2024 "Për shkencën dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë" | Përcaktimi i kritereve, procedurave, periodicitetit dhe metodologjisë së vlerësimit të përmbushjes së kushteve dhe kritereve të funksionimit të Instituteve dhe njësive të veçanta të kërkimit shkencor që financohen me fonde publike | Jo | Shtylla III Ndërtojmë një sistem kërkimor-shkencor të përafruar me modelin e BE, duke zbatuar kuadrin ligjor për shkencën dhe duke dyfishuar investimet për laboratorë modernë në universitetet publike, institutet dhe njësitë kërkimore. | Jo | Vendim nr. 542, datë 20.09.2023 i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023–2030 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj" | Po, ka efekte sociale pozitive. |
| 15 | "Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave për dhënien e statusit "Qendër Ekselence"". | Projektvendim | Ministri i Arsimit | Katërmujori II | Miratimi i aktit nënligjor në zbatim të pikës 1, të nenit 22, të ligjit nr. 109/2024 "Për shkencën dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë" | Përcaktimi i kritereve dhe procedurave për dhënien e statusit "Qendër Ekselence"" | Jo | Shtylla III Ndërtojmë një sistem kërkimor-shkencor të përafruar me modelin e BE, duke zbatuar kuadrin ligjor për shkencën dhe duke dyfishuar investimet për laboratorë modernë në universitetet publike, institutet dhe njësitë kërkimore. | Jo | Vendim nr. 542, datë 20.09.2023 i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023–2030 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj" | Po, ka efekte sociale pozitive. |
| 16 | "Për përcaktimin e nivelit të pagës, kategorizimet në pagë dhe shpërblimin për punën në bazë të cilësisë dhe të rëndësisë së rezultateve të kërkimit shkencor, të personelit të instituteve dhe të njësive të veçanta të kërkimit shkencor publik" | Projektvendim | Ministri i Arsimit | Katërmujori II | Miratimi i aktit nënligjor në zbatim pikës 4, të nenit 23, të ligjit nr. 109/2024 "Për shkencën dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë" | Përcaktimi i nivelit të pagës, kategorizimit në pagë dhe shpërblimin për punën në bazë të cilësisë dhe të rëndësisë së rezultateve të kërkimit shkencor, të personelit të instituteve dhe të njësive të veçanta të kërkimit shkencor publik | Jo | Shtylla III Ndërtojmë një sistem kërkimor-shkencor të përafruar me modelin e BE, duke zbatuar kuadrin ligjor për shkencën dhe duke dyfishuar investimet për laboratorë modernë në universitetet publike, institutet dhe njësitë kërkimore. | Jo | Vendim nr. 542, datë 20.09.2023 i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023–2030 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj" | Po, ka efekte financiare, ka efekte sociale pozitive. |
| 17 | "Për përcaktimin e formës, përmbajtjes dhe elementët e Regjistrit Kombëtar të Institucioneve, Instituteve, Njësive të Veçanta të Kërkimit Shkencor dhe Kërkuesve Shkencorë, si dhe procedurat e krijimit, administrimit të informacionit, si dhe dokumentacioni që depozitohet për regjistrim" | Projektvendim | Ministri i Arsimit | Katërmujori II | Miratimi i aktit nënligjor në zbatim të pikës 2 dhe 3, të nenit 18, të ligjit nr. 109/2024 "Për shkencën dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë" | Përcaktimi i formës, përmbajtjes dhe elementëve të Regjistrit Kombëtar të Institucioneve, Instituteve, Njësive të Veçanta të Kërkimit Shkencor dhe Kërkuesve Shkencorë, si dhe procedurat e krijimit, administrimit të informacionit, si dhe dokumentacioni që depozitohet për regjistrim | Jo | Shtylla III Ndërtojmë një sistem kërkimor-shkencor të përafruar me modelin e BE, duke zbatuar kuadrin ligjor për shkencën dhe duke dyfishuar investimet për laboratorë modernë në universitetet publike, institutet dhe njësitë kërkimore. | Jo | Vendim nr. 542, datë 20.09.2023 i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023–2030 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj" | Po, ka efekte sociale pozitive. |
| 18 | Për disa shtesa në vendimin nr. 288, datë 21.5.2018 të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë" i ndryshuar | Projektvendim | Ministri i Arsimit | Katërmujori II | Rishikimi i vendimit për shkak të hapjes së programeve të reja të studimit, duke vendosur kufirin maksimal sipas ciklit të programeve, në zbatim të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" | Përditësimi i listës me programe të reja të hapura apo ndryshimit të emërtimeve në kuadër të riogrnaizimit të tyre, si dhe heqja nga listat e programeve që janë mbyllur. | Jo | Shtylla III Ngremë arsimin shqiptar në lartësinë e standardeve evropiane, duke e bërë shkollën urën e së ardhmes ku çdo fëmijë dhe i ri gjen mundësi për t'u rritur, për t'u formuar dhe për të qenë një qytetar dinjitoz i Evropës. | Jo | Vendim nr. 621, datë 22.10.2021 i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021-2026 dhe të Planit të Veprimit për zbatimin e saj", | Po, ka efekte sociale pozitive. |
| 19 | Për disa ndryshime në vendimin nr. 436, datë 3.6.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitet akademike 2020–2021 dhe 2021-2022 e në vijim" i ndryshuar. | Projektvendim | Ministri i Arsimit | Katërmujori II | Rishikimi i vendimit me qëllim përjashtimin nga plotësimi i kriterit të notës mesatare personat me AK (ankesa nga KMD), si dhe rishikimi shtojcave në kuadër të hpjes, riorganizimit dh mbylljes së programeve në institucionet publike dhe jopublike të arsimit të lartë, në zbatim të të pikës 1, të nenit 74, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" | Rishikimi i vendimi për shkak të hapjes së programeve të reja të studimit në fushën e mësuesisë, apo riorganizimit dhe mbylljes së disa programeve, sipas nevojave dhe kërkesave të institucioneve të arsimit të lartë | Jo | Shtylla III Ngremë arsimin shqiptar në lartësinë e standardeve evropiane, duke e bërë shkollën urën e së ardhmes ku çdo fëmijë dhe i ri gjen mundësi për t'u rritur, për t'u formuar dhe për të qenë një qytetar dinjitoz i Evropës. | Jo | Vendim nr. 621, datë 22.10.2021 i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021-2026 dhe të Planit të Veprimit për zbatimin e saj", | Po, ka efekte sociale pozitive. |
| 20 | Për disa shtesa në vendimin nr. 666, datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave "Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike" i ndryshuar | Projektvendim | Ministri i Arsimit dhe Ministri i Ekonomisë dhe Inovacionit | Katërmujori II | Sqarimi mbi mënyrën e ndarjes së bursave sipas kuotave për nxënësit që plotësojnë kriterete (raste ankesash nga KMD), në zbatim të nenit 19, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të pikës 2, të nenit 32, të ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin | Qartësimi i mënyrës së përfitimit të kuotave financiare për rastet kur numri i nxënësve që plotësojnë kriteret është më i lartë se numri i kuotave të miratuara. | Jo | Shtylla III Ngremë arsimin shqiptar në lartësinë e standardeve evropiane, duke e bërë shkollën urën e së ardhmes ku çdo fëmijë dhe i ri gjen mundësi për t'u rritur, për t'u formuar dhe për të qenë një qytetar dinjitoz i Evropës. | Jo | Vendim nr. 621, datë 22.10.2021 i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021-2026 dhe të Planit të Veprimit për zbatimin e saj", | Po, ka efekte sociale pozitive. |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | profesional në Republikën e Shqipërisë”, | | | | | | |
| 21 | Ndryshimi i vendimit nr. 486, datë 17.6.2020, të Këshillit të Ministrave "Për shtypjen, botimin, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit të arsimit parauniversitar", i ndryshuar | Projektvendim | Ministri i Arsimit | Katërmujori II | Rishikimi i kategorive që përfitojnë tekste shkollore të reja, çdo vit, në përdorim falas në zbatim të neneve 19 e 47, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar | Përfshirja e klasës së katërt dhe të pestë në kategorinë e nxënësve që do të marrin tekste të reja në përdorim falas | Jo | Shtylla III<br>Garantojmë tekstet falas për 236 mijë nxënës të arsimit bazë, nxënësit e pakicave kombëtare dhe kategori të veçanta sociale të shkollave të mesme. | Jo | Vendim nr. 621, datë 22.10.2021 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021-2026 dhe të Planit të Veprimit për zbatimin e saj”, | Po, ka efekte financiare, ka efekte sociale pozitive tek nxënësit. |
| 22 | Për hapjen e institucionit publik të arsimit të mesëm të lartë “Liceu francez”, Korçë | Projektligj | Ministri i Arsimit | Katërmujori III | Projektligji propozohet në zbatim të neneve 81, pika 1 dhe 100 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë si detyrim sipas marrëveshjes mes Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Francës.<br>Akti rregullon procedurat për krijimin dhe funksionimin e liceut franko-shqiptar të shkencës dhe teknologjisë. Nëpërmjet aktit do të parashikohet mënyra e hapjes, forma juridike, mënyra e funksionimit, pagesës së mësuesve të huaj, kurrikula që do të zbatohet, institucionet që do të anghazhohen për mirëfuksionimin e licenës dhe përgjegjësitë respektive, forma e diplomës etj. | 1. Akti do të përcaktojë mënyrën e organizimit dhe fuksionimit dhe të gjithë elementët organizativ dhe fuksional të liceut;<br>2. Akti do të përcaktojë institucionet dhe detyrat e tyre për funksionimin me cilësi të liceut.<br>3.Do të parashikohen efektet financiare, pagat e punonjësve shqiptar dhe të huaj, mbështetja për nxënësit etj. | Jo | Shtylla III<br>Mbështesim zhvillimin e shkollave me orientim artistik dhe sportiv duke garantuar autonominë dhe mbështetjen e tyre financiare, si dhe ngremë një model të ri shkolle me drejtim shkencor dhe fokus tek inovacioni, duke filluar me hapjen e Liceut Franko-Shqiptar. | Jo | Vendim nr. 621, datë 22.10.2021 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021-2026 dhe të Planit të Veprimit për zbatimin e saj”, | Po, ka efekte financiare, ka efekte sociale pozitive tek fëmijët shqiptar brenda dhe jashtë vendit. |

## PROGRAMI I PËRGJITHSHËM ANALITIK I PROJEKTAKTEVE PËR VITIN 2026

## MINISTRIA E SHENDETESISE DHE MIREQENIES SOCIALE

| Nr. | Titulli i projektaktit | Lloji i projektaktit | Ministri propozues | Katërmujori | Arsyet kryesore për propozimin e projektaktit | Çështjet kryesore që parashikon të rregullojë projektakti | A është parashikuar projektakti në PKIE?<br><br>Nëse po, të specifikohet kapitulli përkatës | Përputhshmëria e projektaktit me programin politik qeverisës 2025-2029<br><br>Nëse përputhet, të jepet referenca e saktë në progam | A është akt i një rëndësie të veçantë e prioritare? | Lidhja e projektaktit me strategjitë kombëtare dhe sektoriale<br><br>Nëse lidhet, të specifikohen strategjitë | Ndikimet e mundshme ekonomike, financiare, sociale dhe mjedisore<br><br>Përgjigjuni me Po/Jo për ndikimet përkatëse |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Për disa ndryshime në VKM nr. 550, datë 27.8.2014, "Për miratimin e rregullores "Për mbrojtjen e sigurisë dhe shëndetit të punëmarrësve nga risqet e lidhura me ekspozimin ndaj agjentë biologiikë në punë", | Projektvendim | Ministri i Shendetesise dhe Mireqenies Sociale | Katërmujori I | Transpozimi i DIREKTIVËS 2000/54/KE TË PARLAMENTIT EVROPIAN DHE TË KËSHILLIT të 18 shtatorit 2000 mbi mbrojtjen e punëtorëve nga rreziqet që lidhen me ekspozimin ndaj agjentëve biologjikë në punë (direktiva e shtatë individuale sipas kuptimit të nenit 16(1) të Direktivës 89/391/KEE):<br>**Ndryshuar nga: Direktiva e Komisionit (BE) 2019/1833 e 24 tetorit 2019** që ndryshon Shtojcat I, III, V dhe VI të Direktivës 2000/54/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit në lidhje me rregullimet thjesht teknike OJ L 279, 31.10.2019, f. 54-79 dhe D**irektiva e Komisionit (BE) 2020/739 e 3 qershorit 2020** që ndryshon Shtojcën III të Direktivës 2000/54/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, në lidhje me përfshirjen e SARS-CoV-2 në listën e agjentëve biologjikë të njohur për infektimin e njerëzve dhe që ndryshon Direktivën e Komisionit (BE) 2019/1833.<br>**Ligji nr. 10237 date 18.02.2010 "Per sigurine dhe shendetin ne pune"** | Projektakti parashikon të rregullojë vlerat limit të ekspozimit dhe rregullat e sigurisë dhe shëndetit në punën ndaj agjentëve biologjike në perputhje me kërkesat/rregullat e BE | PLANI I PUNËS - REFERENCA PËRFUNDIMTARE KLASTERI III "KONKURRUESHMËRIA DHE RRITJA GJITHËPËRFSHIRËSE" KAPITULL 19 - POLITIKA SOCIALE DHE E PUNËSIMIT | 2.4 Puna dhe kapitali njerezor . Garantojme kushte të barabarta pune, trajtim dinjitoz, sistem social të qëndrueshëm dhe të besueshëm. | Jo | Dokumenti Politik për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë dhe Plani I veprimit 2025-2030/ Ligji 10237 dt.18.02.2010 "Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë" | PO Ndikime mjedisore, ekonomike |
| 2 | Për miratimin e Rregullave për përcaktimin e llojeve, kritereve dhe procedurave për ofrimin e kujdesit alternativ, si dhe për funksionimin e komisionit shumëdisiplinar. | Projektvendim | Ministri i Shendetesise dhe Mireqenies Sociale | Katërmujori II | Propozimi i këtij projektakti synon të krijojë një bazë të qartë dhe të unifikuar për organizimin dhe ofrimin e kujdesit alternativ për fëmijët në Shqipëri. Ky projektakt synon të harmonizojë kriteret, procedurat dhe funksionimin institucional, duke siguruar mbrojtje të qëndrueshme për fëmijët dhe standarde të njëjta për të gjitha format e kujdesit alternativ. **Nenet 8, pika 5, 12, pika 7 dhe 26, pika 3 te projektligjit "Per kujdesin alternativ ne familje ne RSH** | Projektakti parashikon të rregullojë procesin e përcaktimit të llojit të kujdesit alternativ, kriteret dhe procedurat për ofrimin e tij, duke përfshirë shqyrtimin e kërkesave, regjistrimin, trajnimet dhe përfundimin e shërbimit. Gjithashtu, përcakton funksionimin e komisionit shumëdisiplinar, përbërjen, rolet dhe përgjegjësitë e tij, si dhe mënyrën e koordinimit me strukturat lokale dhe institucionet përkatëse. Qëllimi është të sigurohet një proces i qartë, transparent dhe i standardizuar për mbrojtjen e fëmijëve në të gjithë vendin. | Kapitulli 23 | 3.3. Familja, Politikat Sociale dhe Strehimi | Jo | Strategjia Kombetare e Mbrojtjes Sociale 2024-2030 | PO Ndikime Sociale |
| 3 | Për miratimin e rregullave për organizimin, funksionimin dhe qasjen në regjistrin e kujdesit alternativ në familje | Projektvendim | Katërmujori II | Katërmujori II | Ky projektakt synon të vendosë një kuadër të qartë dhe të harmonizuar për organizimin dhe funksionimin e regjistrit të kujdesit alternativ në familje, duke e integruar këtë proces në Sistemin Elektronik të Shërbimeve Sociale. Regjstri do të përmbajë informacion të detajuar për regjistrimin, trajnimin, monitorimin dhe përfundimin e kujdesit familjar dhe do të lehtësojë qasjen, koordinimin dhe transparencën e të dhënave mbi fëmijët e vendosur në familjet kujdestare. **Neni 13, pika 4 e projektligjit "Per kujdesin alternativ ne familje ne RSH** | Projektakti parashikon të rregullojë procedurat për organizimin, funksionimin dhe përdorimin e Regjistrit Elektronik të Kujdesit Alternativ në Familje, pjesë e Sistemit Elektronik të Shërbimeve Sociale, për të garantuar koordinim institucional, transparencë dhe mbrojtje të vazhdueshme për fëmijët. | Kapitulli 23 | 3.3. Familja, Politikat Sociale dhe Strehimi | Jo | Strategjia Kombetare e Mbrojtjes Sociale 2024-2030 | PO Ndikime Sociale |
| 4 | Për miratimin e procedurave për manaxhimin e rastit dhe përgatitjen e fëmijës për vendosje në kujdes alternativ në familje" | Projektvendim | Ministri i Shendetesise dhe Mireqenies Sociale | Katërmujori II | Ky projektakt synon të vendosë një kuadër të qartë dhe të standardizuar për manaxhimin e rasteve të fëmijëve që kanë nevojë për kujdes alternativ në familje, duke siguruar një proces të strukturuar dhe të koordinuar ndërmjet institucioneve dhe aktorëve përkatës. Ky akt synon të rrisë sigurinë, transparencën dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve gjatë gjithë procesit të vendosjes në kujdes alternativ në familje. **Nenet 14, pika 3 dhe 16, pika 3 te projektligjit "Per kujdesin alternativ ne familje ne RSH** | Projektakti përcakton procedurat për manaxhimin e rastit, duke përfshirë identifikimin e nevojave të fëmijës, vlerësimin e kushteve, përgatitjen psiko-sociale dhe ndërhyrjet mbështetëse për fëmijën dhe familjen biologjike. Ai gjithashtu rregullon procesin e përgatitjes së fëmijës për vendosje në kujdes alternativ në familje, duke përcaktuar rolet dhe përgjegjësitë e strukturave sociale, komisioneve shumëdisiplinare dhe aktorëve lokalë, në mënyrë që vendosja të bëhet në mënyrë të sigurt, të qëndrueshme dhe në interesin më të mirë të fëmijës. | Kapitulli 23 | 3.3. Familja, Politikat Sociale dhe Strehimi | Jo | Strategjia Kombetare e Mbrojtjes Sociale 2024-2030 | PO Ndikime Sociale |
| 5 | Për miratimin e rregullave, procedurave dhe instrumenteve për vlerësimin periodik të fëmijës si dhe të monitorimit dhe inspektimit të shërbimit të kujdesit alternativ në familje | Projektvendim | Ministri i Shendetesise dhe Mireqenies Sociale | Katërmujori II | Ky projektakt synon të krijojë një kuadër të harmonizuar dhe të standardizuar për vlerësimin periodik të situatës së fëmijëve në kujdes alternativ në familje, si dhe për monitorimin dhe inspektimin e ofrimit të shërbimit. Aktualisht, mungesa e rregullave dhe instrumenteve të detajuara krijon vështirësi në garantimin e cilësisë së kujdesit, mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe koordinimin ndërmjet strukturave përgjegjëse. Projektakti do të sigurojë një mekanizëm të qartë, transparent dhe të unifikuar për të monitoruar dhe vlerësuar shërbimin, duke rritur sigurinë dhe mbrojtjen e fëmijëve. **Nenet 22, pika 5, 24, pika 7 dhe dhe 25, pika 4 te projektligjit "Per kujdesin alternativ ne familje ne RSH** | Projektakti përcakton:<br>Procedurat dhe instrumentet për vlerësimin periodik të gjendjes së fëmijës, duke përfshirë zhvillimin social, emocional dhe edukativ, si dhe frekuencën e vlerësimeve dhe raportimit.<br>Rregullat dhe procedurat për monitorimin e shërbimit, duke përcaktuar rolet e strukturave përgjegjëse, mënyrën e mbikëqyrjes së familjeve profesionale dhe masat korrigjuese në rast devijimesh.<br>Rregullat dhe procedurat për inspektimin e shërbimeve të kujdesit alternativ në familje, përfshirë inspektimet rutinore dhe të jashtëzakonshme, dokumentimin e gjetjeve dhe koordinimin me organet përkatëse | Kapitulli 23 | 3.3. Familja, Politikat Sociale dhe Strehimi | Jo | Strategjia Kombetare e Mbrojtjes Sociale 2024-2030 | PO Ndikime Sociale |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | për respektimin e standardeve ligjore dhe të sigurisë së fëmijës.<br><br>Projektakti synon të sigurojë një proces të qëndrueshëm dhe të standardizuar për cilësinë dhe sigurinë e kujdesit alternativ në familje, duke garantuar transparencë, mbrojtje të të drejtave të fëmijëve dhe koordinim institucional. | | | | | |
| 6 | Për miratimin e masës së pagesës për kujdesin alternativ në familje | Projektvendim | Ministri i Shendetesise dhe Mireqenies Sociale | Katërmujori II | Ky projektakt synon të vendosë një kuadër të qartë dhe të harmonizuar për financimin e kujdesit alternativ në familje, duke siguruar standarde të njëjta për përfituesit dhe transparencë në menaxhimin e burimeve financiare, duke krijuar siguri për familjet ofruese dhe cilësinë dhe qëndrueshmërinë e shërbimeve të kujdesit alternativ. Ky akt synon të garantojë mbështetje të qëndrueshme financiare, të drejtë dhe të monitorueshme për të gjithë fëmijët në kujdes alternativ në familje.**Neni 31, pika 3, e projektligjit "Per kujdesin alternativ ne familje ne RSH** | Projektakti përcakton kriteret dhe procedurat për përfitimin e financimit të kujdesit alternativ në familje, duke përfshirë saktësisht se kush mund të aplikojë, dokumentacionin e nevojshëm dhe mënyrën e vlerësimit të kërkesave. Ai përcakton gjithashtu shumat dhe modalitetet e financimit, duke rregulluar mënyrën e shpërndarjes dhe përdorimit të mjeteve financiare nga familjet kujdestare profesionale, si dhe monitorimin dhe raportimin e përdorimit të këtij financimi, në mënyrë që të sigurohet transparencë, llogaridhënie dhe përdorim efektiv i burimeve. Ky projektakt krijon një proces të qartë dhe të standardizuar për mbështetjen financiare të kujdesit alternativ në familje, duke garantuar drejtësi, transparencë dhe mbrojtje të të drejtave të fëmijëve. | Kapitulli 23 | 3.3. Familja, Politikat Sociale dhe Strehimi | Jo | Strategjia Kombetare e Mbrojtjes Sociale 2024-2030 | PO Ndikime Sociale, Ekonomike dhe Financiare Programi "Perkujdesi Social" 10430 MSHMS |
| 7 | Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave në bashki dhe për procedurën e shqyrtimit të ankesave | Projektvendim | Ministri i Shendetesise dhe Mireqenies Sociale | Katërmujori II | Projektakti propozohet për të krijuar një kuadër të qartë dhe të standardizuar për organizimin dhe funksionimin e komisioneve të shqyrtimit të ankesave në bashki, duke adresuar nevojën për një proces transparent dhe efikas të trajtimit të ankesave të qytetarëve. Krijimi i këtij mekanizmi synon të rrisë llogaridhënien e autoriteteve vendore, të përmirësojë besimin e qytetarëve në institucionet lokale dhe të sigurojë që çdo ankesë të shqyrtohet në mënyrë të drejtë dhe brenda afateve të përcaktuara ligjore.**Neni 35, pika 4 e projektligjit "Per kujdesin alternativ ne familje ne RSH** | Projektakti përcakton mënyrën e organizimit dhe përbërjen e komisionit për shqyrtimin e ankesave në bashki, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, procedurën e pranimit, shqyrtimit dhe vendimmarrjes për ankesat, si dhe afatet dhe format e raportimit të vendimeve. Ai synon gjithashtu të rregullojë standardet e transparencës, të garantojë trajtim të barabartë për të gjitha ankesat dhe të sigurojë një mekanizëm të efektshëm monitorimi dhe vlerësimi të zbatimit të vendimeve të komisionit. | Kapitulli 23 | 3.3. Familja, Politikat Sociale dhe Strehimi | Jo | Strategjia Kombetare e Mbrojtjes Sociale 2024-2030 | PO Ndikime Sociale |
| 8 | Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuar 2026-2030 | Projektvendim | Ministri i Shendetesise dhe Mireqenies Sociale | Katërmujori II | Në përfundim të Planit Kombëtar të Veprimit për Personat më Aftësi të Kufizuara 2021-2025, do të hartohet dokumenti i ri strategjik. **Neni 100 i Kushtetutes . Ligji nr. 8626, date 22.06.200 Statusi I invalidit paraplegjik dhe tetraplegjiki** | Plani do të parashikojë objektiva dhe masa specifike për përfshirjen dhe integrimin në shoqëri të PAK në sektorë të ndryshëm. | Kapitulli 19 "Politikat Sociale dhe Punesimi" | Shtylla III: Mirëqenie për të Gjithë | Jo | Jo | PO Ndikime Mjedisore, Sociale, Ekonomike dhe Financiare |
| 9 | Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 9928, datë 9.6.2008 "Për shërbimin shëndetësor stomatologjik në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar | Projektligj | Ministri i Shendetesise dhe Mireqenies Sociale | Katërmujori II | Për përshtatjen e këtij ligji me zhvillimin teknologjik dhe përparimin shkencor në fushën e shërbimit stomatologjik; Për shtimin dhe rregullimin e shërbimeve të reja stomatologjike; Për një rregullim dhe harmonizim me ligjin nr. "Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, vecanërisht në pjesën që lidhet me masën administrative në rastet e mungesës së licencës së klinikave stomatologjike, prandaj kërkohet rishikim për të siguruar koherencë dhe zbatim të unifikuar. **Ligji nr. 10237 date 18.02.2010 "Per sigurine dhe shendetin ne pune"** | 1. Përputhja e kuadrit ligjor me zhvillimet teknologjike dhe përparimin shkencor në fushën e shërbimeve stomatologjike; 2. Përfshirjas dhe rregullimi i shërbimeve të reja stomatologjike; 3. Harmonizimi i këtij me legjislacionin e përgjithshëm për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë | | 3.2. Shëndetësia | Jo | STRATEGJIA KOMBËTARE E SHËNDETËSISË 2021-2030 | Jo |
| 10 | "Për miratimin e rregullores "Për mbrojtjen e sigurisë dhe shëndetit të punëmarrësve nga risqet e lidhura me plumbin dhe përbërjet e tij inorganike dhe për derivatet e tij në punë" | Projektvendim | Ministri i Shendetesise dhe Mireqenies Sociale | Katërmujori II | **Direktiva (BE) 2024/869** e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 13 Marsit 2024 që ndryshon Direktivën 2004/37/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe Direktivën e Këshillit 98/24/KE në lidhje me vlerat kufitare për plumbin dhe përbërjet e tij inorganike dhe derivatet e tij**. Neni 100 i Kushtetutes Ligji nr. 10 237 date 18.02.2010 Per sigurine dhe shendetin ne pune I ndryshuar.** | Projektakti parashikon të rregullojë vlerat limit të ekspozimit dhe rregullat e sigurisë dhe shëndetit në punën ndaj plumbit dhe përbërësve të tij inorganikë dhë derivatet e tij në perputhje me kërkesat/rregullat e BE | PLANI I PUNËS - REFERENCA PËRFUNDIMTARE KLASTERI III "KONKURRUESHMËRIA DHE RRITJA GJITHËPËRFSHIRËSE" KAPITULL 19 - POLITIKA SOCIALE DHE E PUNËSIMIT | 2.4 Puna dhe kapitali njerezor . Garantojme kushte të barabarta pune, trajtim dinjitoz, sistem social të qëndrueshëm dhe të besueshëm. | Jo | Dokumenti Politik për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë dhe Plani I veprimit 2025-2030/ Ligji 10237 dt.18.02.2010 "Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë" | Ndikime mjedisore, ekonomike |
| 11 | Për rishikimin e vendimit nr.797, datë 29.9.2010 për miratimin e rregullores higjeno-sanitare "Për administrimin e cilësisë së ujërave të larjes" | Projektvendim | Ministri i Shendetesise dhe Mireqenies Sociale | Katërmujori II | Duke qene se gjatë periudhës pas miratimit të këtij vendimi janë bërë disa ndryshime në kompetencat dhe emërtimet e Autoriteteve Kompetente të përfshira në vendim, si dhe në kompetencat e institucioneve të tjera të papërfshira ne vendim, lind nevoja për rishikimin e këtij vendimi, si dhe në zbatim të angazhimeve dhe detyrimeve që rrjedhin nga aktivitetet e parashikuara në Planin e Punës për përmbushjen e piketave mbyllëse për Kapitullin 27 "Mjedisi dhe ndryshimet klimatike" , në kuadër të proceve të Integrimit Evropian. **Neni 100 i Kushtetutes Ligji nr. 7643 date 2.12.1992 Per shendetin publik dhe Inspektoratin Sanitar Shteteror, I ndryshuar.** | Akt i përditësuar dhe përcaktim i qarte i autoriteteve përgjegjëse për menaxhimin e cilësisë së ujërave të larjes, përfshirë monitorimin, vlerësimin dhe kategorizimin e tyre, si dhe specifikimit qartë të institucionit përgjegjës për hartimin dhe përcaktimin e profileve të ujërave të larjes, përcaktim i qartëi kompetencave të çdo institucioni përgjegjës për zbatimin e kërkesave të këtij vendimi në funksion të mbrojtjes së qytetarëve nga ekspozimi ndaj ujërave të larjes me cilësi të keqe. | Kapitulli 27 | Shtylla III: Mirëqenie Për Të Gjithë/ shendetesia publike | Jo | STRATEGJIA KOMBËTARE E SHËNDETËSISË 2021-2030 | Jo |
| 12 | Për disa ndryshime në vkm nr. 933, datë 25.11.2020 "Për përcaktimin e rregullave për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide | Projektvendim | Ministri i Shendetesise dhe Mireqenies Sociale | Katërmujori II | Miratimi i ndryshimeve ne Ligjin 95/2014 'Per sherbimet dhe produktet biocide ne shendet publik" **Neni 100 i Kushtetutes ligji nr. 95/2015 Per sherbimet dhe produktet biocide ne shendetin publik"** . | Lehtesimi i procedurave te vendosjes ne treg te produkteve biocide kryesisht atyre qe jane te rregjistruara dhe qarkullojne ne vendet e BE | Jo | 3.2. Shëndetësia | Jo | Jo | Jo |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | dhe të procedurës së dhënies së autorizimit të vendosjes së tyre në treg" | | | | | | | | | | |
| 13 | Mbi disa ndryshime ligjore në Ligjin Nr. 93/2014 "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara" | Projektligj | Ministri i Shendetesise dhe Mireqenies Sociale | Katërmujori III | Harmonizimi i përmbajtjes së Ligjit nr. 93/2014 "Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara" dhe aktet nënligjore, me Direktivën EU/2019/882. **Nenet 78 dhe 83, pika 1 te Kushtetutes** | Legjislacioni kombëtar synon ndryshime lidhur me përfshirjen, aksesueshmërinë dhe integrimin e personave me aftësi të kufizuar, në përputhje me me standardet e BE-së. | Përmirësimi i këtij legjislacioni është një detyrim në Kriteret e Ndërmjetme, detyrimet e Kapitullit 23 dhe Kapitullit 19 | Shtylla III: Mirëqenie për të Gjithë | Jo | Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025 | PO Ndikime Mjedisore, Sociale, Ekonomike dhe Financiare |
| 14 | Për disa ndryshime në vkm nr. 522, datë 6.8.2014 "Për miratimin e rregullores "Për mbrojtjen e sigurisë dhe shëndetit të punëmarrësve nga risqet e lidhura me agjentët kimikë në punë" | Projektvendim | Ministri i Shendetesise dhe Mireqenies Sociale | Katërmujori III | Transpozimi i Direktivës së Komisionit 2000/39/KE të 8 qershorit 2000 që përcakton një listë të parë të vlerave kufitare treguese të ekspozimit në punë në zbatim të Direktivës së Këshillit 98/24/KE për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë së punëtorëve nga rreziqet që lidhen me agjentët kimikë në punë: ndryshuar nga Direktiva e Komisionit (BE) 2017/164 e 31 janarit 2017 që përcakton një listë të katërt të vlerave kufitare treguese të ekspozimit në punë në përputhje me Direktivën e Këshillit 98/24/KE, dhe që ndryshon Direktivat e Komisionit 91/322/KEE, 2000/39/KE OJ L 27, 1.2.2017, f. 115–120 https://eur-lex.europa.eu/eli/dir/2017/164/oj. Direktiva e Komisionit (BE) 2019/1831 e datës 24 tetor 2019 për krijimin e listës së pestë të vlerave kufi treguese të ekspozimit në punë në përputhje me Direktivën e Këshillit 98/24/EC e cila ka ndryshuar Direktivën e Këshillit 98/24. **Neni 100 i Kushtetutes ligji 10237 date 18.02.2010 "Per sigurine dhe shendetin ne pune"** | Projektakti parashikon të rregullojë vlerat limit të ekspozimit dhe rregullat e sigurisë dhe shëndetit në punën ndaj agjentëve kimikë në perputhje me kërkesat/rregullat e BE | PLANI I PUNËS - REFERENCA PËRFUNDIMTARE KLASTERI III "KONKURRUESHMËRIA DHE RRITJA GJITHËPËRFSHIRËSE" KAPITULL 19 - POLITIKA SOCIALE DHE E PUNËSIMIT | 2.4 Puna dhe kapitali njerezor . Garantojme kushte të barabarta pune, trajtim dinjitoz, sistem social të qëndrueshëm dhe të besueshëm. | Jo | Dokumenti Politik për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë dhe Plani I veprimit 2025-2030/ Ligji 10237 dt.18.02.2010 "Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë" | PO Ndikime mjedisore, ekonomike |
| 15 | Për disa ndryshime në vkm nr. 862, datë 24, 12.2019, "Për miratimin e kërkesave minimale të sigurise dhe shëndetit të punëmarrësve në bordin e mjeteve të lundrimit të gjatë" | Projektvendim | Ministri i Shendetesise dhe Mireqenies Sociale | Katërmujori III | Transpozimi i Direktivës së Këshillit 92/29/KEE të 31 Marsit 1992 mbi kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për trajtim të përmirësuar mjekësor në bordin e anijeve:<br>ndryshuar nga Direktiva e Komisionit (BE) 2019/1834 e 24 Tetorit 2019 që ndryshon Shtojcat II dhe IV të Direktivës së Këshillit 92/29/KEE në lidhje me përshtatjet thjesht teknike. **Ligji 10237 date 18.02.2010 "Per sigurine dhe shendetin ne pune"** | Projekakti parashikon të rregullojë kërkesat e sigurisë dhe shëndetit në punë në mjetet e lundrimit | PLANI I PUNËS - REFERENCA PËRFUNDIMTARE KLASTERI III "KONKURRUESHMËRIA DHE RRITJA GJITHËPËRFSHIRËSE" KAPITULL 19 - POLITIKA SOCIALE DHE E PUNËSIMIT | 2.4 Puna dhe kapitali njerezor . Garantojme kushte të barabarta pune, trajtim dinjitoz, sistem social të qëndrueshëm dhe të besueshëm. | Jo | Dokumenti Politik për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë dhe Plani I veprimit 2025-2030/ Ligji 10237 dt.18.02.2010 "Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë" | PO Ndikime mjedisore, ekonomike |
| 16 | Për disa ndryshime në VKM nr. 484, datë 29.06.2016 "Për mbrojtjen e punonjësve nga rreziqet që lidhen me ekspozimin ndaj azbestit në vendin e punës" | Projektvendim | Ministri i Shendetesise dhe Mireqenies Sociale | Katërmujori III | Transpozimi i "Direktivës2009/148/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 30 nëntorit 2009 mbi mbrojtjen e punëtorëve nga rreziqet që lidhen me ekspozimin ndaj asbestit në punë, siç është ndryshuar nga:<br>Direktiva (BE) 2023/2668 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 22 nëntorit 2023 që ndryshon Direktivën 2009/148/KE mbi mbrojtjen e punëtorëve nga rreziqet që lidhen me ekspozimin ndaj asbestit në punë. **Ligji 10237 date 18.02.2010 "Per sigurine dhe shendetin ne pune"** | Projektakti parashikon të rregullojë vlerat limit të ekspozimit dhe rregullat e sigurisë dhe shëndetit në punën ndaj azbestit në perputhje me kërkesat/rregullat e BE | PLANI I PUNËS - REFERENCA PËRFUNDIMTARE KLASTERI III "KONKURRUESHMËRIA DHE RRITJA GJITHËPËRFSHIRËSE" KAPITULL 19 - POLITIKA SOCIALE DHE E PUNËSIMIT+H9 | 2.4 Puna dhe kapitali njerezor . Garantojme kushte të barabarta pune, trajtim dinjitoz, sistem social të qëndrueshëm dhe të besueshëm. | Jo | Dokumenti Politik për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë dhe Plani I veprimit 2025-2030/ Ligji 10237 dt.18.02.2010 "Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë" | PO Ndikime mjedisore, ekonomike |
| 17 | Për miratimin e Stretegjisë Kombëtare për Shëndetin Mendor 2026-2030 dhe Planin e saj të Veprimit | Projektvendim | Ministri i Shendetesise dhe Mireqenies Sociale | Katërmujori III | Kjo nismë vjen në zbatim të angazhimeve dhe detyrimeve që rrjedhin nga aktivitetet e parashikuara në Planin e Punës për përmbushjen e piketave mbyllëse për Kapitullin 28, Nënkapitulli "Shëndeti Publik" , në kuadër të proceve të integrimit evropian. **Neni 100 I Kushtetutes dhe Ligji 10237 dt. 18.02.2010 "Per sigurine dhe shendetin ne pune".** | Dokumenti Strategjik Kombëtar për Shëndetin Mendor do të ndërtojë një qasje gjithëpërfshirëse dhe ndërsektoriale, ku shëndeti mendor trajtohet si prioritet kombëtar dhe pjesë e politikave publike në të gjitha fushat. Ai synon të garantojë akses të barabartë, respektim të të drejtave dhe shërbime cilësore dhe të integruara. Strategjia do të fokusohet në promovimin e mireeqnies, parandalim problemeve te shendetit mendor, identifikimin e hershem, trajtimin, rehabilitim dhe reintegrim si dhe përfshirjen aktive të komunitetit, duke krijuar mekanizma bashkëpunimi mes sektorëve të ndryshem, për të siguruar një sistem të qëndrueshëm dhe të harmonizuar me standardet evropiane. Harmonizimin i kuadrit strategjik shqiptar per shendetin mendor me parimet përkatëse të BE-së (Soft Acquis i BE) dhe OKB-së, si Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (CRPD), si dhe udhëzimet ndërkombëtare, përfshirë ëHO dhe OHCHR "Guidance on Mental Health, Human Rights and Legislation", ëHO Guidance on Mental Health Policy and Strategic Action Plans, dhe publikimin më të fundit të OBSH-së "ëHO Guidance on Mental Health Across Government Sectors". | Jo | 3.2. Shëndetësia | Jo | Strategjia Kombëtare e Shëndetësisë 2021–2030 Po, si pjese e Planit te Punës për përmbushjen e piketave mbyllëse për Kapitullin 28, Nënkapitulli "Shëndeti Publik" , angazhimeve dhe detyrimeve që rrjedhin nga në kuadër të proceve të integrimit evropian | Po |
| 18 | Strategjia Kombëtare per Drogat 2026-2030 dhe Plani I saj I veprimit | Projektvendim | Ministri i Shendetesise dhe Mireqenies Sociale dhe Ministria e Infrastruktures dhe Energjise | Katërmujori III | Kjo nismë vjen në zbatim të angazhimeve dhe detyrimeve që rrjedhin nga aktivitetet e parashikuara në Planin e Punës për përmbushjen e piketave mbyllëse për Kapitullin 28, Nënkapitulli "Shëndeti Publik" , në kuadër të proceve të integrimit evropian. **Neni 100 I Kushtetutes Ligji Per shendetin Publik"** | Strategjia Kombëtare per Drogat 2026-2030, si nje dokument nder-sektorial qe do te mbuloje gjithë spektrin e përgjigjes kundër drogës nga Reduktimi i ofertës , Reduktimi i kërkesës dhe Reduktimi i dëmit. Reduktimi i ofertës përfshin masa për të kufizuar prodhimin, shpërndarjen dhe trafikun e paligjshëm të drogave, përmes forcimit të kapaciteteve të zbatimit të ligjit, kontrollit kufitar dhe bashkëpunimit ndërkombëtar. Nderkohe Reduktimi i kërkesës synon uljen e përdorimit të | Jo | 3.2. Shëndetësia | Jo | Po, si pjese e Planit te Punës për përmbushjen e piketave mbyllëse për Kapitullin 28, Nënkapitulli "Shëndeti Publik" , angazhimeve dhe detyrimeve që rrjedhin nga në kuadër të proceve të integrimit evropian | Po |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | drogave përmes programeve parandaluese, edukimit publik, trajtimit dhe rehabilitimit të përdoruesve, si dhe promovimit të shëndetit mendor. Gjithahstu Reduktimi i dëmit fokusohet në minimizimin e pasojave shëndetësore dhe sociale të përdorimit të drogave, përmes shërbimeve të reduktimit të rrezikut, aksesit në kujdes shëndetësor dhe programeve mbështetëse për grupet vulnerabel. Synohet qe strategjia kombetare të jetë e harmonizuar me EU Acquis per Drugsat (soft acquis), duke u bazuar veçanërisht në Strategjinë e BE-së për Drogat dhe Planin e Veprimit, dhe përcaktimin e objektivave, masave dhe mekanizmave të zbatimit, duke integruar praktikat më të mira evropiane dhe duke garantuar përputhshmëri me standardet e BE-së. | | | | | |
| 19 | Amendimi i Ligjit Nr. 9636 "Për Mbrojtjen e Shëndetit nga Produktet e Duhanit" dhe akteve nënligjore përkatëse | Projektligj | Ministri i Shendetesise dhe Mireqenies Sociale dhe Ministria e Ekonomise dhe Inovacionit | Katërmujori III | Kjo nismë vjen në zbatim të angazhimeve dhe detyrimeve që rrjedhin nga aktivitetet e parashikuara në Planin e Punës për përmbushjen e piketave mbyllëse për Kapitullin 28, Nënkapitulli "Shëndeti Publik" , në kuadër të proceve të integrimit evropian. **Nenet 78, 83 te Kushtetutes ligji nr. 10138, date 11.05.2009 "Per shendetin Publik".** | Ligji i ri duhet te jete plotesisht i transpozuar me Acquis te BE ne fushen e duhanit. Hartimi i legjislacionit që siguron përafrim të plotë me acquis të BE-së për kontrollin e duhanit, duke përfshirë të gjitha direktivat, vendimet zbatuese. dhe udhëzimet teknike për harmonizimin e dispozitave kombëtare me standardet e BE-së mbi prodhimin, paraqitjen, shitjen, reklamimin, sponsorizimin, paralajmërimet shëndetësore, gjurmueshmërinë dhe elementet e sigurisë për produktet e duhanit, duke siguruar që dokumenti ligjor të reflektojë praktikat më të mira dhe të jetë në përputhje me detyrimet ndërkombëtare. Synohet integrimi i plote i dispozitave për strukturat administrative dhe teknike, mekanizmat e zbatimit dhe masat për ndërtimin e kapaciteteve, përfshire përcaktimin e përgjegjësive institucionale, nevojave për staf dhe planeve të trajnimit për të garantuar zbatimin efektiv deri në momentin e anëtarësimit. | Jo | 3.2. Shëndetësia | Jo | STRATEGJIA KOMBËTARE E SHËNDETËSISË 2021-2030 | Jo |
| 20 | Mbi kërkesat e cilësisë së ujit të pijshëm, që do të shfuqizojë vendimin nr. 379, datë 25.05.2016 për miratimin e rregullores "Cilësia e ujit të pijshëm", i hartuar në përaftrim të Direktivës 98/83/KE, shfuqizuar nga Direktiva 2020/2184 (Recast) qe do perafrohet. | Projektvendim | Ministri i Shendetesise dhe Mireqenies Sociale | Katërmujori III | Projektvendimi mbi kërkesat e cilësisë së ujit të pijshëm përafron direktivën (BE) 2020/2184 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit (recast), që është një nga direktivat e acquis për tu përafruar në zbatim të angazhimeve dhe detyrimeve që rrjedhin nga aktivitetet e parashikuara në Planin e Punës për përmbushjen e piketave mbyllëse për Kapitullin 27 "Mjedisi dhe ndryshimet klimatike" , në kuadër të proceve të Integrimit Evropian. **Ligji 10138 date 11.05.2009 "Per shendetin publik " dhe ligji nr. 111/2012 Per menaxhimin e integruar te burimeve ujore.** | Akt i përditësuar dhe përfshirës i gjithë kërkesave të acquis për ujin e destinuar për konsum nga njerëzit. | Kapitulli 27 | 3.2. Shëndetësia | Jo | STRATEGJIA KOMBËTARE E SHËNDETËSISË 2021-2030 | Jo |
| 21 | Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.121/2016 "Për shërbimet e përkujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë" | Projektligj | Ministri i Shendetesise dhe Mireqenies Sociale | Katërmujori III | Projektakti për miratimin e ndryshimeve në Ligjin nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror" propozohet me qëllim përmirësimin e kuadrit ligjor ekzistues dhe përshtatjen e tij me zhvillimet institucionale, strategjike dhe ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes sociale. Pas zbatimit disavjeçar të ligjit, janë identifikuar një sërë problematikash që lidhen me paqartësi konceptuale, mbivendosje kompetencash ndërmjet niveleve të qeverisjes, mungesë harmonizimi me ligje të tjera si Ligji për vetëqeverisjen vendore dhe Ligji për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve, si dhe me nevojën për të rregulluar më mirë proceset e deinstitucionalizimit, inspektimit, certifikimit profesional dhe financimit të shërbimeve sociale. Ndryshimet synojnë të sigurojnë qartësi ligjore, efikasitet institucional, mbrojtje më të mirë të përfituesve dhe përputhshmëri me standardet ndërkombëtare, veçanërisht me Konventën e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Udhëzimet e OKB-së për Kujdesin Alternativ të Fëmijëve. **Nenet 78 dhe 83, pika 1 te Kushtetutes** | Projektakti parashikon përmirësimin dhe harmonizimin e përkufizimeve ligjore, duke dalluar qartë ndërmjet roleve dhe funksioneve të asistentit personal dhe shërbimit të asistencës personale, si dhe ristrukturimin e klasifikimit të shërbimeve të kujdesit social për të siguruar kategorizim të unifikuar. Ai sanksionon procesin e deinstitucionalizimit si pjesë të kornizës ligjore dhe qartëson rregullat për shërbimet e asistencës personale në përputhje me parimet e përfshirjes dhe mosdiskriminimit. Ndryshimet përfshijnë gjithashtu forcimin e mekanizmave të inspektimit dhe monitorimit, rregullimin e certifikimit dhe akreditimit të praktikuesve socialë, qartësimin e rolit të pushtetit vendor në financimin e shërbimeve, si dhe përmirësimin e rregullave për fondet sociale vendore. Po ashtu, projektakti synon harmonizimin e përgjegjësive ndërmjet Njësive për | Kapitulli 19 | 3.3. Familja, Politikat Sociale dhe Strehimi | Jo | Strategjia Kombetare e Mbrojtjes Sociale 2024-2030 | PO Ndikime Sociale, Ekonomike dhe Financiare Programi "Perkujdesi Social" 10430 MSHMS |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Njësive të Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit, përfshirjen e plotë të të dhënave në Regjistrin Elektronik Kombëtar të Shërbimeve të Kujdesit Social dhe qartësimin e procedurave për decentralizimin e shërbimeve. Një ndër risitë e rëndësishme është rishikimi i dispozitave mbi kujdestarinë, me qëllim diferencimin e qartë nga kujdesi fosters dhe përafrimin me ligjin e ri për kujdesin alternativ. | | | | | |
| 22 | Për një ndryshim në vendimin nr 78, datë 7.2.2007 Për masën, kriteret dhe procedurat e përfitimit të një pakete të veçantë higjieno-sanitare, për invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë", të ndryshuar | Projektvendim | Ministri i Shendetesise dhe Mireqenies Sociale | Katërmujori III | Paketa higjieno-sanitare e paraplegjikëve dhe tetraplegjikëve indeksohet në bazë të indeksit të cmimeve të konsumit, sipas pikës 1.1 të vendimit nr. 78, datë 7.2.2007 "Për masën, kriteret dhe procedurat e përfitimit të një pakete të veçantë higjieno-sanitare, për invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë", të ndryshuar . **Neni 9 i ligjit nr.8626, datë 22.6.2000 "Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar** | Projektakti parashikon përmirësimin e përfitimeve në pagesa për mbulimin e shpenzimeve për përballimin e vlerës së paketës së domosdoshme me materiale të veçanta higjieno-sanitare për paraplegjikët dhe tetraplegjikët, në përputhje me vlerën e materialeve të kësaj pakete në treg | Jo | 3.3. Familja, Politikat Sociale dhe Strehimi | Jo | Strategjia Kombetare e Mbrojtjes Sociale 2024-2030 | PO Ndikime Sociale, Ekonomike dhe Financiare Programi "Perkujdesi Social" 10430 MSHMS |
| 23 | Për miratimin e Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2027-2030 | Projektvendim | Ministri i Shendetesise dhe Mireqenies Sociale | Katërmujori III | Në përfundim të Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmjëve 2021-2026, do të hartohet dokumenti i ri strategjik. **Neni 39, shkronja "b", e ligjit nr. 18/2017, "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës"** | Agjenda do të parashikojë masa dhe objektiva, që kanë synim përmirësimin e cilësisë së jetës së fëmijëve dhe adoleshentëve, si në familje ashtu edhe komunitet. | Kapitulli 19 "Politikat Sociale dhe Punesimi" dhe Kapitulli 23 "Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore" | Shtylla III: Mirëqenie për të Gjithë | Jo | Jo | PO Ndikime Mjedisore, Sociale, Ekonomike dhe Financiare |
| 24 | Për disa ndryshime në VKM nr. 520, datë 6.8.2014 "Për miratimin e rregullores "Për mbrojtjen e sigurisë dhe shëndetit të punëmarrësve nga risqet e lidhura me kancerogjenë dhe mutagene në punë" | Projektvendim | Ministri i Shendetesise dhe Mireqenies Sociale | Katërmujori III | Transpozimi i "Direktivës 2004/37/KE Direktiva e Këshillit mbi mbrojtjen e punëtorëve nga rreziqet që lidhen me ekspozimin ndaj kancerogjenëve ose mutagjenëve në punë (Direktiva e gjashtë individuale sipas kuptimit të Nenit 16(1) të Direktivës së Këshillit 89/391/KEE): Ndryshuar nga:<br>a) Direktiva 2014/27/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 26 shkurtit 2014 që ndryshon Direktivat e Këshillit 92/58/KEE, 92/85/KEE, 94/33/KEE, 98/24/KEE dhe Direktivën 2004/37/KEE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, me qëllim që t'i përafrojë ato me Rregulloren (KE) Nr. 1272/2008 mbi klasifikimin, etiketimin dhe paketimin e substancave dhe përzierjeve<br>OJ L 65, 5.3.2014, f. 1<br>https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?qid=1551976646463&uri=CELEX:32014L0027<br>b) Direktiva 2017/2398/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 12 dhjetorit 2017 që ndryshon Direktivën 2004/37/KE për mbrojtjen e punëtorëve nga rreziqet që lidhen me ekspozimin ndaj kancerogjenëve ose mutagjenëve në punë OJ L 345, 27.12.2017, f. 87, http://data.curopa.eu/eli/dir/2017/2398/oj.<br>c) Direktiva (BE) 2019/130 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 16 janarit 2019 që ndryshon Direktivën 2004/37/KE për mbrojtjen e punëtorëve nga rreziqet që lidhen me ekspozimin ndaj kancerogjenëve ose mutagjenëve në punë OJ L 30, 31.1.2019, f. 112, http://data.curopa.eu/eli/dir/2019/130/oj.<br>d) Direktiva (BE) 2019/983 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 5 qershorit 2019 që ndryshon Direktivën 2004/37/KE për mbrojtjen e punëtorëve nga rreziqet që lidhen me ekspozimin ndaj kancerogjenëve ose mutagjenëve në punë OJL 164, 20.6.2019, f. 23-29 http://data.europa.eu/eli/dir/2019/983/oj.<br>e) Direktiva (BE) 2022/431 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 9 marsit 2022 që ndryshon Direktivën 2004/37/KE për mbrojtjen e punëtorëve nga rreziqet që lidhen me ekspozimin ndaj kancerogjenëve ose mutagjenëve në punë OJ L 88, 16.3.2022, f. 1-14 dhe që ndryshon Direktivën e Komisionit 2000/39/KE OJ L 279, 31.10.2019, . 31-34, https://eur-lex.europa.cu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex%3A32019L1831. **Ligji nr. 10237 date 18.02.2010 "Per sigurine dhe shendetin ne pune"** | Projektakti parashikon të rregullojë vlerat limit të ekspozimit dhe rregullat e sigurisë dhe shëndetit në punën ndaj karcinogenëve/mutagenët në perputhje me kërkesat/rregullat e BE | PLANI I PUNËS - REFERENCA PËRFUNDIMTARE KLASTERI III "KONKURRUESHMËRIA DHE RRITJA GJITHËPËRFSHIRËSE" KAPITULL 19 - POLITIKA SOCIALE DHE E PUNËSIMIT | 2.4 Puna dhe kapitali njerezor . Garantojme kushte të barabarta pune, trajtim dinjitoz, sistem social të qëndrueshëm dhe të besueshëm. | Jo | Dokumenti Politik për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë dhe Plani I veprimit 2025-2030/ Ligji 10237 dt.18.02.2010 "Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë" | Ndikime mjedisore, ekonomike |

## Programi i Përgjithshëm Analitik i Projektakteve për vitin 2026

### MINISTRIA E EKONOMISE DHE INOVACIONIT

| Nr. | Titulli i projektaktit | Lloji i projektaktit | Ministri propozues | Katërmujori | Arsyet kryesore për propozimin e projektaktit | Çështjet kryesore që parashikon të rregullojë projektakti | A është parashikuar projektakti në PKIE? Nëse po, të specifikohet kapitulli përkatës | Përputhshmëria e projektaktit me programin politik qeverisës 2021-2025<br><br>Nëse përputhet, të jepet referenca e saktë në progam | A është akt i një rëndësie të veçantë e prioritare? | Lidhja e projektaktit me strategjitë kombëtare dhe sektoriale<br><br>Nëse lidhet, të specifikohen strategjitë | Ndikimet e mundshme ekonomike, financiare, sociale dhe mjedisore<br><br>Përgjigjuni me Po/Jo për ndikimet përkatëse |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9902, datë 17.04.2008 "Për mbrojtjen e konsumatorit" të ndryshuar. | Projektligj | Ministri i Ekonomisë dhe Inovacionit | Katërmujori I | Nenet 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës. Arsyeja e propozimit të projektaktit është harmonizimi i mëtejshëm me Direktivën 2019/2161 (Direktiva e Modernizimit) , Direktivën 2024/825 (Direktiva e Tranzicionit Ekologjik), Direktivën 2019/770 (Kontratat për furnizimin e përmbajtjeve dhe shërbimeve digjitale), Direktivën 2019/771 (Kontratat për shitjen e mallrave), si dhe Rregulloren (BE) 2017/2394 në kuadër të Kapitullit 28 të acquis "Mbrojtja e konsumatorit dhe e shëndetit". Detyrimi për të përafruar legjislacionin shqiptar me Kapitullin 1 të legjislacionit europian buron nga neni 76 "Mbrojtja e konsumatorit" i Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit (MSA), ku përcaktohet se Shqipëria duhet të harmonizojë legjislacionin e saj me atë të Bashkimit Europian (BE), por gjithashtu të sigurojë që ai të zbatohet dhe të vihet në praktikë. | Përafrimi i mëtejshëm me Direktivën 2019/2161 (Direktiva e Modernizimit) , Direktivën 2024/825 (Direktiva e Tranzicionit Ekologjik), Direktivën 2019/770 (Kontratat për furnizimin e përmbajtjeve dhe shërbimeve digjitale), Direktivën 2019/771 (Kontratat për shitjen e mallrave), si dhe Rregulloren (BE) 2017/2394 në kuadër të Kapitullit 28 të acquis "Mbrojtja e konsumatorit dhe e shëndetit". | Kapitulli 28 "Mbrojtja e konsumatorit dhe shëndetit" | Shtylla "Shqipëri e fortë"; Fusha "Integrimi Evropian | Jo | Angazhimi për miratimin e projektligjit është reflektuar edhe në Strategjinë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe Mbikëqyrjen e Tregut 2024–2030 (miratuar me VKM-në nr.326, datë 29.05.2024). | Po, ekonomike, financiare, sociale |
| 2 | "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 489, datë 15.12.2011 "Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve jo-ushqimore", i ndryshuar | Projektligj | Ministri i Ekonomisë dhe Inovacionit | Katërmujori I | Nenet 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës. Harmonizimi i mëtejshëm me Rregulloren (BE)2019/1020 për mbikëqyrjen e tregut dhe përputhshmërinë e produkteve, në kuadër të Kapitullit 1 të acquis – Lëvizja e lirë e mallrave. Detyrimi për të përafruar legjislacionin shqiptar me Kapitullin 1 të legjislacionit evropian buron nga Neni 70 dhe 75 i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA), ku përcaktohet se Shqipëria duhet të harmonizojë teknikisht legjislacionin e saj kombëtar me atë të Bashkimit Evropian (BE), por gjithashtu të sigurojë që ai të zbatohet dhe të vihet në praktikë. | Projektligji do të përafrojë Rregulloren (BE) 2019/1020 së Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 20 qershor 2019 "Për mbikëqyrjen e tregut dhe përputhshmërinë e produkteve". Projektligji i planifikuar rregullon tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut për produktet jo ushqimore në fushëzbatimin e saj. Ai përcakton funksionet, kompetencat dhe detyrimet e strukturave të mbikëqyrjes së tregut, si dhe detyrimet e operatorëve ekonomikë, sipas zinxhirit të furnizimit të produkteve. | Kapitulli 1 "Lëvizja e lirë e mallrave" | Shtylla "Shqipëri e fortë"; Fusha "Integrimi Evropian" | Jo | Angazhimi për miratimin e projektligjit është reflektuar edhe në Strategjinë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe Mbikëqyrjen e Tregut 2024–2030 (miratuar me VKM nr. 326, datë 29.05.2024). | Po, ekonomike, financiare |
| 3 | "Për lirinë e vendosjes dhe ofrimit të shërbimeve në Republikën e Shqipërisë" | Projektligj | Ministri i Ekonomisë dhe Inovacionit | Katërmujori I | Nenet 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës. Arsyeja e propozimit të projektaktit është harmonizimi i mëtejshëm me Direktiven 2006/123/KE te Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 12 dhjetor 2006, "Për shërbimet në tregun e brendshëm" CELEX: 32006L0123, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L 376, datë 27.12.2006 Nevoja për përafrimin e plotë vjen si rezultat i mungesës së një serë parashikimesh të rëndësishme të domosdoshme në kuadër të lirisë së ofrimit të shërbimeve – si p.sh. shërbimet ndërkufitare, garancitë e përgjegjësisë profesionale, shërbimet mutlidisiplinore etj. | Synohet përafrimi i ligjit nr. 66/2016 "Për shërbimet në Republikën e Shqipërisë" me direktivën 2006/123/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 12 dhjetor 2006, "Për shërbimet në tregun e brendshëm" CELEX: 32006L0123, | Kapitulli 3 "Lëvizja e lirë e Sherbimeve" | Shtylla "Shqipëri e fortë"; Fusha "Integrimi Evropian" | Jo | **Jo** | Po, ekonomike, financiare |
| 4 | Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar | Projektligj | Ministri i Ekonomisë dhe Inovacionit | Katërmujori I | Nenet 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës.Arsyeja e propozimit të projektaktit është përafrimi me disa direktiva të Bashkimit Europian | Të drejtat e aksionerëve, bashkimi dhe përthithja e shoqërive ndërkufitare. | Kapitulli 6 "Shoqëritë tregtare dhe raportimi financiar" | Jo | Jo | Jo | Po, ekonomike |
| 5 | "Për përcaktimin e procedurave dhe rregullave për administrimin e sistemit elektronik "e-Inspektimi" nga Inspektorati i Përgjithshëm, mbikëqyrjen online dhe në terren dhe raportimin", në proces brenda institucionit. (Inspektimi) | Projektvendim | Ministri i Ekonomisë dhe Inovacionit | Katërmujori I | Neni 13, pika 6 të ligjit nr. 99/2024 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", | Projektakti rregullon procedurat e ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit të Përgjithshëm për administrimin, përmbajtjen dhe sigurinë e të dhënave të sistemit elektronik "e-Inspektimi", si dhe mënyrën e raportimit dhe kërkimit të informacionit. Gjithashtu përcakton rregullat për mbikëqyrjen online dhe në terren të procedurave të inspektimit dhe funksionimin e integruar të sistemit me bazat e tjera shtetërore të të dhënave. | **Jo** | Jo | Jo | **Jo** | Po, sociale |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 6 | Për miratimin e rregullave të përgjithshme për programimin e inspektimeve, metodologjinë e vlerësimit të riskut, përcaktimin e periudhës maksimale të inspektimeve vjetore dhe mënyrën e llogaritjes së tyre".(Inspektimi) | Projektvendim | Ministri i Ekonomisë dhe Inovacionit | Katërmujori I | Neni 32, pika 8 të ligjit nr. 99/2024 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë" | Projektakti përcakton rregullat e përgjithshme për programimin vjetor dhe mujor të inspektimeve, metodologjinë e vlerësimit të riskut dhe klasifikimin e subjekteve mbi bazë risku. Gjithashtu rregullon përcaktimin e periudhës maksimale të inspektimeve vjetore dhe mënyrën e llogaritjes së saj për çdo kategori subjekti. | **Jo** | Jo | Jo | Jo | Po, sociale |
| 7 | "Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të metodologjisë së përcaktimit të dënimeve administrative në procesin e inspektimeve". | Projektvendim | Ministri i Ekonomisë dhe Inovacionit | Katërmujori I | Neni 44, pika 7 të ligjit nr. 99/2024 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", | Projektakti përcakton rregullat dhe metodologjinë e unifikuar për përcaktimin e dënimeve administrative nga inspektoratet, duke vendosur kriteret, faktorët e riskut dhe sistemin e pikëzimit për caktimin e masës së dënimit. Gjithashtu rregullon procedurat për zbatimin e dënimeve në sistemin "e-Inspektimi", klasifikimin e dënimeve administrative dhe mënyrën e aplikimit të tyre në përputhje me parimin e proporcionalitetit. | Jo | Jo | Jo | Jo | Po, sociale |
| 8 | Ligji "Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë" | Projektligj | Ministri i Ekonomisë dhe Inovacionit | Katërmujori II | Nenet 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës | Përfundom afati i ligjit në Dhjetor 2026 | Jo | Po, përputhet me Programin Qeverisës , Prioritetet për përmirësimin e shërbimeve për investitorët | Jo | Strategjia për Zhvillimin e Biznesit dhe Investimeve (BIDS); Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2030; Strategjia e Zhvillimit të Turizmit 2030; Strategjia e Energjisë; Strategjia për Zhvillimin Rural dhe Bujqësisë | Ekonomike: Po; Financiare: Po; Sociale: Po; |
| 9 | "Për miratimin e raportit për ndihmat shtetërore të vitit 2025" | Projektvendim | Ministri i Ekonomisë dhe Inovacionit | Katërmujori II | .Projektvendimi hartohet në bazë të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 17, shkronja dh), nenit 18, shkronja e) dhe nenit 32, pika 2, e Ligjit nr. 9374, datë 21.04.2005 "Për ndihmën shtetërore",të ndryshuar.Përgatitja e këtij projektvendimi është në përputhje me nenin 71, pika 5 e Marrëveshjes së Stabilizim- Asociimit ndërmjet Komuniteteve Evropiane e Shteteve të tyre Anëtare dhe Republikës së Shqipërisë. | Qëllimi i raportimit të rregullt vjetor mbi ndihmat shtetërore të vitit paraardhës është garantimi i transparencës në fushën e ndihmës shtetërore. Ashtu si në raportet e tjera edhe këtë vit, në mënyrëne paraqitjes dhe analizës së të dhënave në raport është ndjekur metodologjia e Komisionit Evropian, duke përshkruar zhvillimet kryesore në fushën e ndihmës shtetërore. | Kapitulli 8 | Shtylla 2.2 Politikat për Biznesin | Jo | Jo | Po, ekonomik, social dhe institucional |
| 10 | "Për indeksimin e Pensioneve" | Projektvendim | Ministri i Ekonomisë dhe Inovacionit | Katërmujori II | Neneve 61 e 88 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar | Indeksimi i pensioneve sipas këtij projektvendimi ka për qëllim që të mbajë në nivel real masën e pensioneve dhe përfitimeve të tjera sociale duke i përshtatur me efektet e rritjes së indeksit të çmimeve të mallrave të konsumit për shportën e pensionistëve. | Kapitulli 19 Politikat sociale dhe punësimi | Kujdesi për të moshuarit dhe qytetarët në nevojë | Jo | Jo | Jo |
| 11 | Per disa shtesa dhe ndryshime ne vendimin nr. 179, datë 26.2.2020 "Për rregullat, kushtet dhe procedurat e privatizimit të banesave që kanë qenë subjekt i ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, "për privatizimin e banesave shtetërore", dhe të ligjit nr. 9321, datë 25.11.2004, "për privatizimin e banesave dhe objekteve të kthyera në banesa, të ndërtuara me fondet e shoqërive dhe të ndërmarrjeve shtetërore" | Projektvendim | Ministri i Ekonomisë dhe Inovacionit | Katërmujori II | Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 1, shkronja "a", e 3, të nenit 77, të ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social | Rishikimi dhe përmirësimi i procedurave të privatizimit që kryejne Enti Kombëtar i Banesave EKB dhe bashkitë në zbatim të tij, për privatizimin e banesave dhe objekteve të kthyera në fond banese dhe që kanë qenë subjekt i ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992 dhe ligjit nr. 9321 datë 25.11.2004 të cilat mbetën pa u privatizuar dhe aktualisht janë në pronësi të shtetit apo EKB-së | Jo | Jo | Jo | Jo | Po, sociale dhe ekonomike |
| 12 | "Për përcaktimin e koeficientit te indeksimit të bazës së vlerësuar vjetore, për llogaritjen e pensioneve" | Projektvendim | Ministri i Ekonomisë dhe Inovacionit | Katërmujori II | Pikave 1 e 3, të nenit 59, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", | Koeficientët e indeksimit të pagave, mbi të cilat janë paguar kontributet për sigurimet shoqërore të detyrueshme, për efekt të llogaritjes së bazës së vlerësuar për llogaritjen fillestare të pensioneve | Kapitulli 19 Politikat sociale dhe punësimi | Shtylla "Familja"; Fusha Kujdesi për të moshuarit dhe qytetarët në nevojë | Jo | Jo | Po, financiare dhe ekonomike |
| 13 | ProjektVendimi për miratimin e Planit të Veprimit për përmirësimin e renditjes së shqipërisë në indeksin e OECD-së për politikat e NMV-ve | Projektvendim | Ministri i Ekonomisë dhe Inovacionit | Katërmujori II | Qellimi i këtij projekt-vendimi është i lidhur me VKM Nr. 621, datë 10.10.2024 "Për miratimin e dokumentit të politikës "Agjenda Kombëtare e Reformave 2024–2027", në kuadër të instrumentit të Bashkimit Evropian "Faciliteti për reforma dhe rritje për Ballkanin Perëndimor" (hartimi dhe miratimi i Planit të Veprimit për përmirësimin e renditjes së shqipërisë në indeksin e OECD-së për | Në funksion të përshpejtimit të procesit të integrimit evropian, ashtu siç parashikohet në VKM nr. 621/2024, përmirësimi i treguesve të SME Policy Index, i cili lidhet drejtpërdrejt me Kapitullin 20 – Ndërmarrjet dhe | Kapitulli 20 | me Programin e Qeverisë 2021-2025 dhe 2025-2029 (Shtylla 2.2 Politikat për Biznesin) | Jo | VKM Nr. 621, datë 10.10.2024 "Për miratimin e dokumentit të politikës "Agjenda Kombëtare e Reformave 2024–2027", Strategjia SKZHIE 2030 dhe Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2021-2027 | Po, sociale dhe ekonomike |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | politikat e NMV-ve është masë e parashikuar në Agjendën e Reformave) | Politikat Industriale, ndikon në mënyrë direkte në progresin dhe raportimin e Shqipërisë për këtë kapitull, në kuadër të negociatave të anëtarësimit në Bashkimin Evropian. | | | | | |
| 14 | Projektvendim Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Industrisë 2026-2030 | Projektvendim | Ministri i Ekonomisë dhe Inovacionit | Katërmujori II | Projektakti synon përafrimin e kuadrit ligjor me dispozitat e Rregulloreve të BE-së si vijon:<br>Komunikata (BE) Nr. (2020) 102 e Komisionit Europian për Parlamentin Europian, Këshillin Europian, Komitetin Ekonomik dhe Social Europian dhe Komitetin e Rajoneve për një Strategji të re Industriale për Evropën;<br>- Komunikata (BE) Nr. (2021) 350 e Komisionit Europian për Parlamentin Europian, Këshillin, Komitetin Ekonomik dhe Social Europian dhe Komitetin e Rajoneve për Përditësimin e Strategjisë së re Industriale 2020: Ndërtimi i një tregu të vetëm më të fortë për rimëkëmbjen e Europës. | Strategjia Kombëtare e Industrisë 2026-2030 do të adresojë të gjitha problematikat për zhvillimin e konkurrueshmërisë dhe industrializimit të ekonomisë së vendit në bashkërendim me politikat sektoriale zhvillimore të vendit, sipas standarteve të Bashkimit Evropian. Strukturat e MEI përfshirë edhe Drejtorinë e Politikave të Nxitjes së Biznesit kanë si mision kryesor mbështetetjen e konkurrueshmërisë së industrisë së vendit, rritjen dhe qëndrueshmërinë e biznesit dhe përmirësimin e klimës së biznesit në ekonominë e vendit tonë. | Kapitulli 20 | Shtylla 2.2 Politikat për Biznesin | Jo | Jo | Po, sociale |
| 15 | "Për tregjet e kriptoaseteve " | Projektligj | Ministri i Ekonomisë dhe Inovacionit | Katërmujori III | Përafrimi i legjislacionit kombëtar me atë të BE: Të transpozohet plotësisht me Rregulloren e BE 2023/1114/EU (MiCA) dhe të harmonizohet me kuadrin ekzistues për shërbimet e investimit, pagesave dhe parasë elektronike, duke garantuar siguri juridike dhe koherencë rregullatore.Kuadri rregullator për kripto-asetet të rregullohet duke i përafruar kërkesat rregullatore me Direktivën 2014/65/EU (MIFID II) dhe Direktivën 2009/110/EC (EMD2), duke vendosur standarde të njëjta me ato që zbatohen për instrumentet financiarë dhe paranë elektronike. Ai synon gjithashtu të mbështesë teknologjitë e reja dhe krijojë kushte të favorshme për bizneset inovative shqiptare, duke u ofruar rregulla të qarta dhe të harmonizuara me BE-në për të nxitur konkurrueshmërinë, investimet dhe integrimin në tregun evropian, ndërsa ruan balancën mes mbrojtjes së konsumatorit dhe nxitjes së inovacionit. | Projektligji do të krijojë një kuadër të qartë dhe të qëndrueshëm rregullator, që u jep siguri juridike të gjithë pjesëmarrësve në tregun e kripto-aseteve. Përmes harmonizimit me rregullat e investimeve, pagesave dhe parasë elektronike, projekti do të ndërtojë një sistem të bashkërenduar dhe funksional. Gjithashtu një vend të veçantë zë mbrojtja e investitorëve, duke vendosur kërkesa të forta për qeverisje, transparencë, siguri kibernetike, dhe duke parandaluar abuzimet me tregun dhe pastrimin e parave, me vendosjen e mekanizmave të posaçëm kontrolli. Projektligji synon të rrisë besueshmërinë e vendit dhe të forcojë integritetin e tregut financiar modern. | Kapitulli 9 | Jo | Jo | “Strategjia e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare 2023–2027” të miratuar më 27 prill 2023, me Vendimin nr. 266 të Këshillit të Ministrave. | Po, sociale |
| 16 | Ligji për Dizajnet Industriale | Projektligj | Ministri i Ekonomisë dhe Inovacionit | Katërmujori III | Përafrimi i legjislacionit kombëtar me atë të BE: Përafrimi i plotë i legjislacionit kombëtar të dizenjove me legjislacionin e BE-së Rregullimi i sistemit të dhënies dhe mbrojtjes: Miratimi i një ligji specifik për dizenjot.<br>Lehtësimi i zbatimit të drejtave: Lehtësimi i zbatimit të të drejtave të lidhura me dizenjot.<br>Sigurimi i nivelit të njëjtë të jmbrojtjes: Sigurimi i një mbrojtjeje të njëjtë të të drejtave të dizenjove sipas legjislacionit të BE-së.<br>Parashikimet ligjore për masa të përkohshme: Rregullimi i masave të përkohshme në rast të shkeljeve. | Mbrojtja e konsumatorëve: Ndërhyrja e qeverisë do të ndihmojë në krijimin e një mjedisi më të sigurt dhe më të drejtë për konsumatorët.<br>Përputhshmëria me standardet evropiane e ndërkombëtare: Sektori i pronësisë industriale duhet të përputhet me direktivat dhe standardet ndërkombëtare për të lehtësuar integrimin në tregjet globale.<br>Rritja e besimit në sektor: Ndërhyrja e qeverisë ndihmon në rritjen e besimit të palëve të interesuara, i cili është thelbësor për nxitjen dhe zhvillimin e inovacionit në vend. | Kapitulli 7 | Shtylla "Shqipëria Europiane"; 1.1. Anëtarësimi në Bashkimin Europian | Jo | Strategjisë së Pronësisë Intelektuale: Përmbushja e objektivave të përcaktuara në strategji. | Jo |
| 17 | Ligji për Treguesit Gjeografikë, me efekt që nga data e anëtarësimit | Projektligj | Ministri i Ekonomisë dhe Inovacionit | Katërmujori III | Pjesë e angazhimeve të vendit për të përmbushur standardet dhe rregullat e BE-së në fushën e mbrojtjes së të drejtave të pronësisë intelektuale, veçanërisht për sa i përket treguesve gjeografikë (TG) dhe etiketave të origjinës.<br>Ky ligj përcakton se si mund të regjistrohen dhe mbrohen treguesit gjeografikë për produktet që kanë një lidhje të veçantë me një territor ose rajon të caktuar. Kjo ndihmon në mbrojtjen e emrave të produkteve të njohura, si p.sh. "Dajti" për verën, ose "Gjakova" për një lloj produkti ushqimor. | Projektakti është një hap i rëndësishëm për të mbrojtur identitetin dhe traditat e produkteve shqiptare, si dhe për të krijuar mundësi të reja për tregtinë dhe zhvillimin ekonomik.<br>Definicioni dhe Klasifikimi i Treguesve Gjeografikë<br>Procedurat për Regjistrimin e Treguesve Gjeografikë.<br>Mbrojtja Ligjore dhe Parandalimi i Shkeljeve<br>Verifikimi dhe Monitorimi i Cilësisë së Produkteve<br>Përfitimet Ekonomike dhe Promovimi i Produkteve të Mbrojtura.<br>Shpërndarja e Treguesve Gjeografikë për Produktet e Dallueshme. | Kapitulli 7 | Shtylla "Shqipëria Europiane"; 1.1. Anëtarësimi në Bashkimin Europian | Jo | Strategjisë së Pronësisë Intelektuale: Përmbushja e objektivave të përcaktuara në strategji. | Jo |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Mbështetje për Prodhuese dhe Konsumatorë. | | | | | |
| 18 | Projektligj "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.15/2019 "Për nxitjen e punësimit" | Projektligj | Ministri i Ekonomisë dhe Inovacionit | Katërmujori III | Pjesë e angazhimeve të vendit për të përmbushur standardet dhe rregullat e BE-së në fushën e politikave të punësimit për kapitujt 2 dhe 19. Qëllimi i projektligjit është përmirësimi i sistemit të shërbimeve të punësimit, programeve aktive te tregut te punes për punëkërkuesit, punëdhënësit dhe grupet e veçanta, në kuadër të zgjerimit të politikës së tregut të punës; | Qëllimi i projektligjit është zgjerimi i shërbimeve të punësimit për punëkërkuesit, punëdhënësit dhe grupet e veçanta, në kuadër të zgjerimit të politikës së tregut të punës; Arritja e standardeve të BE-së, ku përfshihet EURES, Garancia Rinore, Observatori i tregut të punës (plani i veprimit për kapitujt 2 dhe 19); Digjitalizimi i proceseve: pasaporta digjitale, shkëmbimi elektronik i të dhënave; Përmirësimi i mekanizmave të monitorimit, inspektimit dhe transparencës; | Kapitulli 2 dhe 19 | Shtylla "Shqipëria Europiane"; 1.1. Anëtarësimi në Bashkimin Europian | Jo | Strategjia Kombetare e Punesimit dhe Aftesive 2023 - 2030 | Po, sociale dhe ekonomike |
| 19 | Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 349, datë 29.04.2020 "Për miratimin e rregullit teknik "Për pajisjet elektrike të projektuara për përdorim brenda kufijve të caktuar të tensionit (LVD)"" | Projektvendim | Ministri i Ekonomisë dhe Inovacionit | Katërmujori III | Detyrimi për të përafruar legjislacionin shqiptar me Kapitullin 1 të legjislacionit evropian që buron nga Neni 70 dhe 75 i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA), ku përcaktohet se Shqipëria duhet të harmonizojë teknikisht legjislacionin e saj kombëtar me atë të Bashkimit Evropian (BE), por gjithashtu të sigurojë që ai të zbatohet dhe të vihet në praktikë. | Projektvendimi përcakton kushtet për vendosjen në treg të pajisjeve elektrike të projektuara për përdorim brenda kufijve të caktuar të tensionit, duke garantuar sigurinë për konsumatorët dhe përdoruesit e tjerë, si dhe eliminimin e pengesave tregtare për lëvizjen e lirë të produkteve. Percakton gjithashtu kërkësat për tregtimin e këtyre pajisjeve, detyrimet e operatorëve ekonomikë, si dhe masat që duhen ndërmarrë lidhur me pajisjet që paraqesin rrezik për sigurinë apo shëndetin, etj. | Kapitulli 1 | Shtylla "Shqipëria Europiane"; 1.1. Anëtarësimi në Bashkimin Europian | Jo | Strategjia Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe Mbikëqyrjen e Tregut 2024–2030 (miratuar me VKM nr. 326, datë 29.05.2024). | Jo |
| 20 | Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 192, datë 4.4.2018 "Për miratimin e rregullit teknik "Për ashensorët dhe komponentët e sigurisë për ashensorë dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara" | Projektvendim | Ministri i Ekonomisë dhe Inovacionit | Katërmujori III | Detyrimi për të përafruar legjislacionin shqiptar me Kapitullin 1 të legjislacionit evropian që buron nga Neni 70 dhe 75 i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA), ku përcaktohet se Shqipëria duhet të harmonizojë teknikisht legjislacionin e saj kombëtar me atë të Bashkimit Evropian (BE), por gjithashtu të sigurojë që ai të zbatohet dhe të vihet në praktikë. | Projektvendimi përcakton kushtet për vendosjen në treg të ashensorëve, duke garantuar sigurinë për konsumatorët dhe përdoruesit e tjerë, si dhe eliminimin e pengesave tregtare për lëvizjen e lirë të produkteve. Përcakton gjithashtu kërkësat për tregtimin e këtyre pajisjeve, detyrimet e operatorëve ekonomikë, si dhe masat që duhen ndërmarrë lidhur me pajisjet që paraqesin rrezik për sigurinë apo shëndetin, etj. | Kapitulli 1 | Shtylla "Shqipëria Europiane"; 1.1. Anëtarësimi në Bashkimin Europian | Jo | Strategjia Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe Mbikëqyrjen e Tregut 2024–2030 (miratuar me VKM nr. 326, datë 29.05.2024). | Jo |
| 21 | "Për miratimin e rregullit teknik për pajisjet e aerosolit" | Projektvendim | Ministri i Ekonomisë dhe Inovacionit | Katërmujori III | Detyrimi për të përafruar legjislacionin shqiptar me Kapitullin 1 të legjislacionit evropian që buron nga Neni 70 dhe 75 i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA), ku përcaktohet se Shqipëria duhet të harmonizojë teknikisht legjislacionin e saj kombëtar me atë të Bashkimit Evropian (BE), por gjithashtu të sigurojë që ai të zbatohet dhe të vihet në praktikë. | Projektvendimi përcakton kushtet për vendosjen në treg të pajisjeve të aerosolit, duke garantuar sigurinë për konsumatorët dhe përdoruesit e tjerë, si dhe eliminimin e pengesave tregtare për lëvizjen e lirë të produkteve. Përcakton gjithashtu kërkësat për tregtimin e këtyre pajisjeve, detyrimet e operatorëve ekonomikë, si dhe masat që duhen ndërmarrë lidhur me pajisjet që paraqesin rrezik për sigurinë apo shëndetin, etj. | Kapitulli 1 | Shtylla "Shqipëria Europiane"; 1.1. Anëtarësimi në Bashkimin Europian | Jo | Strategjia Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe Mbikëqyrjen e Tregut 2024–2030 (miratuar me VKM nr. 326, datë 29.05.2024). | Jo |
| 22 | "Për shpërblimin e pensionistëve për festat e fundvitit" | Projektvendim | Ministri i Ekonomisë dhe Inovacionit | Katërmujori III | Neni 5, i ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, | Percaktimi i masës së shpërblimit për kategorinë e pensionistëve në kuadër të festave të fundvitit | Jo | Shtylla "Familja"; Fusha "Kujdesi për të moshuarit dhe qytetarët më në nevojë" | Jo | Jo | Po, financiare dhe ekonomike |
| 23 | "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 563, datë 03.07.2013, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores "Për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për përdorimin e pajisjeve mbrojtëse individuale në vendin e punës" | Projektvendim | Ministri i Ekonomisë dhe Inovacionit | Katërmujori III | Përafrmi në kuadër të Integrimit Evropian. Akti përafron direktivën e Këshillit 89/656/KEE e 30 nëntorit 1989, mbi kërkesat minimale të shëndetit dhe sigurisë për përdorimin nga punëtorët të pajisjeve mbrojtëse personale në vendin e punës (direktiva e tretë individuale sipas kuptimit të nenit 16 (1) të Direktivës 89/391/KEE), e ndryshuar nga Direktiva e Komisionit 2019/1832 e 24 tetorit 2019 (që ndryshon Shtojcat I, II dhe III të Direktivës së Këshillit 89/656/KEE në lidhje me rregullimet thjesht teknike). | Mbi kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për përdorimin e pajisjeve mbrojtëse individuale në vendin e punës | Kapitulli 19 | Programi Shqipëria 2030 - Harmonizimi i plotë i legjislacionit me acquis communautaire | Jo | VKM Nr 144, datë 06.03.2025 "Për miratimin e Dokumentit të Politikave për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë dhe Planit të Veprimit 2025 -2030" | Po, sociale |

## PROGRAMI I PËRGJITHSHËM ANALITIK I PROJEKTAKTEVE PËR VITIN 2026

## MINISTRIA E DREJTËSISË

| Nr. | Titulli i projektaktit | Lloji i projektaktit | Ministri propozues | Katërmujori | Arsyet kryesore për propozimin e projektaktit | Çështjet kryesore që parashikon të rregullojë projektakti | A është parashikuar projektakti në PKIE?<br><br>Nëse po, të specifikohet kapitulli përkatës | Përputhshmëria e projektaktit me programin politik qeverisë 2025-2029<br><br>Nëse përputhet, të jepet referenca e saktë në progam | A është akt i një rëndësie të veçantë e prioritare? | Lidhja e projektaktit me strategjitë kombëtare dhe sektoriale<br><br>Nëse lidhet, të specifikohen strategjitë | Ndikimet e mundshme ekonomike, financiare, sociale dhe mjedisore<br><br>Përgjigjuni me Po/Jo për ndikimet përkatëse |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | "Për miratimin e rekomandimeve prioritare për Prokurorin e Përgjithshëm, në luftën kundër kriminalitetit, për vitin 2026." | Projektvendim | Ministri i Drejtësisë | Katërmujori I | Rekomandimet kanë për qëllim dhe synojnë garantimin e funksionimit efektiv të organit të prokurorisë, parandalimit dhe luftës kundër korrupsionit, krimit të organizuar, dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të të drejtave të njeriut. Projektvendimi propozohet bazuar në nenin 103, të ligjit nr.97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe pikën 32, të nenit 6, të ligjit nr.8678, datë 14.05.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", të ndryshuar. | Përcaktimin e prioriteteve në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, në përmbushje të detyrimeve të brendshme ligjore, si dhe rekomandimeve të organizatave ndërkombëtare. Këto rekomandime prioritare i përcillen organit të prokurorisë në ushtrim të përgjegjësisë shtetërore të Këshillit të Ministrave dhe Ministrisë së Drejtësisë, për ndjekjen dhe realizimin e politikës së përgjithshme shtetërore në fushën e drejtësisë dhe në respektim të parimit themelor të kontrollit dhe ekuilibrimit reciprok të pushteteve. | Jo | Jo | Jo | Jo | Po, ka ndikime sociale |
| 2 | "Për organizimin dhe funksionimin e Institutit të Mjekësisë Ligjore dhe shërbimeve mjekoligjore në Republikën e Shqipërisë" | Projektligj | Ministri i Drejtësisë | Katërmujori III | Arsyeja e propozimit të këtij projektakti është reformimi i shërbimit të Mjekësisë Ligjore në Republikën e Shqipërisë | Licencimin e ekspertëve mjekoligjorë dhe trajnimin e tyre vazhdues. Procesin e kryerjes së ekspertimeve mjeko-ligjore. Shpërblimin për kryerjen e ekspertimeve mjeko-ligjore | Jo | Jo | Jo | Jo | Jo |
| 3 | "Për disa ndryshime në ligjin nr.111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti" | Projektligj | Ministri i Drejtësisë | Katërmujori III | Arsyeja e propozimit të këtij projektakti lidhet me përmirësimin e kuadrit ligjor aktual, si dhe harmonizimin e ligjit aktual me legjislacionin e Bashkimit Evropian. | Projektakti synon garantimin e aksesit efektiv dhe të barabartë në drejtësi për të gjithë përfituesit e ndihmës juridike falas, në çdo fazë të procesit gjyqësor, si dhe përafrimin e legjislacionit kombëtar me atë të Bashkimit Evropian | Po, kapitulli 23. | Jo | Po | 1. Strategjia ndërsektoriale e drejtësisë 2024–2030<br>2. Strategjia ndërsektoriale për mbrojtjen e viktimave të krimit 2024–2030 | Po, ka ndikime sociale |
| 4 | "Për disa ndryshime në ligjin nr.80/2020 "Për policinë e burgjeve" | Projektligj | Ministri i Drejtësisë | Katërmujori III | Ndryshimet e theksuara në kompensimin që i jepet personelit të Policisë së Burgjeve dhe personelit të Forcave të tjera të armatosura. | Përmirësimi i trajtimit financiar të punonjësve të Policisë së Burgjeve për shkak të privacioneve që i vijnë si pasojë e pozicionit të punës duke i njësuar me trajtimin e personelit në forca të tjera të armatosura. | Jo | Jo | Jo | Jo | Jo |
| 5 | "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10193, date 3.12.2009 "Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale" | Projektligj | Ministri i Drejtësisë | Katërmujori III | Arsyeja e propozimit është përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale me aktet e Bashkimit Evropian. | Projektakti synon përafrimin e dispozitave që lidhen me të drejtat procedurale në procedurat e urdhrit të arrestit evropian. | Po, kapitulli 23. | Jo | Po | Strategjia ndërsektoriale e drejtësisë 2024-2030 | Jo |
| 6 | "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995 "Kodi Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë" | Projektligj | Ministri i Drejtësisë | Katërmujori III | Arsyeja e propozimit të këtij projektakti lidhet me garantimin e të drejtave procedurale gjatë gjykimit penal, si dhe me harmonizimin e legjislacionit kombëtar me acquis e Bashkimit Evropian. | Projektakti synon garantimin e të drejtave procedurale gjatë procedimit penal që nga marrja në pyetje dhe deri te gjykimi | Po, kapitulli 23. | Jo | Po | Strategjia ndërsektoriale e drejtësisë 2024-2030 | Po, ka ndikime sociale |
| 7 | "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar. | Projektligj | Ministri i Drejtësisë | Katërmujori III | Arsyeja e propozimit të këtij projektakti lidhet garantimin e të drejtave procedurale gjatë gjykimit administrativ, si dhe me harmonizimin e legjislacionit kombëtar me acquis e Bashkimit Evropian. | Projektakti synon garantimin e të drejtave procedurale gjatë gjykimit administrativ. | Po, kapitulli 23. | Jo | Po | 1. Strategjia ndërsektoriale e drejtësisë 2024–2030, 2. Agjenda Kombëtare e Reformave 2024–2027", në kuadër të instrumentit të Bashkimit Evropian "faciliteti për reforma dhe rritje për ballkanin perëndimor". | Po, ka ndikime sociale |
| 8 | "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë" | Projektligj | Ministri i Drejtësisë | Katërmujori III | Arsyeja e propozimit është përafrimi me aquis cummunitaire të legjislacionit penal të Republikës së Shqipërisë | Projektakti synon përafrimin e legjislacionit penal të detyrueshëm për vendet anëtare të bashkimit Evropian. | Po, kapitulli 23. | Po, Shtylla 1 "Shqipëria Evropiane, në kapitullin 1.1 Anëtarësimi në Bashkimin Evropian". | Po | 1. Strategjia ndërsektoriale e drejtësisë 2024–2030, | Po, ka ndikim social |
| 9 | Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë për të Mitur 2026-2030, planit të veprimit dhe të pasaportës së indikatorëve | Projektvendim | Ministri i Drejtësisë | Katërmujori III | Hartimi i një strategjie të re sektoriale të drejtësisë për të mitur e cila është në përputhje me udhërrëfyesin për shtetin e së drejtës dhe vizionin e Republikës së Shqipërisë për integrimin evropian në fushën e drejtësisë për të miturit. Strategjitë janë politika që bazohen në nenin 100 të Kushtetutës. | Projektvendimi synon adresimin e politikave të sistemit të drejtësisë për të miturit të bazuara sipas masave strategjike të parashikuara në dokumentet strategjike për integrimin europuan në lidhje me Kapitullin 23 "Gjyqësori dhe të drejtat themelore". | Jo | Jo | Po | Po/Udhërrëfyesi për Shtetin e së Drejtës – Kapitullin 23 "Gjyqësori dhe të drejtat themelore | Po, ka ndikim social |

## PROGRAMI I PËRGJITHSHËM ANALITIK I PROJEKTAKTEVE PËR VITIN 2026

## MINISTRIA E MBROJTJES

| Nr. | Titulli i projektaktit | Lloji i projektaktit | Ministri propozues | Katërmujori | Arsyet kryesore për propozimin e projektaktit | Çështjet kryesore që parashikon të rregullojë projektakti | A është parashikuar projektakti në PKIE? Nëse po, të specifikohet kapitulli përkatës | Përputhshmëria e projektaktit me programin politik qeverisës 2025-2029<br>Nëse përputhet, të jepet referenca e saktë në progam | A është akt i një rëndësie të veçantë e prioritare? | Lidhja e projektaktit me strategjitë kombëtare dhe sektoriale<br>Nëse lidhet, të specifikohen strategjitë | Ndikimet e mundshme ekonomike, financiare, sociale dhe mjedisore<br>Përgjigjuni me Po/Jo për ndikimet përkatëse |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9210, datë 23.3.2004, "Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar | Projektligj | Ministri i Mbrojtjes | Katërmujori I | •Projektakt i planifikuar në PPAP 2025, i cili vlerësohet që nuk miratohet brenda vitit 2025.<br>• Nenet 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës të Republik së Shqipërisë.<br>•Rishikimi në tërësi i tij duke bërë harmoznizimin me ligjet e tjera të cilat kanë pësuar ndryshime. | • Prodhimin e kartës së ushtarakut aktiv, në rezervë, në pension dhe studentit ushtarak.<br>• Përfitimin e trajtimit financiar për vjetërsi shërbimi.<br>• Përfitimin e trajtimit financiar në rastet e largimit nga FA-ja, sipas kritereve ligjore.<br>• Efektet për personelin që humbin jetën.<br>• Stërvitje, trajnime e kurse afatshkurtra. | Jo | Shqipëria 2030 Shtylla I "Shqipëria Evropiane", pika 1.6. | Jo | Strategjia Ushtarake | •Po, Ndikim Financiar, Social<br>•Ndryshimet e propozuara shoqërohen me efekt financiar, vlera e të cilit është 166.787.900 lekë në vit. Efekti financiar është i përfshirë në PBA për vitin 2026-2028, në Programin Buxhetor "Forcat e Luftimit".<br>•Përmirësim i përfitimeve të ushtarakëve |
| 2 | "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.173/2014 "Për disiplinën në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar | Projektligj | Ministri i Mbrojtjes | Katërmujori I | •Projektakt i planifikuar në PPAP 2025, i cili vlerësohet që nuk miratohet brenda vitit 2025.<br>• Nenet 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës të Republik së Shqipërisë.<br>•Ky projektligj vjen si nevojë e zgjidhjes së problematikave të reja, të patrajtuara nga ligji aktual, i cili kërkon ndërhyrje për shkak të implementimit të strukturës së re. Dinamika të reja, të cilat kanë penguar realizimin e përforcimit të disiplinës në Forcat e Armatosura, sipas ligjit nr.173/2014, adresohen nga ky projektligj që njëkohësisht shton klasifikimin e masave disiplinore kur shkelja kryhet ne misione jashtë vendit | •Arsyet e rishikimit të këtij ligji lidhen më së shumti me rregullime teknike dhe harmonizim me teknologji me ligjet e tjera që normojnë aktivitetin e FARSH | Jo | Jo | Jo | Jo | Jo |
| 3 | "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.742, datë 16.10.2012"Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit" | Projektvendim | Ministri i Mbrojtjes | Katërmujori I | •Projektakt i planifikuar në PPAP 2025, i cili vlerësohet që nuk miratohet brenda vitit 2025.<br>•Në zbatim të pikës 2 të nenit 5 e të pikës 2 të nenit 7 të ligjit nr. 10 435, datë 23.6.2011 "Për shërbimin e kërkim-shpëtimit në Republikën e Shqipërisë ", të ndryshuar | •Me ndryshimet e ligjit lind nevoja dhe per organizimin dhe funksionimin e QKKSH. | Jo | Jo | Jo | Jo | Jo |
| 4 | "Për detyrimin e subjekteve të licencuara, për sigurimin e një rezerve të caktuar armatimesh dhe pajisjesh teknologjike, për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë" | Projektvendim | Ministri i Mbrojtjes | Katërmujori I | •Projektakt i planifikuar në PPAP 2025, i cili vlerësohet që nuk miratohet brenda vitit 2025.<br>•Në zbatim të pikës 2, të nenit 9, të ligjit 87/2024 "Për rregullimin e prodhimit, tregtimit, kërkimit dhe zhvillimit të armëve, municioneve, pajisjeve dhe teknologjive ushtarake" | •Në rastin e gjendjes së luftës ose në kushtet e një rreziku të afërt dhe konkret të një agresioni ushtarak ndaj Republikës së Shqipërisë ose aleatëve të saj strategjikë, subjektet e licencuara kanë detyrimin që të sigurojnë një rezervë të caktuar armatimesh dhe pajisjesh teknologjike për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë. | Jo | Jo | Jo | Strategjia e Sigurisë Kombëtare | Jo |
| 5 | "Për miratimin e listës së mallrave të përjashtuara nga taksat doganore, të cilat shërbejnë drejtpërdrejt për prodhimin e armatimit ushtarak" | Projektvendim | Ministri i Mbrojtjes | Katërmujori I | •Projektakt i planifikuar në PPAP 2025, i cili vlerësohet që nuk miratohet brenda vitit 2025.<br>•Në zbatim të shkronjës "c", të pikës 1, të nenit 26, të ligjit 87/2024 "Për rregullimin e prodhimit, tregtimit, kërkimit dhe zhvillimit të armëve, municioneve, pajisjeve dhe teknologjive ushtarake" | •Përcaktimi dhe miratimi i listës së mallrave të përjashtuara<br>•Lehtesimi fiskal për indrustrinë e mbrojtjes<br>•Mbeshtetja për zhvillimin e industrisë së mbrojtjes. | Jo | Jo | Jo | Jo | Jo |
| 6 | "Për përcaktimin e kritereve, rregullave, etiketën apo pullën unike të markimit, procedurën dhe mënyrën e markimit dhe të gjurmimit, si dhe autoritetin për realizimin e markimit dhe gjurmueshmërisë" | Projektvendim | Ministri i Mbrojtjes | Katërmujori I | •Projektakt i planifikuar në PPAP 2025, i cili vlerësohet që nuk miratohet brenda vitit 2025.<br>•Në zbatim të pikës 3, të nenit 16, të ligjit 87/2024 "Për rregullimin e prodhimit, tregtimit, kërkimit dhe zhvillimit të armëve, municioneve, pajisjeve dhe teknologjive ushtarake" | •Ky projektakt synon të rregulloje markimin nëpërmjet shënjës unike në fomë kodi, pulle apo etikete, ose çdo forme tjetër unike identifikimi e individualizimi në armatimin ushtarak, me qëllim identifikimin dhe gjurmimin e tyre. | Jo | Jo | Jo | Jo | Jo |
| 7 | "Për përcaktimin e tarifave për lëshimin e dokumenteve ligjore që lidhen me transferimin ndërkombëtar të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë, të cilat lëshohen nga Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve " | Projektvendim | Ministri i Mbrojtjes | Katërmujori I | •Pika 1, e nenit 46, të ligjit nr. 46/2018,"Për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të artikujve eteknologjive me përdorim të dyfishtë"<br>•Harmonizimi me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 248, datë 30.04.2025, "Për përcaktimin e llojeve të licencave/certifikatave dhe autorizimeve, të dokumentacionit të aplikimit, formateve të kërkesave të aplikimeve, si dhe të formateve të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për transferimet ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë, që lëshohen nga Autoriteti i | •Llojet e shërbimeve të ofruara nga AKSHE, në përputhje me VKM nr. 248, datë 30.04.2025.<br>•Vlera e tarifave të aplikimit për secilin shërbim. | Jo | Shqipëria 2030 Shtylla I "Shqipëria Evropiane", pika 1.6. | Jo | Strategjia për Mospërhapjen e Armëve të dëmtimit në Masë MADM 2025 | •Po, Ndikim Ekonomik<br>•Rritje e të ardhurave nga pagesa e tarifave për aplikim. |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | Kontrollit Shtetëror të Eksporteve” | | | | | | |
| **8** | "Për disa ndryshime në vendimin nr. 181, datë 29.03.2023 të Këshillit të Ministrave “Për pjesëmarrjen e personelit të Forcave të Armatosura të Rapublikës së Shqipërisë në shtabin e kualicionit FOB UNION III, në operacionin ushtarak të NATO-s në Irak (NMI). | Projektvendim | Ministri i Mbrojtjes | Katërmujori I | •Pika 1, e nenit 7, të ligjit nr. 9363, datë24.3.2005, “Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, sidhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorine Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe shkronja “ç”, e nenit 11, të ligjit nr. 64/2014,“Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura tëRepublikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.<br>•Mbaron afati i zbatimit në datën 13.04.2026. | • Plotësimi me kuader ligjor për pjesëmarrjen e personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në shtabin e kualicionit FOB UNION III, në operacionin ushtarak të NATO-s në Irak (NMI). | Jo | Jo | Jo | Strategjia Ushtarake | Jo |
| **9** | Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 628, datë 25.9.2019 "Për miratimin e dokumentit të Rishikimit të Strategjisë së Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë" | Projektvendim | Ministri i Mbrojtjes | Katërmujori I | • Shkronja “a”, e pikës 2, të nenit 13, të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosuratë Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar<br>•Rishikimi i këtij dokumenti bëhet për një periudhë 5 vjeçare duke u bazuar në Strategjinë e Sigurisë Kombëtare.<br>• Interesat strategjike kombëtare dhe politikat e mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë, rëndësinë e koordinimit dhe bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të sigurisë. | •RSM përshkruan interesat strategjike kombëtare dhe politikat e mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë, cilësinë e kapaciteteve dhe mjedisin e ri të sigurisë. | Jo | Jo | Jo | Strategjia e Sigurisë Kombëtare/ Strategjia Ushtarake | Jo |
| **10** | “Për njësimin e gradave ushtarake me funksionet organike në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”. | Projektvendim | Ministri i Mbrojtjes | Katërmujori I | •Neni 23, i ligjit nr. 59/2014, “Për karrierën ushtarake në Forcate Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.<br>•Ndryshimet në strukturën organizative gjatë 10 viteve të fundit<br>•Shtimi i strukturave të reja dhe ndryshimi i nivelit dhe funksioneve organike. | •Njësimin e funksioneve organike në strukturat e Forcave të Armatosura me gradat përkatëse. | Jo | Jo | Jo | Jo | Jo |
| **11** | "Për krijimin e medaljeve, shenjave dhe distinktivëve të veçantë të nderit, kriteret, procedurat dhe autoritetet përgjegjëse për dhënien e tyre në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë" | Projektvendim | Ministri i Mbrojtjes | Katërmujori II | •Projektakt i planifikuar në PPAP 2025, i cili vlerësohet që nuk miratohet brenda vitit 2025.<br>•Projektvendimi i propozuar ka për qëllim krijimin e medaljeve, shenjave dhe distinktivëve të veçantë të nderit, që i jepen personelit ushtarak dhe civil që shërben në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, si dhe për ushtarakët e huaj që shquhen për merita dhe kontribute të veçanta për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë si dhe kriteret, procedurat dhe autoritetet përgjegjëse për dhënien e tyre.në zbatim të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 93/2022, “Për dekoratat në Republikën e Shqipërisë”. | •Projektvendimi i paraqitur ka si objekt të tij krijimin e medaljeve, shenjave dhe distinktivëve të veçantë të nderit, që i jepen personelit ushtarak dhe civil që shërben në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, si dhe për ushtarakët e huaj që shquhen për merita dhe kontribute të veçanta për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë si dhe kriteret, procedurat dhe autoritetet përgjegjëse për dhënien e tyre.<br><br>•Ky vendim do të zbatohet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë territorit të saj, ku personeli i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dërgohet me detyrë, mision, operacion ushtarak apo në ndihmë të popullsisë civile, shërbim, stërvitje të përbashkët ose mision diplomatik | Jo | Jo | Jo | Jo | Jo |
| **12** | "Për përcaktimin e masës së kompensimit të dëmeve, procedurat, afatet, strukturat shtetërore përgjegjëse për vlerësimin e dëmeve, si dhe pasuritë dhe subjektet që kompensohen si pasojë e një fatkeqësie." | Projektvendim | Ministri i Mbrojtjes | Katërmujori II | •Projektakt i planifikuar në PPAP 2025, i cili vlerësohet që nuk miratohet brenda vitit 2025.<br>•Në zbatim të pikës 6, e nenit 41 të ligjit nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile" | •Ky projektvendim ka për qëllim përcaktimin e masës së kompensimit të dëmeve, procedurat, afatet, strukturat shtetërore përgjegjëse për vlerësimin e dëmeve, si dhe pasuritë dhe subjektet që kompensohen si pasojë e një fatkeqësie | Jo | Jo | Jo | Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut për Fatkeqësitë dhe PKEC 2023 | •Po, Ndikim Financiar, Social<br>•Efektet financiare të këtij projektvendimi parashikohet të mbulohen nga vetë bashkitë, nëpërmjet fondit të dedikuar për mbrojtjen civile nga buxheti i shtetit.<br>•Kompensim financiar të dëmtuarit në rastet e fatkeqësive natyrore ose fatkeqësi tjetër. |
| **13** | "Për ngritjen dhe funksionimin e sistemit të numrit të unifikuar të thirrjeve emergjente 112.” | Projektvendim | Ministri i Mbrojtjes | Katërmujori II | •Projektakt i planifikuar në PPAP 2025, i cili vlerësohet që nuk miratohet brenda vitit 2025.<br>•Ligji nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile” në nenin 47 parashikon se numri i unifikuar i thirrjeve emergjente 112 siguron komunikim, paralajmërim të hershëm, njoftim, alarm, informim, koordinim, vendimmarrje, aktivizim dhe ndërhyrje të integruar të strukturave operacionale në përballimin e aksidenteve dhe të situatave emergjente që mund të ndodhin në të gjithë vendin. | •Unifikimin e numrit 112 për cështjet e emergjencës. | Jo | Jo | Jo | Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut për Fatkeqësitë | •Po, Ndikim Financiar<br>•Ngritur grupi ndërinstitucional dhe teknik u punës për përllogaritjen e efekteve financiare me urdhrin e Kryeministrit nr. 146, datë 12.9.2025 . |
| **14** | "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 729, datë 13.11.2019 "Për rishikimin e Planit Kombëtar të Kërkim Shpëtimit në Republikën e Shqipërisë dhe Planit të Veprimit të tij" | Projektvendim | Ministri i Mbrojtjes | Katërmujori II | •Projektakt i planifikuar në PPAP 2025, i cili vlerësohet që nuk miratohet brenda vitit 2025.<br>•Në zbatim të pikës 1, të nenit 8, të ligjit nr. 10435, datë 23.6.2011, “Për shërbimin e kërkim-shpëtimit në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. | •Ndryshimi i strukturave në FA dhe të strukturave shtetërore, bën të nevojshme rishikimin në procedura dhe kapacitete | Jo | Jo | Jo | Strategjia Ndërsektoriale për Menaxhimin e Integruar të Kufirit | Jo |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **15** | "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 45/2019, "Per mbrojtjen civile" | Projektligj | Ministri i Mbrojtjes | Katërmujori II | •Projektakt i planifikuar në PPAP 2025, i cili vlerësohet që nuk miratohet brenda vitit 2025.<br>• Nenet 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës të Republik së Shqipërisë<br>•Përforcimi i sistemit kombëtar të mbrojtjes civile dhe të kapaciteteve të mbrojtjes civile në Republikën e Shqipërisë<br>•Zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë dhe realizimin e mbrojtjes civile për të garantuar mbrojtjen e jetës së njerëzve, të gjësë së gjallë, të pronës, të trashëgimisë kulturore e të mjedisit. | • Detyrat e organeve kolegjiale të sistemit kombëtar të mbrojtjes civile dhe koordinimin e strukturave të parashikuara në ligj;<br>• Problematikat me zbatimin në praktikë të parimit të subsidiaritetit në të gjitha fazat e menaxhimit të fatkeqësive dhe të përballimit të emergjencave civile;<br>• Përfshirjen e strukturave operacionale në përballimin e emergjencave, brenda dhe jashtë vendit, si edhe procedurat e angazhimit të tyre në rastet e misioneve në kuadër të Mekanizmit të Mbrojtjes Civile të Bashkimit Evropian (UCPM);<br>• Nevojat për të rregulluar statusin e shërbimit të vullnetarëve të mbrojtjes civile dhe domosdoshmëria e saktësimit të detyrimit të trajnimit dhe formimit profesional në fushën e mbrojtjes civile për të gjithë subjektet e ligjit 45/2019;<br>• Përfshirjen e shtetit në ndihmën për subjektet e dëmtuara nga fatkeqësitë;<br>• Rolin dhe funksionet e AKMC-së në sistemin kombëtar të mbrojtjes civile. | Jo | Jo | Jo | Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut për Fatkeqësitë | Jo |
| **16** | "Për përcaktimin e kritereve dhe mënyrës së vlerësimit të parakohshëm të ushtarakëve aktive të Forcave e Armatosura të Republikës së Shqipërisë" | Projektvendim | Ministri i Mbrojtjes | Katërmujori II | •Projektakt i planifikuar në PPAP 2025, i cili vlerësohet që nuk miratohet brenda vitit 2025.<br>•Në zbatim të nenit 18/1, të ligjit nr. 59/2014, "Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar | •Përcakton kriteret dhe mënyrën e vlerësimit të parakohshëm të ushtarakëve aktive të Forcave e Armatosura të Republikës së Shqipërisë. | Jo | Jo | Jo | Jo | Jo |
| **17** | "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 472, datë 26.7.2023 "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Inovacionit të Sigurisë dhe Mbrojtjes" | Projektvendim | Ministri i Mbrojtjes | Katërmujori II | •Projektakt i planifikuar në PPAP 2025, i cili vlerësohet që nuk miratohet brenda vitit 2025.<br>•Tek parashikimet e kreut 2 të VKM Nr. 472, datë 26.07.2023 mungon harmonizimi me paketën e re ligjore të industrisë ushtarake dhe konkretisht me nenin 22 të Ligjit 87/2024 "Për rregullimin e prodhimit, tregtimit, kërkimit dhe zhvillimit të armëve, municioneve, pajisjeve dhe teknologjive ushtarake" dhe konkretisht bashkëpunimi i Qendrës me subjekte të licensuara sipas ligjit nr. 87/2024 me objekt projekte të përbashkëta kërkimore, zhvillimin e teknologjive të reja dhe shkëmbimin e njohurive dhe ekspertizës. | •Ky shtim i përgjegjësisë funksionale të Qendrës do të mundësonte harmonizimin e plotë të VKM Nr. 472/2023 me Ligjin Nr 87/2024 duke qënë në përputhje me njëra tjetrën dhe në përfshirjen e plotë të përgjegjësive të Qendrës edhe të detyrimit ligjor që rrjedh nga Ligji 87/2024 | Jo | Jo | Jo | Jo | •Po, Ndikim Financiar<br>•Efekte buxhetore shtesë në formën e shpenzimeve për programin e akselerimit e cila do ofrojë mbështetje financiare për startup-et në formën e një pagese të kufizuar për anëtarët e grupeve pjesëmarrëse.<br>•Shpenzime për shpërblimin monetar për individin apo ekipin fitues në aktivitetet garuese për sfida të ndryshme të inovacionit në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes<br>•Efekt buxhetor shtesë në rast të angazhimit të ekspertëve të jashtëm, vendas ose të huaj me njohuri të specializuara në fusha që lidhen me sigurinë dhe mbrojtjen në raste komplekse ose në mungesë të ekspertizës së brendshme |
| **18** | "Për disa shtesa dhe ndyshime në ligjin nr. 87/2024 "Për rregullimin e prodhimit, tregtimit, kërkimit dhe zhvillimit të armëve, municioneve, pajisjeve dhe teknologjive ushtarake" | Projektligj | Ministri i Mbrojtjes | Katërmujori II | • Nenet 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës të Republik së Shqipërisë<br>• Kuadri aktual paraqet një sërë kufizimesh që pengojnë funksionimin efikas të sistemit të kontrollit shtetëror dhe zhvillimin e industrisë ushtarake kombëtare.<br>• Nevoja për një listë të plotë e të harmonizuar të armatimit ushtarak në përputhje me kërkesat bashkëkohore të industrisë dhe standardet ndërkombëtare.<br>•Nevoja për fleksibilitet në sistemin e licencimit dhe shmangien e vonesave dhe pasigurive në procedura.<br>•Konfigurimi aktual i Këshillit të Mbrojtjes dhe Sigurisë nuk garanton nivelin e duhur të koordinimit ndërinstitucional, duke ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në efikasitetin e vendimmarrjes strategjike.<br>• Dispozita ligjore të paqarta ose të pazbatueshme në praktikë, krijojnë boshllëqe normative<br>•Nevoja për modernizimin dhe harmonizimin e kuadrit ligjor, në përputhje me zhvillimet teknologjike, kërkesat e sigurisë kombëtare dhe praktikat më të mira të Bashkimit Evropian. | • Krijimi i një liste kombëtare të armatimit ushtarak që do të miratohet në kuadër të Industrisë ushtarake duke përfshirë një gamë më të gjerë mallrash dhe produktesh sipas specifikave të industrisë ushtarake.<br>• Rregullimi i sistemit të licencimit duke përfshirë edhe autorizimet si pjesë e sistemit.<br>•Ndërhyrje në konfigurimin e Këshillit të mbrojtjes dhe sigurisë, me qëllim forcimin e koordinimit ndërinstitucional dhe rritjen e efikasitetit në proceset e vendimmarrjes strategjike.<br>•Ndryshimin e dispozitave ligjore të cilat kanë paqartësi dhe nuk janë të zbatueshme në praktikë. | Jo | Shqipëria 2030 Shtylla I "Shqipëria Evropiane", pika 1.6, shkronja "c", fq.19 | Jo | Strategjia për Mospërhapjen e Armëve të Dëmtimit në Masë MADM 2025 | Jo |
| **19** | "Për një ndryshim në ligjin nr. 73/2021, "Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e artikujve piroteknikë" | Projektligj | Ministri i Mbrojtjes | Katërmujori II | •Nenet 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës të Republik së Shqipërisë<br>•Nuk janë parashikuar tarifat për aplikim të subjekteve që pajisen me licenca dhe autorizime | •Synon të regullojë cështjen e parashikimit te tarifave të aplikimit<br>•Nevoja për mbulimin e shpenzimeve administrative dhe të inspektimit | Jo | Shqipëria 2030 Shtylla I "Shqipëria Evropiane", pika 1.6. | Jo | Strategjia për Mospërhapjen e Armëve të Dëmtimit në Masë MADM 2025 | •Po, Ndikim Ekonomik<br>•Vendosja e tarifave krijon një mekanizëm të qartë dhe të ligjshëm për mbledhjen e të ardhurave, si dhe redukton nevojën për mbështetje shtesë nga |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | | | buxheti i shtetit dhe përmirëson planifikimin buxhetor |
| **20** | "Për një ndryshim në ligjin nr. 74/2021, "Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e lëndëve plasëse për përdorim civil" | Projektligj | Ministri i Mbrojtjes | Katërmujori II | •Nenet 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës të Republik së Shqipërisë<br>•Nuk janë parashikuar tarifat për aplikim të subjekteve që pajisen me licensa dhe autorizime | •Synon të rregullojë cështjen e parashikimit te tarifave të aplikimit<br>•Nevoja për mbulimin e shpenzimeve administrative dhe të inspektimit | Jo | Shqipëria 2030 Shtylla I "Shqipëria Evropiane", pika 1.6. | Jo | Strategjia për Mospërhapjen e Armëve të Dëmtimit në Masë MADM 2025 | •Po, Ndikim Ekonomik<br>•Vendosja e tarifave krijon një mekanizëm të qartë dhe të ligjshëm për mbledhjen e të ardhurave, si dhe redukton nevojën për mbështetje shtesë nga buxheti i shtetit dhe përmirëson planifikimin buxhetor |
| **21** | "Për disa shtesa dhe ndryshime në "Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 793, datë 19.12.2024 Për "Licencat dhe autorizimet e lëshuara nga Agjencia e Industrisë së Mbrojtjes" | Projektvendim | Ministri i Mbrojtjes | Katërmujori II | •Pika 5, e nenit 12 dhe pika 3, e nenit 14, të ligjit nr. 87/2024, "Për rregullimin e prodhimit, tregtimit, kërkimit dhe zhvillimit të armëve,municioneve, pajisjeve dhe teknologjive ushtarake"<br>•Zbatimi i Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 793/2024 ka krijuar procedura të mbingarkuara për licencim/autorizim.<br>•Dokumentacion i tepërt i përsëritur, shpesh pa ndikim real në procesin e vlerësimit të sigurisë ose kapaciteteve teknike të aplikuesve.<br>•Vonesa në dhënien e licencave dhe rritje të kostove administrative, si për subjektet private, ashtu edhe për vetë AIM.<br>•Nevojitet ndërhyrje për reduktimin e dokumentacionit të kërkuar dhe lehtësimin e procedurave, duke ruajtur në çdo rast standardet e sigurisë dhe kontrollit shtetëror. | 1. Thjeshtimi i procedurave burokratike në procesin e licencimit dhe autorizimit.<br>2. Ulja e barrës administrative për subjektet dhe për AIM.<br>3. Standardizimi i dokumenteve bazë dhe dixhitalizimi i shkëmbimit të informacionit.<br>4. Rritja e efikasitetit dhe transparencës në shqyrtimin e aplikimeve.<br>5. Përputhja e procedurave me parimet e menaxhimit modern publik dhe praktikat e BE-së. | Jo | Shqipëria 2030 Shtylla I "Shqipëria Evropiane", pika 1.6, shkronja "c", fq.19 | Jo | Jo | Jo |
| **22** | "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 392, datë 30.06.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e specialiteteve në FA", i ndryshuar | Projektvendim | Ministri i Mbrojtjes | Katërmujori II | • Pika 1/1, e nenit 21, të ligjit nr. 59/2014,"Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar<br>•Përfshirja e specialiteteve të tjera të domosdoshme për ruajtjen e kapaciteteve njerëzore dhe profesionale në Forcat e Armatosura | •Shtohet spektri i specialiteteve të Forcave të Armatosura që rrezikojnë të humbasin dhe kanë si objektiv kryesor ruajtjen e kapaciteteve njërzore. | Jo | Jo | Jo | PAZHFA 2024-2033 | Jo |
| **23** | Për disa ndryshime në vendimin nr. 289, datë 17.05.2023 të Këshillit të Ministrave "Për pjesëmarrjen e personelit të Forcave të Armatosura të Rapublikës së Shqipërisë si pjesë e Forcës Shumëkombëshe dhe Vëzhguesve (Multinational Force and Observes MFO), në Sinai, Republika Arabe e Egjiptit". | Projektvendim | Ministri i Mbrojtjes | Katërmujori II | •Pika 2, e nenit 6, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005,"Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrëne procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës sëShqipërisë", të ndryshuar, dhe të shkronja "ç", të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, "Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar<br>•Mbaron afati i zbatimit në datën 15.06.2026 | •Plotësimin me kuader ligjor për pjesëmarrjen e personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë si pjesë e Forcës Shumëkombëshe dhe Vëzhguesve (Multinational Force and Observes MFO), në Sinai, Republika Arabe e Egjiptit, në kuader të angazhimeve ndërkombetare të vendit tonë. | Jo | Jo | Jo | Strategjia Ushtarake | Jo |
| **24** | "Për disa ndryshime në vendimin nr. 475, datë 08.06.2017 të Këshillit të Ministrave "Për pjesëmarrjen e një toge të Forcave të Armatosura të Rapublikës së Shqipërisë në operacionin ushtarak të NATO-s, në Letoni, i ndryshuar. | Projektvendim | Ministri i Mbrojtjes | Katërmujori III | •Neni 6, pika 5 dhe neni 7, të ligjit nr. 9363, datë24.3.2005, "Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhepër mënyrën e procedurat e vendosjes dhe të kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, dhe shkronja "ç", të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, "Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës sëShqipërisë", të ndryshuar.<br>• Mbaron afati i zbatimit. | •Plotësimi me kuader ligjor për pjesëmarrjen e një toge të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në operacionin ushtarak të NATO-s, në Letoni, në kuadër të angazhimeve ndërkombëtare të vendit tonë.<br>•Afati deri në 31 dhjetor 2026 | Jo | Jo | Jo | Strategjia Ushtarake | Jo |
| **25** | "Për disa ndryshime në vendimin nr. 805, datë 28.12.2023 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin estatusit, mënyrave të pjesëmarrjes dhe masës së dietës ditore për vështirësi shërbimi të personelit të Forcave të Armatosura të Rapublikës së Shqipërisë në misionin e Kombeve të Bashkuara në UNISFA" | Projektvendim | Ministri i Mbrojtjes | Katërmujori III | •Pikat 2 dhe 5, të nenit 6, të ligjit nr. 9363, datë24.3.2005, "Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit", sidhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorine Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, shkronja "ç", e nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, "Përpushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, dhe shkronja "b", e nenit 3, të aktit normativ nr. 4, datë 20.6.2023,të Këshillit të Ministrave, "Për pjesëmarrjen e personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në misionin e Kombeve të Bashkuara në Abyei (UNISFA)", miratuar me ligjin nr.59/2023.<br>•Mbaron afati i zbatimit. | • Plotësimi me kuader ligjor për pjesëmarrjen në misionin e Kombeve të Bashkuara në UNISFA) në kuadër të angazhimeve ndërkombëtare të vendit tonë. | Jo | Jo | Jo | Strategjia Ushtarake | Jo |

## PROGRAMI I PËRGJITHSHËM ANALITIK I PROJEKTAKTEVE PËR VITIN 2026

## MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

| Nr. | Titulli i projektaktit | Lloji i projektaktit | Ministri propozues | Katërmujori | Arsyet kryesore për propozimin e projektaktit | Çështjet kryesore që parashikon të rregullojë projektakti | A është parashikuar projektakti në PKIE?<br><br>Nëse po, të specifikohet kapitulli përkatës | Përputhshmëria e projektaktit me programin politik qeverisë 2025-2029<br><br>Nëse përputhet, të jepet referenca e saktë në progam | A është akt i një rëndësie të veçantë e prioritare? | Lidhja e projektaktit me strategjitë kombëtare dhe sektoriale<br><br>Nëse lidhet, të specifikohen strategjitë | Ndikimet e mundshme ekonomike, financiare, sociale dhe mjedisore<br><br>Përgjigjuni me Po/Jo për ndikimet përkatëse |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Për përcaktimin e kritereve bazë të sektoreve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga Fondi i Programit për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural për vitin 2026 | Projektvendim | MBZHR | Katërmujori I | Percaktimi me vendim te Keshillit te Ministrave te kritereve bazë, sektorëve që mbështeten dhe masës së përfitimit, ndarjes se fondit te bujqesise dhe zhvillimit rural per pagesat direkte ne buxhetet familjare per vitin 2026, bazuar ne pikën 3 të nenit 6 të Ligjit Nr. 9817, datë 22.10.2007 "Për bujqësinë dhe zhvillimin rural" dhe në përputhje me buxhetin për vitin 2026 të miratuar sipas ligjit vjetor të buxhetit 2026. | Percakton kriteret baze per te perfituar nga buxheti i shtetit i alokuar per buxhetet familjare per vitin 2026, masat qe financohen dhe dokumentacioni qe paraqitet. | Jo | Po<br>Shtylla II "Rritja ekonomike e qëndrueshme"<br>Pika 2.7 'Bujqësia dhe Zhvillimi Rural'<br>Shkronjat a) dhe b) | Po | Po, me Strategjinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Peshkimit, 2021–2027 | Po, ekonomike sociale dhe financiare.<br><br>Pika 3.3 nënpika 3.3.1 "Mbështetje financiare dhe asistencë teknike për fermerët"e PBA 2026-2028 |
| 2 | Per disa shtesa dhe ndryshime ne Ligjin Nr. 9244, datë 17.6.2004, "Për mbrojtjen e tokës bujqësore", të ndryshuar. | Projektligj | MBZHR | Katërmujori I | Ne legjislacionin aktual nuk eshte parashikuar aktiviteti bujqesore permes teknologjive inovative. Qëllimi i këtij projektligji është plotësimi i kuadrit ligjor për lejimin e ushtrimit të aktivitetit bujqësor përmes teknologjive inovative si; aeroponia, akuaponia dhe hidroponia për tu zhvilluar në tokë bujqësore. | Kërkesa për të transformuar gjithnjë e më shumë sektorin bujqësor në Shqipëri shtron nevojën e adoptimit të teknologjive inovative si; Akuaponi, Aeroponi dhe Hidroponi. Përqasja me modeleve të ngjashme me vendet me bujqësi të zhvilluar dhe zbatimin e tyre në vend, kërkon ndërhyrje ligjore për rregullimin e këtij aktiviteti në tokën bujqësore. | Jo | Jo | Jo | Jo | Po, ekonomike dhe mjedisore. |
| 3 | "Per disa shtesa dhe ndryshime ne Ligjin Nr. 8318, datë 1.4.1998, "Për dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve dhe të kullotave që janë pasuri shtetërore", të ndryshuar. | Projektligj | MBZHR | Katërmujori I | Nëpërmjet këtij projektligji synohet të shfrytëzohen toka bujqësore, të cilat për shkak të cilësive jo të mira dhe kushteve jo të favorshme të terrenit, nuk kanë efektivitet në prodhimtarinë bujqësore, por krijojnë të ardhura nëpërmjet përdorimit të teknologjive të reja duke rritur konkurrencën dhe efektivitetin e prodhimit. | Plotësimin e bazës ligjore dhe mundësimin e prodhimit të energjisë elektrike nga burimeve të rinovueshme në tokat bujqësore që jepen me qira nga Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, bashkë me aktivitetin bujqësor; kalimi i siperfaqeve toke bujqesore me bonitet 9-10 ne fondin e pasurive te paluajtshme ne mbehtetje te investimeve strategjike. kontrata e qiarse si dhe monitorimete per rastin e aktiviteteve agrivoltaike parashikohen të realizohen nga MBZHR dhe MIE | Jo | Jo | Jo | Jo | Po,ekonomike dhe mjedisore. |
| 4 | "Për për disa shtesa në Vendimin nr. 760, datë 16.9.2015 të Këshillit të Ministrave "Për kërkesat për gjurmimin e ushqimit dhe ushqimit për kafshë" | Projektvendim | MBZHR | Katërmujori I | Miratimi i këtij projetvendimi është në kuadër të nismave të ndërmarra për përafrimin e plotë të legjislacionit evropian ne kuadër të antarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian (BE), në mbështetje të kapitullit të 12 "Politikat e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë dhe Fitosanitetit". Miratimi i projektvendimit është kërkesë e Raport Progresit të vitit 2024 dhe është angazhim i marrë në Pozicionin Negociues. Miratohet në zbatim të pikës 4, të nenit 25, të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, "Për ushqimin", të ndryshuar | Ky projektvendim vendos kërkesa të detajuara për gjurmueshmërinë e filizave dhe farave të destinuara për prodhimin e filizave, duke mundësuar identifikimin dhe ndjekjen e çdo partie farash ose filizash në të gjitha fazat e prodhimit, përpunimit dhe shpërndarjes për të mbrojtur shëndetin publik dhe për të parandaluar incidentet e sigurisë ushqimore që mund të lidhen me filizat dhe farat e tyre. | Po, kapitulli 12 | Po<br>Shtylla II "Rritja ekonomike e qëndrueshme"<br>Pika 2.7 'Bujqësia dhe Zhvillimi Rural'<br>Shkronjat a) dhe b) | Jo | Po, me Strategjinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Peshkimit, 2021–2027 dhe me Strategjinë Kombëtare të Sigurisë Ushqimore 2023–2027 | Jo |
| 5 | "Për kontrollet zyrtare dhe veprimtari të tjera zyrtare të kryera për të garantuar zbatimin e legjislacionit mbi ushqimin dhe ushqimin për kafshë, rregullimeve mbi shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve si dhe mbi shëndetin e bimëve dhe produkteve për mbrojtjen e bimëve në Republikën e Shqipërisë" | Projektligj | MBZHR | Katërmujori I | Ky projekt ligj do të përafrohet pjesërisht me Rregulloren (BE) 2017/625 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 15 mars 2017. Ky projekt ligj përcakton rregullat e përgjithshme dhe të veçanta, parimet dhe kërkesat që lidhen me kontrollet zyrtare dhe veprimtaritë e tjera zyrtare, si dhe përcakton përgjegjësitë, financimin dhe procedurat për kryerjen e kontrolleve zyrtare me qëllim garantimin e një niveli të lartë të mbrojtjes së shëndetit të njerëzve, kafshëve dhe të mjedisit në Republikën e Shqipërisë. Hartimi i ketij projekt ligji ka per qellimin unifikim e kontrolleve zyrtare sipas legjislacionit te BE-së, si dhe plotësimin e rekomandimeve te Raport-progreseve. | Ky projekt ligj parashikon të përcaktoje rregullat për: a) kryerjen e kontrolleve zyrtare dhe veprimtari të tjera zyrtare nga institucionet përgjegjëse; b) financimin e kontrolleve zyrtare; c) miratimin dhe zbatimin e kushteve që duhet të përmbushin kafshët dhe mallrat që hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë nga shtete që nuk janë shtete anëtare të BE-së; d) ngritjen e një sistemi informacioni të kompjuterizuar për të menaxhuar informacionin dhe të dhënat që i përkasin kontrolleve zyrtare; | Po, kapitulli 11 dhe 12 | Jo | Po | Po, me Strategjinë Kombëtare te Sigurisë Ushqimore 2023 - 2027 | Po, ndikime ekonomike. |
| 6 | "Për përcaktimin e kritereve, procedura, mënyra e transferimit të menaxhimit të infrastrukturës së peshkimit dhe infrastrukturës së lidhur me peshkimin dhe formati tip i kontratës" | Projektvendim | MBZHR | Katërmujori I | Me hyrjen ne fuqi te ndryshimeve te ligjit 64/2012 "Për peshkimin", bazuar pikës 4 të nenit 65 të këtij ligji nevojitet hartimin e vendimit per përcaktimin e kritereve, procedura, mënyra e transferimit të menaxhimit të infrastrukturës së peshkimit dhe infrastrukturës së lidhur me peshkimin dhe formati tip i kontratës, me qellim menaxhimin optimal te infrastrukturës se peshkimit. | Projektvendimi percakton kriteret, procedurat, mënyren e transferimit të menaxhimit të infrastrukturës së peshkimit dhe infrastrukturës së lidhur me peshkimin dhe formati tip i kontratës | Jo | Jo | Jo | Po, me Strategjinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Peshkimit, 2021–2027 | Jo |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
